



UBT ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi edhe me 16 universitete evropiane

## KOSOVA KA NJË TË ARDHME TË SHKËLQYESHME

Kualiteti dhe dituria e studentëve të UBT-së janë në rritje...

..... Faqe 4

## UBT-ja E ZYRTARIZOI MARRËVESHJEN ME UNIVERSITETIN CITY



..... Faqe 5

## NGA UBT - DOKTORATË NË UNIVERSITETIN TEKNIKTË VJENËS

"Punimet hulumtuese shkencore që i kemi zhvilluar gjatë programit master në UBT kanë dhënë efekte pozitive ...

..... Faqe 7

## UBT-ja VËRTET ËSHTË INSTITUCIONIN I ARSIMIT TË LARTË



Mundësitë që i ofron UBT-ja gjatë periudhës së studimeve, e sidomos kontaktet në trekëndëshin student-mësimdhënës-staf menaxherial...

..... Faqe 14

## STUDENTJA E UBT-së FITOI MEDALJE TË ARTË

..... Faqe 8

# UBT-ja PËRFITUESE E PROJEKTIT "ERASMUS MUNDUS"

"Me kënaqësi e mora ftesën nga një institucion i arsimit të lartë, siç është në këtë rast UBT-ja, që është përfituese e një projekti "ERASMUS MUNDUS", sepse ta përfitosh një projekt të tillë nuk është rastësi por është e arritur në sajë të cilësisë, e përgëzoj UBT-në për punën e bërë në vazhdimësi". tha Prof. Dr. Ramë Buja, Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Kosovës.



Faqe 3

# UBT UNIVERSITET ME NAM

Kam pasur oferta të ligjëroj edhe në universitete tjera private, por për shkak të namit të këtij universiteti jam përcaktuar vetëm për UBT-në. UBT në krahasim me institucionet e tjera arsimore është institucion i profilizuar dhe udhëheqës në Teknologjinë Informativë", thotë Fatos Maxhuni.

Faqe 8



## Editorial

**ZHVILLIM .... HULUMTIM ... BASHKËPUNIM ... STUDIM ...**

**Edmond Hajrizi**  
President i UBT-së

**Zhvillimi ekonomik**

Këto ditë jemi dëshmitarë të diskutimit rreth aprovimit të buxhetit dhe rritjes së pagave në sektorin publik. Të gjithë dëshirojnë rritjen e pagave, megjithëse mungon potenciali për një gjë të tillë. Prodhimtaria e ulët vendore. Ne duhet të punojmë më shumë në rritjen e prodhimit të vendore, cilësisë, eksportit dhe investimeve të huaja.

**Zonat ekonomike**

Zonat ekonomike shihen si një potencial i mirë për zhvillimin ekonomik, zhvillimin e prodhimit të vendore dhe uljes së papunësisë. Qeveria dhe komunat e Kosovës, por edhe iniciativat private, kanë bërë që në Kosovë të kemi disa zona ekonomike dhe inkubatorë të biznesit, të cilat dita-ditës po marrin formën e tyre të plotë. Një faktor me rëndësi në suksesin e këtyre zonave është edhe mënyra e menaxhimit të tyre. UBT ka zhvilluar një hulumtim rreth rolit dhe rëndësisë së zonave ekonomike, praktikave më të mira në botë rreth menaxhimit të tyre, si dhe ka organizuar një vizitë studimore në Slloveni, Angli, Gjermani dhe Austri. Është bërë edhe një analizë dhe një studim për modelet më të mira të menaxhimit të mundshëm të zonave ekonomike në Kosovë, duke dhënë në fund edhe një propozim konkret.

**Investimet e huaja**

UBT ka bërë edhe një hulumtim rreth perceptimit të investitorëve të huaj në Kosovë prej 1999 deri në 2010, për të bërë biznes në Kosovë. Studimi na tregon cilët janë faktorët kryesorë që vlerësohen në Kosovë dhe cilët janë faktorët të cilët shihen nga ana e investitorëve të huaj si pengesë apo kanë nevojë për përmirësim.

UBT në këtë rast ka bërë disa propozime se çka duhet të ndërmerret për përmirësimin e klimës investive në Kosovë.

Në ndërkohë, UBT ishte pjesë e një delegacioni kosovar të përbërë nga Qeveria e Kosovës, Agjencia për Promovimin e Investimeve të Huaja në Kosovë (IPAK) dhe disa kompani prodhuese dhe tregtare në Kosovë, gjatë një vizite në Gjermani. Në këtë rast, para shume bizneseve dhe institucioneve gjermane është bërë një paraqitje e mundësive dhe potencialit që ka Kosova për investime, dhe pse kompanitë gjermane duhet të investojnë në Kosovë.

**Marrëveshja me City University**

Para disa ditësh isha në Angli për të përfunduar procesin e nënshkrimit të marrëveshjes me Universitetin City në Londër. Përveç pritjes shumë të mirë, diskutuam shumë për projektet që dëshirojmë t'i realizojmë së bashku në të ardhmen. Edhe një herë morëm konfirmimin se UBT do të jetë një urë lidhëse për të gjitha projektet dhe bashkëpunimin që ky universitet do të ketë me regionin e Evropës Juglindore.

**Tani e tutje, studentët e UBT-së do të kenë mundësi të marrin edhe diploma nga Britania e Madhe dhe nga një Universitet prestigjioz siç është City University.****Vizita në IfM – Cambridge University**

Vizita e UBT-së në Universitetin e Cambridg-it, njërin prej universiteteve më të mira në botë, ishte një eksperiencë e paharrueshme. 1000 vjet përvojë, infrastruktura, qasja praktike, hulumtimet intensive, publikimet, janë disa prej pikave të cilat e karakterizojnë këtë universitet.

**Zhvillimet e reja në Menaxhimin e Projekteve**

Edhe kësaj here UBT e përfaqësoi Kosovën në mbledhjen vjetore të Organizatës Botërore për Menaxhimin e Projekteve (IPMA), ku me theks të veçantë u diskutua për avancimin e një modeli të ri të standardeve për vlerësimin e kompetencës në menaxhimin e projekteve.

**Konferenca dhe Gara Evropiane**

Roli i Sistemeve të Informacionit dhe Teknologjisë në zhvillimin ekonomik është konferenca e radhës që UBT organizon në bashkëpunim me Universitetin e Tiranës dhe nën patronazhin e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

Edhe këtë vit UBT është mikpritëse e një gare ndërkombëtare për robotikë. Është fjala për garat në futboll por edhe garat e robotëve humanoidë.

**Qasja praktike në studime**

Një ndër faktorët e suksesit në karrierë është qasja praktike gjatë studimeve. Ajo do të ndihmojë shumë të diplomuarin për punësim dhe zhvillim të karrierës.

Në UBT për çdo ditë kemi kërkesa dhe oferta për kryerjen e praktikës së studentëve të tij. Kjo për faktin se studentët e UBT-së janë më të vlerësuarit.

**Erasmus Mundus**

UBT është universiteti i parë dhe i vetmi privat që për katër vitet e ardhshme do të përfitojë nga Projekti Evropian "Erasmus Mundus". Në kuadër të konzorciumit me 16 universitete të tjera nga Evropa dhe regionin, studentët dhe stafi i UBT-së do të kenë mundësi të qëndrojnë për vizita studimore jashtë vendit. Të gjitha shpenzimet do të hiqen nga ky projekt.



## IMPRESUM

UBT News - Gazetë studentëve të UBT-së,  
**Përgatiti & Kryeredaktore:** Naile Demiri  
**Adresa:** www.ubt-uni.net  
**Tel:** 038 541 400  
**Thyerja Grafike:** ELV Studio



**UNIVERSITY EDUCATION  
FOR BUSINESS AND TECHNOLOGY**  
**AMERICAN EUROPEAN UNIVERSITY**



UBT ORGANIZOI KONFERENCË ME TEMËN "PROJEKTET E UBT-së DHE NDËRKOMBËTARIZIMI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS, NË VEÇANTI PREZANTIMI I PROJEKTIT ERASMUS MUNDUS"

# UBT-ja PËRFITUESE E PROJEKTIT "ERASMUS MUNDUS"

"Me kënaqësi e mora ftesën nga një institucion i arsimit të lartë, siç është në këtë rast UBT-ja, që është përfituese e një projekti "ERASMUS MUNDUS", sepse ta përfitosh një projekt të tillë nuk është rastësi por është e arritur në sajë të cilësisë, e përgëzoj UBT-në për punën e bërë në vazhdimësi". tha Prof. Dr. Ramë Buja, Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Kosovës.



PRISHTINË, 03 MARS 2011— Universiteti për Biznes dhe Teknologji (UBT) organizoi konferencën me temën "Projektet e UBT-së dhe ndërkombëtarizimi i Republikës së Kosovës, ku me theks të veçantë u prezantua projekti "Erasmus Mundus".

Konferenca u organizua në ambientet e Hotel Grandit në Prishtinë, ndërsa punimet dhe vendimet e projektit "ERASMUS MUNDUS" u prezantuan nga Prof. Dr. Edmond Hajrizi, i pari i Universitetit për Biznes dhe Teknologji (UBT), që njëherësh është përfituesi i projektit, vlerësoi se përmes projekteve të tilla edhe më të hershme është arritur një mobilitet i lartë i studentëve në këtë universitet, stafit akademik, ngritje e kapaciteteve akademike shkencore dhe janë arritur që të organizohen konferenca të shumta ndërkombëtare siç është "SWIIS 2010 Workshop on Supplemental Ways for Improving International

Stability, që është organizuar në semestrin e kaluar, etj. Presidenti Hajrizi ndër të tjera ka theksuar se përmes publikimeve në revistave ndërkombëtare dhe konferencave kemi arritur që Kosovën ta fusim në mekanizmat ndërkombëtare të akademisë dhe shkencës siç është në Organizatën Ndërkombëtare për Cilësi (OEC), në Federatën Ndërkombëtare të Kontrollit Automatik (IFAC), si dhe në Organizatën për Menaxhimin e Projekteve (IPMA) etj, ku vendi ynë sot është i barabartë me organizmat më të rëndësishëm botëror në fushat e shkencës dhe teknologjisë, andaj edhe projekti "Erasmus Mundus", do të jetë kontribues i madh për katër vitet e ardhshme, siç janë bursat që ofrohen për të studiuar në vendet e Bashkimit Evropian, por edhe në rajon.

Ai po ashtu ka theksuar se ideja dhe përmbajtja e këtij projekti është që zakonisht të rritet hapësira e ndërmarrësisë dhe kompetenca

në menaxhim në fushat e teknologjisë, inxhinierisë, matematikës edhe shkencës.

Ndërkohë Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Kosovës, Prof. Dr. Ramë Buja, konferencën e ka vlerësuar si të rëndësishme në zbatimin programeve për ngritjen e cilësisë së studimeve. "Me kënaqësi e mora ftesën nga një institucion i arsimit të lartë, siç është në këtë rast UBT-ja, që është përfituese e projektit "Erasmus Mundus", sepse ta përfitosh një projektin e tillë nuk është rastësi por është e arritur në sajë të cilësisë e përgëzoj UBT për punën e bërë në vazhdimësi".

Ai ka premtuar mbështetje të pakursyer që Kosova të ecë në hap me dijen. "Nuk guxojmë që në Kosovë të kemi qytetarë të rangut të parë dhe të dytë. Unë do të jem shumë i interesuar që në institucionet tona të instalojmë një gjë që është shumë logjike, garën e dijes, por edhe të shohim se cili është

pozicioni i gjithsecilit", ka thënë Ministri Buja.

**Përfitues të projektit "ERASMUS MUNDUS", janë 16 universitete nga rajoni dhe Evropa, prej tyre tetë nga vendet e Ballkanit, ku Universiteti për Biznes dhe Teknologji (UBT), është Universiteti i vetëm privat nga Kosova dhe rajoni që është përfituese e projektit në fjalë.**

Projekti është katërvjeçar dhe në përgjithësi ofron 264 bursa, UBT-ja ka 38 mobilitete ose bursa. Projekti ka një shumë 3.8 milionë euro. Krahas tjerave UBT e ka edhe një privilegj përfshirë brenda projektit, sepse për katër vite me radhë është koordinatore e këtij projekti. "Erasmus Mundus" ofron bursa, që do të ndahen për studentë dhe staf akademik të të gjitha institucioneve të arsimit të lartë në Kosovë përmes projektit, përfshinë edhe aktivitete tjera si trajnime

në ndërmarrësi, menaxhment, shkencë, teknologji, inxhinieri dhe matematikë.

**UBT ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi edhe me 16 universitete evropiane**

Ta përkujtojmë se në kuadër të këtij projekti UBT është në marrëveshje bashkëpunimi me 16 universitete evropiane siç janë: City University London, Freie University Berlin, Lappeenranta University of Technology, Wrocław University of Technology, University of Bucharest, Technical University of Cluj-Napoca, University of Business & Technology, Polytechnic University of Tirana, University of Sarajevo, University of Tuzla, University of Split, University "St. Kliment Ohridski" Bitola for University of Novi Sad. Të drejtë aplikimi do të kenë studentët dhe mësuesit që iu takojnë lëvizjeve të teknologjisë, inxhinierisë, ndërmarrësisë, matematikës etj.



INTERVISTË ME PROF. DR. MOHAMED BAZAZ, LIGJËRUES NË FAKULTETIN E MENAXHMENTIT, BIZNESIT DHE EKONOMISË TË UNIVERSITETIT PËR BIZNES DHE TEKNOLOGJI (UBT)

# KOSOVA KA NJË TË ARDHME TË SHKËLQYESHME

Kualiteti dhe dituria e studentëve të UBT-së janë në rritje. Në nivelin e të diplomuarëve gati se të gjithë studentët janë duke punuar. Ata më shumë janë fokusuar në të mësuar sesa në pranimin e një diplome - thotë profesori Mohamed Bazaz

INTERVISTOI: NAILE DEMIRI

## Kush është Bazazi?

**UBT News:** Profesor a mund të na thuani pak fjalë për veti dhe angazhimeve të Juaja në aspektin profesional?

**M. Bazaz:** Kam ligjësuar kontabilitetin në Universitetin e Oakland-it gjatë 20 vjetëve të fundit. Njëherësh kam ligjësuar edhe në kurse të ndryshme financiare, menaxheriale dhe kontabilitet ndërkombëtar për të dy nivelet - të diplomuarëve dhe të padiplomuarëve. Kam qenë i ftuar për të mbajtur kurse të edukimit ekzekutiv në kontabilitet në universitete të ndryshme si në Austri, Kanada, Indi, Iran, Kosovë (pikërisht në Universitetin për Biznes dhe Teknologji (UBT), që nga viti 2004), si dhe në Malajzi. Kam publikuar më tepër se 35 artikuj hulumtimi në zhurnale nacionale dhe ndërkombëtare të nivelit të lartë shkencor. Gjithashtu kam prezantuar punime të shumta shkencore në konferenca të ndryshme të kontabilitetit.

**UBT News:** Profesor, ju jeni ndër ligjësuesit e parë ndërkombëtarë në Universitetin për



**Biznes dhe Teknologji, si e vlerësoni UBT në përgjithësi që nga dita e parë e deri më tani?**

**M. Bazaz:** UBT është rritur dhe ka fituar dimensione të shumta. Ky institucion shkencor ofron fusha të ndryshme studimi: teknologji, shkencë kompjuterike, inxhinieri, menaxhment dhe ekonomi; pastaj administrim publik dhe biznes, ligj dhe marrëdhënie ndërkombëtare. Kualiteti i studentëve në UBT është rritur në mënyrë të konsiderueshme. Grupi i tanishëm i studentëve komunikojnë rrjedhshëm në gjuhën angleze. Këta tash janë më serioz në krahasim me grupin e parë. Janë entuziast në të mësuar dhe marrin pjesë në mënyrë aktive në diskutime.

**UBT News:** Si e vlerësoni nivelin e studentëve, të cilëve ju u keni dhënë mësim në UBT?

**M. Bazaz:** Siç tregova më parë, kualiteti i njohurive të studentëve të UBT-së është në rritje. Në nivelin e të diplomuarëve, gati të gjithë studentët janë fokusuar në të mësuar sesa në pranimin e një diplome. Ata e njohin rolin e njohurive të kontabilitetit në jetën e tyre profesionale dhe personale.

**UBT News:** Duke pasur përvojë të gjatë në mësimdhënie në shtetin tuaj, a mund të bëni një krahasim ndërmjet edukimit të lartë atje dhe edukimit të lartë në UBT?

**M. Bazaz:** Kurrikualet e edukimit të lartë në ShBA dhe Kosovë

janë relativisht të ngjashme. Në ShBA studentët kanë më tepër qasje në resurset edukative dhe në bazat e të dhënave, kurse në Kosovë besoj se studentët kanë mungesa, por edhe punojnë më shumë që t'i zhvillojnë aftësitë e tyre. Një sugjerim modest që e kam për UBT-në është t'i zgjerohet orët e kontaktit me studentë për një periudhë më të gjatë.

**UBT News:** Si e shihni të ardhmen e këtij institucioni?

**M. Bazaz:** Duke i shtrënguar gradualisht standardet e edukimit, duke ndjekur kërkesat e trupit akreditues të Evropës dhe ISO 9001, dhe duke vazhduar tërheqjen e trupit student, studentë të zgjuar dhe të pasionuar,

do të bëhet e ardhmja e UBT-së e shkëlqyeshme dhe më e suksesshme. Jam i sigurt që UBT-ja është në rrugë të drejtë në bërjen e brendit që është i njohur regjionalisht për ekselencën edukative në Kosovë.

**UBT News:** Dhe për fund, Çfarë mesazhe do t'i jepni studentëve, por edhe institucioneve të Kosovës në lidhje me ekonominë që po ndodh sot në Kosovë - është e përshtatshme apo duhet të ndërrohet?

**M. Bazaz:** Studentët ekzekutiv duke u diplomuar nga universitetet në Kosovë janë mjaft të edukuar dhe menaxherë të aftë që janë në gjendje të luajnë role të rëndësishme në zhvillimin dhe rritjen e ekonomisë. Besoj që Kosova ka një nga ekonomitë më të hapura në rajon. Kosova po vazhdon të punojë me komunitetin ndërkombëtar në masat se si ta përmirësojë ambientin e biznesit dhe të tërheqjes së investimeve të huaja. Studentët e diplomuar që janë të tanishëm dhe menaxherët e ardhshëm duhet të ndihmojnë në privatizimin e bizneseve dhe të provojnë të tërheqin më tepër investime të huaja. Niveli i edukimit është duke u rritur. Kërkesat e lartë për punësim janë faktorë kryesorë që ndihmojnë në përmirësimin e ekonomisë së Kosovës. Kosova duhet të punojë shumë për t'u integruar në Unionin Evropian. Në përgjithësi, jam i sigurt që Kosova ka një të ardhme të shkëlqyeshme.

**UBT News:** Planet tuaja profesionale në të ardhmen?

**M. Bazaz:** Planifikoj të jap mësim dhe të vazhdoj kryerjen e hulumtimeve për të paktën në 10 vitet e ardhshme. Për më tepër, do të doja ta bëja veten më në dispozicion për angazhime konsultative.

## PRESIDENTI I UBT-së NDEROHET ME TITULLIN AMBASADOR PËR PAQE

PRISHTINE, 18 MARS 2011—

Presidenti i Universiteti për Biznes dhe Teknologji (UBT), Prof. Dr. Edmond Hajrizi, është nderuar më titullin Ambasador për Paqe, nga Asambleja Kombëtare të Ambasadorëve të Paqes në Kosovë, e cila mbahet nën organizimin e Federatës së Paqes Universale (UPF). Për kontributin e juaj pozitiv në fushën e arsimit të edukimit dhe shkencës në përgjithësi, me kënaqësi të veçantë të ndajmë titullin Ambasador për Paqen, u tha në ftesën për pjesëmarrje e tij gjatë ceremonisë së ndarjes së titullit.



## UBT ME KAMPUS TË RI UNIVERSITAR



Universiteti për Biznes dhe Teknologji (UBT), brenda vitit akademik 2010/2011, procesin mësimor pret ta organizojë në kampusin e ri universitar. Kampusi i ri është në afërsi të QMI-së, në Komunën e Lipjanit. Projekti i kampusit është projektuar nga studentët e diplomuar në Fakultetin e Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor në UBT si Ardian Muhadri, Fidan Belegu etj. dhe stafi akademik ndërkombëtar e vendor.



## UBT-ja BASHKËPUNON ME LONDRËN



## UBT E ZYRTARIZOJ MARRËVESHJEN ME UNIVERSITETIN CITY

PRISHTINË, MARS 2011—

Në kuadër të vazhdës së Marrëveshjeve të Bashkëpunimi që ka Universiteti për Biznes dhe Teknologji (UBT) me universitete me prestigjioze në botë dhe Evropë, Presidenti i universitetit në fjalë Prof. Dr. Edmond Hajrizi për disa ditë më radhë ka qëndruar jashtë shtetit më konkretisht në Universitetin City në Londër (Angli), për ta zyrtarizuar dhe konkretizuar përfundimisht marrëveshjen e bashkëpunimit ndëruniversitar.

Me theks të veçantë marrëveshja në fjalë do të mundësojë studenteve kosovarë që studimet universitare në nivelin bachelor, master dhe të doktoratës ti ndje-

kin në UBT dhe në Universitetin City, po ashtu stafit akademik zhvillim e kompetencës në fushën hulumtuese dhe zhvillimore. Bashkëpunimi do të ofrojë edhe programe të tjera te veçante si janë projektet, seminarat, transferi i teknologjisë, dhe takime tjera akademike për çështje të rëndësishme për të dy institucionet dhe të dy vendet.

Sipas palëve nënshkruese bashkëpunimi ndëruniversitar në mes UBT-së dhe Universitetit City ka filluar më herët dhe pohuan se marrëveshja është incizuar nga të dy palët.

Në bazë të bisedave që patën mes krerëve të institucioneve në

fjalë Presidenti i UBT-së Dr. Hajrizi, u nda i kënaqur me të arritura e Universitetin e City, sidomos më programet e studimit më teknologjinë më moderne, me stafin akademik dhe me arritjet e studenteve. Universitetit City numëron një numër të konsiderueshëm të mësimit dhe ka marrëveshje shumta bashkëpunimi me universitete ndërkombëtare, është themeluar që 100 vite e më shumë, numri i të diplomuarve është i krahasueshëm me universitetet më të mëdha në botë, po ashtu të diplomuarit sot janë të vende udhëheqëse nëpër kompani dhe organizata më profitabile në Evropë dhe botë.

## PRESIDENTI I UBT-së, z. HAJRIZI ZHVILLOI TAKIM ME KRYETARIN E AKADEMISË SË SHKENCAVE TË SHQIPËRISË

## UBT-ja FILLON BASHKËPUNIMIN ME AKADEMINË E SHKENCAVE TË SHQIPËRISË



PRISHTINË, 28 SHKURT 2011 — Presidenti i Universitetit për Biznes dhe Teknologji (UBT), Prof. Dr. Edmond Hajrizi ka zhvilluar një takim me Kryetarin e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Akademik Gudar Beqiraj.

Takimi u realizua me qëllim që një të ardhme të afërt të arrihet

një mirëkuptim ndërinstitucional për të vazhduar bashkëpunimin shkencor dhe kulturor në mes dyja institucioneve. Duke nënvizuar rëndësinë e shkëmbimit të përvojave dhe projekteve të ndërsjellta në përgatitjen e kualifikuar shkencore dhe të kërkimit shkencor ndërmjet institucioneve të dhe

përfaqësuesve të saj, kreu i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë shprehu mbështetjen e tij për studimin dhe kërkimin shkencor, por dhe për të gjithë botën akademike në UBT. Nga ana tjetër presidenti i UBT, Prof. Dr. Edmond Hajrizi pasi e falënderoi Kryetarin Beqiraj për pritjen e ngrohtë e miqësore, e njohu atë me ecurinë e kërkimit studimor e shkencor të UBT-së dhe përfshirjet e bashkëpunimit të nënshkruar nga ky universitet me institucionet ndërkombëtare në rajon dhe në botë. Akademik Beqiraj shprehu gatishmërinë e tij dhe të institucionit që drejton për të ndihmuar dhe bashkëpunuar në kërkimin shkencor të UBT-së, më konkretisht ndërinstitucional.

## UBT VIZITOI QENDRËN NACIONALE E TRAJNIMIT TË FSK-së NË FERIZAJ

## BASHKËPUNIM NDËRINSTITUCIONAL



PRISHTINË, 4 SHKURT 2011 — Me ftesë të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), i pari i Universitetit për Biznes dhe Teknologji (UBT), Prof. Dr. Edmond Hajrizi, Prof. Lulzim Beqiri dhe Prof. Muhamet Ahmeti dhe disa studentë vizituan Qendrën Nacionale e Trajnimit të FSK-së në Ferizaj.

Palët nga UBT i priti gjenerali Enver Çikaqi, dhe diskutuan për disa çështje dhe me tutje ata prezantuan veprimtarinë e qendrës dhe llojet e trajnimeve që organizohen aty, si dhe strukturat operacionale të qendrës së trajnimeve. Ndërsa, majori Naim Sylejmani, u fokusua më shumë në simulimet. "FSK ka shprehë

nevojën e bashkëpunimit me institucionet akademike në këtë rast me UBT-në për aplikimin e njohurive shkencore", citoi z. Sylejmani.

Palët nga UBT shprehën gatishmërinë e ofrimit të një përkrahje adekuate për FSK-në, në aspektin menaxherial, trajnime dhe fusha të tjera.

Të dyja palët u pajtuan që fillimisht të mbajë një takim të përbashkët, ku do të marrin pjesë përveç institucioneve të lartpërmendura edhe institucionet tjera.

Në takimin nismëtarë do të identifikohen mundësitë e bashkëpunimit institucional UBT dhe FSK.

## UBT-ja FILLON BASHKËPUNIMIN ME UNIVERSITETIN E EVROPËS JUGLINDORE

PRISHTINË, 28 SHKURT 2011 — Në kuadër të marrëveshjeve të shumta që i ka Universiteti për Biznes dhe Teknologji (UBT), me universitetet e tjera më prestigjioze në Evropë dhe Botë, Presidenti i UBT, Prof. Dr. Edmond Hajrizi dhe rektori i të Universitetit e Evropës Juglindore (UEJL), Prof. Dr. Zamir Dika, zhvilluan një takim miqësorë për të arritur një bashkëpunim ndëruniversitar. Më konkretisht, në takim u diskutua për të arritur një marrëveshje e cila parasheh mundësimin e shkëmbimit të stafit akademik, studentët të organizojmë seminare dhe takime tjera akademike për çështje shkencore, zbatimin e përbashkët të programeve postdiplomike, aktivitetet lidhur me kurset verore dhe takime tjera akademike për

çështje të rëndësishme për të dy institucionet dhe të dy vendet", theksoi Presidenti i UBT, Edmond Hajrizi, pas takimit me z. Dika.

Sipas palëve homologe bashkëpunimi ndëruniversitar në mes UBT dhe UEJL do filloj brenda një kohë të shkurtër dhe do rezultojë në mënyrë më pozitive, dhe më tej pohuan se takimi është iniciuar nga të dyja palët për të biseduar dhe për të arritur një marrëveshje ndëruniversitare.

Në bazë të bisedave që patën në mes udhëheqësit e institucioneve në fjalë Presidenti i UBT-së z. Hajrizi, u nda i kënaqur me të arritura e Universitetin e Evropës Juglindore, sidomos më programet e studimit më teknologjinë më moderne, me stafin akademik dhe me arritjet e studenteve.



NË UBT U ORGANIZUAN KONFERENCAT NË VAZHDIMËSI ME TEMËN  
«PROGRAMI PËR MENAXHIMIN E ZONAVE EKONOMIKE»

# KUSH DO T'I MENAXHOJË ZONAT EKONOMIKE?

“Zonat ekonomike mund të gjenerojnë një zhvillim të madh ekonomik për të cilin vendi jonë ka shumë nevojë”, tha Presidenti UBT-së, Prof.Dr. Edmond Hajrizi

PRISHTINË, SHKURT 2011 –

Në ambientin e Universitetit për Biznes dhe Teknologji (UBT), gjatë tre muajve të fundit, po të këtij viti, janë organizuar tre konferenca, për të diskutuar për projektin «Programi për menaxhimin e zonave ekonomike», si vazhdimësi e projektit të iniciuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI), respektivisht nga Agjencia për Mbështetje të Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (AMNVM) dhe të implementuar dhe koordinuar UBT-ja.

Në të tria konferencat e fundit fillimisht janë prezantuar hulumtimet që janë bërë nga UBT-ja rreth menaxhimit të zonave ekonomike në vendet e ndryshme të rajonit, Evropës dhe botës.

“Është kërkesë por edhe një sinjal nga eksperiencia e vendeve tjera, se zonat ekonomike mund të gjenerojnë një zhvillim ekonomik për të cilin vendi jonë ka shumë nevojë”, tha Presidenti UBT-së, Prof.Dr. Edmond Hajrizi, gjatë takimit në fjalë.

I pari i UBT-së, z. Hajrizi, me theks të veçantë, në takim prezantoi edhe eksperiencat e marra nga një varg vizitash që ditë më parë i bërë në Republikën e Sllovenisë dhe në Republikën e Gjermanisë, pikërisht në parkun më të madh dhe më të suksesshëm që ka ky shtet, si parkun teknologjik të Dortmundit, dhe disa ndërmarrjeve të tjera.

“Qëllimi i vizitës ishte që të merren praktikata e mira rreth menaxhimit të zonave ekonomike pasiqë, nga përvojat dhe nga praktikata e mira mund të krijohet një vizion më të qartë rreth asaj se si në të vërtetë mund të menaxhohen më mirë zonat ekonomike, dmth, cili model do të ishte më i miri për rastin e Kosovës”, tha Presidenti i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi.

Gjithashtu, në takim janë prezantuar edhe modelet e kompanive menaxhuese për zonat ekonomike dhe aspekti ligjor për krijimin e këtyre kompanive rreth të cilave u zhvillua një debat nga të gjithë pjesëmarrësit të cilët kontribuan me eksperiencat e tyre profesionale rreth menaxhimit të zonave.



Në konferencën e radhës, po me të njëjtën temën me theks të veçantë dhe me gjerësisht u diskutua rreth katër modeleve të kompanisë për menaxhimin e zonave ekonomike si: modeli i parë, një kompani publike qendrore që do të menaxhojë të gjitha Zonat ekonomike në Republikën e Kosovës, modeli i dytë, ku shihet një kompani publike për çdo zonë ekonomike të themeluar nga Qeveria e Kosovës apo nga komunat, modeli i tretë, partneritet publiko privat - kompani publike për menaxhim dhe disa shërbime të ofruara nga kompanitë private dhe modeli i katërtë, kompani

private për menaxhimin e zonave ekonomike.

**Pjesëmarrësit gjatë diskutimit favorizuan gati të gjitha modelet, por më të pëlqyera ishin dy modelet e fundit si partneritet publiko – privat, kompani publike për menaxhim dhe disa shërbime të ofruara nga kompanitë private dhe modeli kompani private për menaxhimin e zonave ekonomike.**

Pjesëmarrësit në fund u pajtuan që për këto dy modelet të bëhet struktura komplete e kompanive me të gjitha parametrat e nevo-

jshme për funksionim në mënyrë që të prezantohen para grupit punues në konferencën e radhës, ku në këtë konferencë do të vendoset për modelin e kompanisë që do të menaxhojë Zonat Ekonomike në vend.

**Kompania publike apo kompania private do të menaxhojë Zonat Ekonomike.**

Po ashtu gjatë konferencës së radhës më saktësisht që u mbajt më 4 prill 2011, në UBT, me theks të veçantë dhe me gjerësisht u prezantua raporti final dhe konceptet e kompanive për menaxhimin e zonave ekonomike. Fokusi i pjesëmarrësve ishte në dy tipe të menaxhimit të zonave ekonomike si kompania publike apo kompania private do të menaxhojë Zonat Ekonomike.

Konceptet për këto kompani i ka prezantuar UBT-ja, dhe të pranishmit kanë dhënë sugjerimet finale të tyre rreth koncepteve të këtyre modeleve dhe rreth përbajtës së raportit final.

Gjatë fundit të konferencës UBT-ja do të inkorporojë këtë raport edhe sugjerimet e grupit punues

dhe pas aprovimit të raportit final nga AMNVM ditëve në vijim do të bëjë promovimin publik të këtij raporti, dhe gazeta e UBT-së, “UBT News” do raportojë në detaje për raportin final.

Me këtë rast, grupi punues ka rekomanduar që në raport të prezantohen të katër modelet, që janë dhënë në konferencën e kaluar të kësaj natyre, e në veçanti dy rastet e fundit të prezantohen në mënyrë detale.

Pjesëmarrësit gjatë konferencave ishin nga institucionet si: MTI-AMNVM, ZKM, MEE, MTI-AMNVM, MTI-APIK, MTI-MAPL, Asociacioni i Komunave, Qendra për Zhvillim Regjional, Oda Ekonomike e Kosovës, Aleanca Kosovare e Biznesit, Oda Ekonomike Amerikane, Banka Botërore, etj.

Konferenca rezultoi të ketë pasur debat të frytshëm dhe prezantim të projektit, ndërsa në konferencën e radhës apo të fundit, do të vendoset për modelin e kompanisë që do të menaxhojë Zonat Ekonomike në vend.

Po ashtu konferenca e parë, për temën e cekur më lartë, është organizuar gjatë muajit Dhjetor 2010, Prishtinë, në UBT.



# NGA UBT - DOKTORATË NË UNIVERSITETIN TEKNIK TË VJENËS

“Punimet hulumtuese shkencore që i kemi zhvilluar gjatë programit master në UBT kanë dhënë efekte pozitive në karrierën time, dhe si rezultat i tyre sot kam fatin që të vazhdoj edhe më tutje me hulumtimet e mia shkencore në TU në Vjenë”, thotë Mimoza Dugolli, për gazetën “UBT News”.

VALËZA GELA &  
FIDAN THAQI STUDENTË NË UBT

Mimoza Dugolli, Binak Beqaj, Lulzim Beqiri dhe Muhamet Ahmeti, të cilët kanë përfunduar studimet master në Universitetin për Biznes dhe Teknologji (UBT), në Departamenti IEME, kurse z. Ahmeti në Departamentin Diplomaci dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare, edhe më tutje u ka hapur dyert UBT-ja, përmes zbatimit të marrëveshjes së bashkëpunimit që ka me Universitetin Teknik (TU) të Vjenës në Austri, ku në marrëveshje, përveç shkëmbimit të stafit akademik ndërinstitucional, konferenca shkencore të përbashkëta, trajnime etj, studentët e UBT-së mund të ju qasën edhe studimeve të mëtutjeshme, dhe kandidatët në fjalë kanë vazhdua punën në këtë drejtim dhe në këtë rast vlen të veçohet pranimi dhe diplomimi i tyre në studimet e doktoratës në Universitetin Teknik (TU) të Vjenës në Austri. Ndaj, Binak Beqaj, vetëm brenda muajit prill po të këtij viti, para një komisioni të universitetit në fjalë ka mbrojtur temën me sukses dhe u shpall dr. nga fusha e planifikimit dhe menaxhimit urban, kurse për Mimosën, Lulëzimin dhe Muhametin, pranimi i tyre u bë e ditur pasi që këta kandidatë gjatë këtyre ditëve kanë marrë konfirmimin nga TU-ja.

## Studimi për KEK-un

Hulumtimi i znj. Dugollit do të përqendrohet më shumë në sektorin e shkencave socio-ekonomike, dhe hulumtimi i saj do përcillet nga Prof. Dr. Peter Kopacek. Ky hulumtim më shumë do të jetë



i drejtuar nga proceset që janë zhvilluar në Kosovën e pasluftës, respektivisht privatizimi i Ndërmarrjeve Publike, me theks të veçantë procesi i privatizimit të Korporatës Energjetike të Kosovës, staf i së cilës kompani është edhe vetë znj. Dugolli, ku mban pozitën e menaxheres në Departamentin e Përkrahjes Afariste.

“Ky është një proces mjaft kompleks që ndërlidh në vete shumë analiza, hulumtime, eksperiencat e ndryshme nga vendet të cilat këtë fazë e kanë kaluar shumë kohë më parë, efektet sociale që do të shprehën gjatë këtyre proceseve etj, e posaçërisht kur një proces i tillë për Korporatën Energjetike të Kosovës është në hapat e parë të përgatitjes”, tha për gazetën “UBT News” Mimoza Dugolli, të cilës rrugët për studimet të tilla ia kanë hapur studimet master në IEME - UBT. Punimet hulumtuese shkencore që i kemi zhvilluar gjatë programit master

në UBT, e posaçërisht pjesës së ligjëratave në TU në Vjenë, kanë dhënë efekte pozitive në karrierën time dhe si rezultat i tyre sot kam fatin që të vazhdoj edhe më tutje me hulumtimet e mia shkencore në TU në Vjenë, shtoi ajo.

Po ashtu, Lulzim Beqiri, i cili studimet master i ka përfunduar në UBT, njëherit edhe ligjërues në Departamentin e Arkitekturës dhe menaxher për zyrën e projekteve në UBT, ka fituar të drejtën të bëhet kandidat për doktoratë në TU, ku mentor e ka prof. dr. Peter Kopacek, dhe temë hulumtimi e ka “Faktorët që ndikojnë në menaxhimin strategjik të ndërmarrjeve të mesme dhe të vogla ndërtimore në Kosovë”.

## Impakti i autostradës Morinë - Mendar

Po ashtu edhe kandidati i tretë, Muhamet Ahmeti, i cili ka përfunduar studimet master në UBT, në Departamentin Diplomaci dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare, po



ashtu është edhe ligjërues në UBT, po në këtë afat ka hyrë në studime të doktoratës në TU, mentor e ka prof. dr. Peter Kopacekun, ndërsa tema e tij është “Logjistika dhe transporti (inpakti i autostradës Merdar - Morinë) dhe menaxhimi i projekteve ndërtimore, autostrada Merdar-Morinë”. Vlen të veçohet se studentët e UBT-së edhe më herët e kanë pasur këtë mundësi të lëvizin nëpër universitete më prestigjioze nëpër Evropë dhe botë. Një rast që vlen të përmendur është Ilir Hajdini, i cili studimet themelore i ka përfunduar në UBT, masterin në Angli, kurse doktoratën e ka regjistruar në TU.

## BINAK BEQAJ DOKTOROI NË UNIVERSITETIN E VJENËS

Po ashtu edhe kandidati Binak Beqaj, i cili ka përfunduar masterin në UBT, Departamenti IEME, vetëm gjatë këtyre ditëve ka mbaruar studimet e doktoratës në Universitetin e Teknologjik të Vjenës.

## Menaxhimi i integruar urban - rasti i Prishtinës

Hulumtimi i kandidatit në fjalë është “Menaxhimi i integruar urban - rasti i Prishtinës”, dhe me këtë, është njëri ndër hulumtuesit e parë në Kosovë në fushën e planifikimit dhe menaxhimit urban, po ashtu është ndër të partë që ka marrë titullin doktor i kësaj fushe. “Edhe fusha e hulumtimit si edhe përmbajtja disertacionit konsiderohen ndër fushat më me rëndësi për planifikimin e zhvillimit të gjithë mbarshëm të shoqërisë kosovare e sidomos në menaxhimin e rritjes rapide të zoneve urbane në Kosovë, me theks të veçantë Prishtinës si kryeqytet i saj.

Pasiçë ne e uruam z. Beqaj për këtë sukses që ka arritur në institucionet akademike me renome ndërkombëtare, përgjigja e tij ishte mjaftë modeste: “Këtë nivel që e kam arritur e vë në dispozicion të nevojave të qytetarëve dhe institucioneve të Republikës së Kosovës”, tha Dr. B. Beqaj për gazetën “UBT News”.

## “EKO” PREZENTE EDHE NË ZVICËR

Studentët e UBT-së, janë të mirëseardhur në bodrumin e Rahovecit “Eko”, për vizitë, praktikë në lëmin e teknologjisë dhe për punësim - thotë Kreshnik Hoxha

RREZART PREBREZA,  
STUDENT NË UBT

Një pjesë e madhe e studentëve të UBT, përveç që e ndjekun procesin mësimorë ata menaxhojnë edhe bizneset e tyre familjare, ndaj edhe nga ata nuk kanë nevojë të kërkojnë punësim të mëtutjeshëm. Kreshnik Hoxha, studentë në UBT, në Fakultetin e Shkencave Kompjuterik dhe Inxhinieri, që e ka edhe biznesin e vetë familjarë, bodrumin “Eko”, në Rahovec, që prodhon verë dhe raki rrushi me traditë familjarë afër 200 vjet, është edhe i licencuar prej vitit 2002 nga Ministrin e Bujqësisë të Republiksë së Kosovës. Kompania në vazhdimësi është ka shkon në

rritje të produktit që ka, po ashtu në të njëjtën kohë rritet edhe oferta për punësim. Kjo ofertë për Kreshnikun më shumë vlen për kolegët e studimeve në UBT, në fakultetin ku është edhe vetë.

“Prindërit e mi e menaxhojnë bodrumin “Eko”. Unë gjatë pushimeve kyçem në vazhdimësi, por edhe studentët janë të mirëseardhur për vizita, punë praktikë në lëmin e teknologjisë, por janë të mirëseardhur studentët edhe për punësim”, thotë Kreshniku.

“Në këtë fabrikë prej vitit 2002, në pajisje dhe në objekt janë investuar 700 mijë € kurse për investime të mëtutjeshme nuk mendojmë, sepse te ne mungon përkrahja nga bankat të cilat operojnë në Kosovë,

me këtë lloj kamatat aq janë abnormale për prodhimtarin”, tha ai, për biznesin e vetë familjarë.

Punën intensive biznesi në fjalë e ka nisë prej vitit 2002 kur edhe ka depërtuar në treg. Në fillim kanë pasur shumë vështirësi, por me këmbëngulësi dhe më punë të pandashme dhe të palodhshme dhe me ngritjen e kualitetit momentalisht janë prezentë në tregun e Kosovës, Shqipëri dhe në Zvicër.

Për kualitetin që e ka bodrumin “Eko” momentalisht janë shumë mirë që na dëshmoj edhe me medalje të cilat i kanë fituar në degustimet që janë bërë në Kosovë, Shqipëri dhe në Francë, përfundoi Kreshnik Hoxha.





BISEDË ME PROFESOR FATOS MAXHUNIN, PROFESOR NË FAKULTETIN SHKENCA KOMPJUTERIKE DHE INXHINIERI NË UNIVERSITETIN PËR BIZNES DHE TEKNOLOGJI UBT, FLET PËR GAZETËN "UBT NEWS"

## MAXHUNI: UBT UNIVERSITET ME NAM

"Kam pasur oferta të ligjëroj edhe në universitet tjera private, por për shkak të namit të këtij universiteti jam përcaktuar vetëm për UBT-në. UBT në krahasim me institucionet e tjera arsimore është institucion i profilizuar dhe udhëheqës në Teknologjinë Informativë", thotë Fatos Maxhuni

NORA & FILLORETA HASANI  
- STUDENTE NË UBT

### Studentë-profesor bashkëpronarë të kompanisë "eLogic"

**UBT News:** Një bashkëpunim të kënaqshëm e shohim mes teje dhe studentëve të cilëve u ligjëroni ju, si në procesin mësimor dhe gjetiu, sa jeni të kënaqur më punën e tyre?

**z. Maxhuni:** Kemi studentë të cilët janë praktikantë ndërsa njëri prej tyre është bashkëpronar, dhe gjithashtu shpresoj se në të ardhmen do të krijohen kushte që të punësojmë studentët të UBT-së, të aftësuar në lëmin e Teknologjisë Informativë. Sa i përket punës së studentëve-praktikant në firmë, jam shumë i kënaqur. Studentëve të angazhuar në firmën tonë ua kemi mundësuar që kohën ta shfrytëzojnë jo vetëm për punët e firmës, por, një pjesë të orarit të punës, ta ndajnë edhe për mësim, për shkak se atyre u duhet të përgatiten për ngritje profesionale.

**UBT News:** Studentët në fjalë, a janë më të suksesshëm në UBT apo në "eLogic"?

**z. Maxhuni:** Studentët e angazhuar në firmën tonë kanë qenë dhe ende janë mjaft të suksesshëm si në studime po ashtu edhe në punë. E rritet se koha e kaluar në firmë shfrytëzohet edhe për aftësim të mëtejshëm profesional. Këtyre studentëve kjo kohë u jepet në dispozicion për shkak të domosdoshmërisë së përcjelljes me trendet zhvillimore në fushën e Teknologjisë Informativë.

**UBT News:** Flitet në administratën e UBT-së, por këto fjalë vijnë edhe nga vetë studentët, se Fatosi është ndër profesorët më të preferuar të studentët, është i afërt me ta, respekt në mes të dy palëve, ligjërimi i juaj është i nivelit të lartë etj. Si keni arritur në këtë nivel të kënaqshëm, çka ju shtynë të mbani këtë relacion pozitiv me studentët dhe a do ta vazhdoni këtë metodë edhe në të ardhmen?

**z. Maxhuni:** Së pari ju falënderoj juve dhe studentët për këto fjalë. Unë të gjithë procesin mësimor e bazoj në dy elemente: në punë dhe



në respekt të ndërsjellë. Studimet e mia i kam përfunduar në Mbretërinë e Bashkuar, dhe kam pasur fatin të studioj në një ambient ku relacioni student-ligjërues ka qenë shumë korrekt dhe respekti ka qenë i dyanshëm. Unë besoj se një student që ndihet i respektuar dhe i afërt me profesorin, motivohet më shumë, prandaj edhe suksesi nuk mungon. Meqenëse kjo qasje më ka motivuar mua, mendoj se do t'i motivojë edhe studentët në UBT. Respekti i dyanshëm ndikon edhe në ndërtimin e një relacioni të afërsisë, ku çdo student ndihet i lirë që në çdo kohë, të pyes apo debatoi me ligjëruesin. Sa i përket ligjërimin, niveli arrihet me përgatitje (punë), dhe atë jo vetëm me përgatitjen akademike të mëhershme por me punë dhe përgatitje të vazhdueshme. Unë kam pasur fatin të punoj në korporata të mëdha dhe të marrë pjesë në projekte të mëdha, kështu që përpos pjesës akademike unë tek studentët mund ta përçoj edhe përvojën time personale.

**UBT News:** Refuzuat ofertat e ligjërimin në institucione të tjera arsimore në vend dhe u ndale vetëm në UBT?

**z. Maxhuni:** Më herët kam ligjëruar në Universitetin Publik të Prishtinës si dhe në Riinvest dhe gjithashtu kam pasur oferta të ligjëroj edhe në disa universitet tjera private, por për shkak të namit të këtij universiteti si dhe të orarit tim të ngjeshur, jam përcaktuar vetëm për UBT-në. UBT në krahasim me institucionet e tjera arsimore është institucion i profilizuar dhe udhëheqës në Teknologjinë Informativë dhe kjo ka qenë arsyeja kryesore pse kam zgjedhur UBT-në.

Sa i përket UBT-së e sidomos departamentit të Shkencave Kompjuterike, mund të them që sistemi ka qenë i një niveli të kënaqshëm, e në vitet që kanë pësuar ka shënuar ngritje të vazhdueshme.

**UBT News:** Ju ligjëroni që pesë vite në UBT. Na tregoni për përparimin dhe ngecjet që janë bërë

në UBT brenda kësaj periudhe? Na trego për nivelin e cilësisë në Departamentin që ligjëroni ju?

**z. Maxhuni:** Në UBT jam i angazhuar që nga viti 2005. Përgjigja rreth cilësisë së UBT-së, por edhe të universiteteve të tjera është e lidhur ngushtë përgjithësisht me sistemin e arsimit në Kosovë. Mendoj se i gjithë sistemi arsimor e sidomos ai i ulët dhe i mesëm duhet të pësoj ndryshime domethënëse. Edukimi dhe arsimimi i gjeneratave të reja duhet të filloi që nga klasat e para të shkollës. Të gjitha qeveritë që nga paslufta, pa përjashtim, arsimin nuk e kanë pasur prioritet. Apo thanë më saktë arsimimi është paraqitur si "prioritet", porse investimet kanë pësuar rënie të vazhdueshme. Besoj se është normale që të investohet në infrastrukturë por pa dyshim investimi kryesor duhet të jetë në kuadro. Në asnjë fushë të jetës nuk duhet të ketë nepotizëm, nuk duhet të ketë mosdije dhe injorancë, por pa pardon në arsim.

Sa i përket UBT-së e sidomos departamentit të Shkencave Kompjuterike, mund të them që sistemi ka qenë i një niveli të kënaqshëm, e në vitet që kanë pësuar ka shënuar ngritje të vazhdueshme. Megjithatë, kjo nuk duhet të na kënaq, por duhet të punojmë dhe angazhohemi edhe më shumë që të kemi mundësi që për studentët të ofrohen kushte edhe më të mira, në mënyrë që në të ardhmen të nxjerrim kuadro të nivelit konkurrues me vendet evropiane. Kosova, në këtë kohë dhe në këto kushte, ka më shumë se kurrë nevojë për kuadro të tilla profesionale.

**UBT News:** A keni ndonjë këshillë për studentët e UBT-së në përgjithësi për vitin 2011, si dhe për vitet që do vijnë?

**z. Maxhuni:** Si ligjërues këshilla ime kryesore për të gjithë studentët është që të studiojnë pa ndërprerë. Në këtë epokë ku burimi i informatës është i pakufishëm, studentët nuk duhet të limitohen vetëm në literaturën e gjuhës shqipe por të shfrytëzojnë, sa të kenë mundësi, materiale edhe

nga studiues të ndryshëm. E vetmja mënyrë si të krijohen kuadro të afta e profesionale është të lexohet literaturë e ndryshme mbi subjektin që studiohet, të analizohen dhe eksperimentohen teori të studiuesve të ndryshëm.

Shikoni, këto ditë tregu i punës edhe është tkurrë paksa, për këtë arsye përgatitja dhe aftësimi profesional kanë rol kyç në këtë treg.

**UBT News:** Ju si ligjërues, si e vlerësoni nivelin e shkencave kompjuterike në UBT?

**z. Maxhuni:** Mendoj që UBT ju ofron studentëve kushte mjaft të mira për të studiuar, megjithatë gjithmonë ka hapësirë për përmirësime. Niveli në Shkencat Kompjuterike gjithashtu është mjaft i mirë edhe pse unë mendoj se duhet të investohet edhe më shumë në infrastrukturë, por me ndërtimin e kampusit të ri universitar edhe kjo çështje do zgjidhet.

### FATOS MAXHUNI

Studimet bachelor i ka përfunduar në Shkenca Kompjuterike në Universitetin e Londrës. Studimet master në Sistemet e Shpërndara i ka përfunduar në Universitetin e Edinburgut. Për rreth katër vite ka punuar në departamentin e Teknologjisë Informativë, në Mercedes-Benz Finance, në Britani të Madhe. Në vitin 2003 është kthyer në Kosovë ku për dy vite ka punuar në departamentin e Teknologjisë Informativë në Ministrinë e Ekonomisë dhe të Financave. Që nga viti 2005 është i punësuar në PTK, fillimisht në departamentin e Drejtorit Ekzekutiv e pastaj në Vala. Në periudhën 2003-2007 ka ligjëruar në Universitetin e Prishtinës. Në Riinvest kam ligjëruar në periudhën 2009/2010. Në Universitetin për Biznes dhe teknologji (UBT) është i angazhuar si ligjërues që nga viti 2005.

### IPKOFUNDATION NË VAZHDIMËSI BASHKËPUNON ME UBT-në

PRISHTINË, 28 MARS 2011 – Përfaqësuesit kompanisë më profitabile në vend si "Ipkofoundation", para studentëve të Universitetit për Biznes dhe Teknologji (UBT), prezantuan mbi projektin për ndarjen e bursave në nivelin universitar.

Gjatë prezantimit ata cekën të gjitha kriteret për marrjen e kësaj shumë si notën mesatare, disa ese të shkruar dhe të përpiluar për vizionin e tyre me theks të veçantë për sektorin e teknologjisë, përvoja e punës së mëhershme etj.

Studentët të cilët do kenë fatin të jenë përfitues të bursave gjatë vitit akademik do kenë aktivitete të shumta si koktej, darka dhe vizita nga vendet më të ndryshme. Vlen të theksohet se në vitin e kaluar përfitues të bursave në fjalë kanë qenë tre student të UBT-së si Anesa Ramaxhiu, Valbona Fejzullahu dhe Arian Agani.

### KOSOVARET KTHEHEN NGA SLOVENIA ME 11 MEDALJE



### STUDENTJA E UBT-së FITOI MEDALJE TË ARTË

Optimizmi i përzgjedhësit të përfaqësueses së Kosovës, Zeqir Bilalli, para nisjes në Slloveni, doli të jetë i saktë, meqë garuesit e tij u kthyen nga ky vend me 11 medalje të fituara (5 të arta, 1 e argjendet dhe 5 të bronzta). Kështu, karateja kosovare është në rrugë të mirë të rikthimit të namit të dikurshëm, veçmas kur dihet se turneu, Grant Prix në Zhalect të Sllovenisë, tuboi 54 klube nga Austria, Hungaria, Kroacia, Sllovenia dhe Kosova, ku për medaljet luftuan hiq me pak se 430 garues, në Katada dhe Kumite. Suksesi i veçantë ishte edhe shpallja e karateistit tonë Alvin Karaçi, për garuesin më të mirë të këtij turneu. Herolind Nishevc i rrëmbeu dy medalje të arta, të dyjat në konkurrencën seniorëve, ndërkohë që edhe Gentina Karpuzi, Fiona Beqiri (seniorë) dhe Alvin Karaçi (juniorë), u bënë pronarë të medaljeve të arta. Rreze Shatri fitoi medaljen të argjenditë, ndërkohë që me medalje të dytë (bronzte), u nderuan edhe Karpuzi e Beqiri. Alvin Karaçi fitoi të argjenditë në konkurrencën e seniorëve, kurse Fiton Ahmeti zuri dy vendet e treta.



# UBT organizon për herë të dytë Garën Evropian të Robotëve që luajnë futboll



Universiteti për Biznes dhe Teknologji (UBT) organizon edhe një aktivitet unik ndërkombëtar. Federata Evropiane e Futbollit me Robotë, pas organizimit me sukses vitin e kaluar, ia ka besuar UBT-së organizimin për herë të dytë me radhë Garës Evropian të Robotëve që luajnë futboll.

Kështu, kjo garë do të mbahet nga 3 - 6 maj 2011, në lokalet e UBT-së në Prishtinë.

Organizimi i këtij aktiviteti shënon edhe një sukses të UBT-së, por njëkohësisht edhe të Republikës së Kosovës, që është shteti i vetëm në Evropën Juglindore ku organizohet, madje për të dytën herë, një aktivitet i karakterit shumë të rëndësishëm ndërkombëtar. Deri tash pjesëmarrjen në Garën Evropian të

Robotëve që luajnë futboll e kanë konfirmuar disa ekipe nga shtetet evropiane, të njohura për aktivitete në fushën e robotëve që luajnë futboll.

#### Vendin tonë e përfaqëson "UBT KOSOVA"

Sikur edhe në kampionatin e kaluar, vendin tonë në këtë garë do ta përfaqësojë ekipi "UBT-Kosova", i cili e ka përfaqësuar Kosovën edhe në kampionate të mëhershme evropiane, përfshirë të në Zvicër e Austri, ku ka shënuar suksese të dalluara.

Me këtë rast, organizatori ka parapa të mbahet edhe një koherencë shkencore për robotik, ku pritet një numër i madh studiues ndërkombëtar dhe vendorë të paraqesin punimet e tyre nga fusha

në fjalë. Në ceremoninë e hapjes dhe gjatë zhvillimeve janë të ftuar të marrin pjesë përfaqësues të institucioneve të Republikës së Kosovës, profesorë e ekspertë vendorë e ndërkombëtarë, përfaqësues të kompanive të ndryshme, përfaqësues të biznesit, studentë e mysafirë të tjerë.

#### Gara organizohet nën patronatin e MASHT-it

Garat Evropiane të Robotëve që luajnë futboll zhvillohen në objektin e Universitetit për Biznes dhe Teknologji në Prishtinë dhe mund të përcillen nga të gjithë të interesuarit. Në këtë rast, kjo garë madhështore organizohet nën patronatin e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT).



## UBT DHE UT ORGANIZOJNË KONFERENCË NË NIVEL BOTËTOR

Universiteti për Biznes dhe Teknologji (UBT), dhe Universiteti i Tiranës kanë organizuar Konferencë ndërkombëtare "Sistemet e informacionit dhe teknologjive, rëndësia e tyre në zhvillimin ekonomik", e cila do të mbahet ka mesi i muajit qershor 2011. Organizator dhe sponsor të

Konferencës në fjalë janë Universiteti për Biznes dhe Teknologji (UBT) dhe Universiteti i Tiranës (UT). Në konferencë do të marrin pjesë një numër i madh i shkencëtarëve nga vendet e ndryshme të botës. Konferenca organizohet në Universitetin i Tiranës, Tiranë.

## PRIVATËT: KONKURRENT NË TREGUN E PUNËS



PRISHTINË, 15 PRILL 2011 -

Me rastin e zhvillimeve të fundit në arsimin e lartë privat në Kosovë, Presidenti i Universitetit për Biznes dhe Teknologji (UBT), Prof. Dr. Edmond Hajrizi, në bashkëpunim me Ministrin a Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), me kënaqësi i ftoi në një takim miqësor dhe të përbashkët të të gjithë bartësve të institucio-

neve private arsimore të vendit. Përfaqësuesit e institucioneve në fjalë më konkretisht diskutua për rrjedhat e fundit në sektorin e arsimit veçanërisht atë privatë, për shpeshimin e kontakteve për të bashkëpunuar në fushat në interes të përbashkët dhe u vendos që një takim më i gjerë të mbahet ditëve në vijim. Takimi u mbajt më 15.04.2011, në lokalin Collection, në Prishtinë.

## VALDRINI: JAM I LUMTUR ME RININË KOSOVARE

BESARTA SHEHU,  
STUDENTE NË UBT

Dukja e jashtme është shumë e rëndësishme te një person e cilësdo moshë qoftë, por ata të cilët më së shumtin bien në sy janë personat e estradës dhe të politikës dhe studentët që e përfaqësojnë botën më të këndshme të vendit tonë, e sidomos kryeqendrën e Kosovës, Prishtinën.

Por nëse shohim vetën që nuk po dukesh dhe ndihesh mirë, ne duhet të trokasim te stilistët, ku për këtë gjë më së miri na këshillojnë ata, dhe me pak këshilla dhe intervenime tjera

ai/ajo, do të ndryshime që do të ndihet mirë dhe rehat edhe në prani të shoqërisë. Vendi jonë ka pas gjithmonë stilistë të mëdhenj, por ka edhe tash.

Në vendin tonë stilistët i frekuentojnë më së shumti ata të cilët i përkasin komunitetit të estradës dhe studentët për mbrëmje të veçanta si të maturës dhe absolventiadës, mirëpo të pakt janë ata nga shtresat tjera etj.

"Studentet duhet të vishen ashtu që ata të ndihen më së miri, dhe më femëra, por asnjëherë banal", thotë stilisti Valdrin Sahiti, për

gazetën "UBT News". Ai më tej shton, se rinisë kosovare i duhet shumë pak punë në kultivimin e shijes dhe kulturë në veshje, përndryshe rina jonë ka shije dhe është i lumtur për një gjë të tillë.

Po ashtu ai cekë: "Unë mendoj se personat të cilët i përkasin estradës vendase dhe politikës janë shumë në trend përbri kohës nëpër të cilën po kalojmë, por ka gjëra për të ndryshuar, por ato vijnë në ndryshimin e rrethanave", thotë ai. Valdrini shton se është i zoti të bëjë ndryshime të çdo person në dukje, por gjithmonë përkrah

personalitetit të tij, andaj të gjithë janë të lumtur sepse më pas ndihen vetvetja.

Valdrin Sahiti, deri më sot ka prezantuar tetë sfilata, në të cilat ka paraqitur fustana të mbrëmjes. Stili i tij është i identifikuar, i cili është ekstravagant dhe klasik. Punon me një sy në të kaluarën dhe një në të ardhmen. Valdrini, mohon të ketë pasur ndonjë bashkëpunim në lëmin profesional: "Me gjithë kolegët kam një miqësi të jashtëzakonshme, mirëpo bashkëpunim profesional nuk kam pasur deri më tani", përfundoi Valdrini.



# TRANSMISIONET ELEKTRIKE

AIDA SPAHIU

Kursimi i energjisë elektrike është një prioritet i lartë në Strategjinë Kombëtare të Energjisë të Shqipërisë, me përfitime të dukshme financiare. Në Strategjinë Kombëtare të Energjisë janë përcaktuar drejtimet kryesore për zhvillimin e një sistemi të sigurtë energjetik, mbështetur në parimet e tregut, për plotësimin e kërkesave për energji për konsumatorët me kosto minimale, duke patur në konsideratë sigurinë e furnizimit, mbrojtjen e mjedisit dhe përmirësimin e mirëqenies së popullatës.

Në Strategjinë Kombëtare të Energjisë theksohet nxitja e përdorimit eficient të energjisë, ekonomik dhe me ndikim minimal në mjedis, në mënyrë të tillë që sektori energjetik të jetë një sektor mbështetës për një zhvillim të qëndrueshëm të të gjithë sektorëve të tjerë ekonomik dhe shoqëror.

Shqipëria e ka të vështirë të plotësojë kërkesat për energji elektrike si dhe një furnizim të sigurtë me energji për shkak të luhatjeve të reshjeve. Energjia elektrike në Shqipëri pothuaj në 99 % të saj prodhohet nga hidrocentralet, duke bërë kështu prezent rrezikun e sigurisë së furnizimit të vazhdueshëm me energji elektrike. Sistemi ynë energjetik ka varësi totale nga moti. Kështu në një vit të thatë, për shembull viti 2007, ka një rritje të konsiderueshme të importit të energjisë, siç tregohet qartë nga figura e mëposhtme.

Egzistojnë dhe faktorë të tjerë të kufizojnë furnizimin e sigurtë me energji elektrike si numri i kufizuar i linjave të interkonjeksionit në rajon, kapaciteti i pamjaftueshëm gjenerues i energjisë elektrike për të përballuar kërkesën në rritje të energjisë elektrike në vend, mungesa e eficiencës në furnizimin me energji. Të gjithë këta faktorë çojnë në ndërprerjet e shpeshta në furnizimin me energji, duke sjellë pasoja në zhvillimin ekonomik të Shqipërisë.


Prandaj një kWh i shfrytëzuar si duhet është një nga mënyrat më të mira për kursimin e energjisë elektrike dhe për të rritur sigurinë



e furnizimit me energji elektrike. Një drejtim i rëndësishëm që siguron kursime të konsiderueshme të energjisë elektrike dhe ulje të konsumit të saj në sektorin industrial dhe atë rezidencial është përdorimi i transmisioneve elektrike me rendiment të lartë.

Transmisionet elektrike me rendiment të lartë përbëhen nga motori elektrik me rendiment të lartë në vend të atij standart, shndërruesi statik, i cili e ushqen motorin elektrik me frekuencë dhe tension të ndryshueshëm (sot më të përdorshmit janë PWM-VSI, CSI) dhe ngarkesa mekanike në bosht të motorit. Si ngarkesë mekanike në bosht kemi sistemet e kompresimit të ajrit, pompimit apo sistemet e ventilimit, që përbëjnë rreth 60% të ngarkesave në transmisionet elektrike. Përdorime të tjera të rëndësishme të transmisioneve elektrike janë vinçat, ashensorët, mullinjtë, përzierësit, konvejerët etj.

Për të patur kursim të energjisë elektrike duhet të optimizohet i gjithë transmissioni elektrik. Kursimet më të mëdha të energjisë i përftojmë duke zëvendësuar motorët standartë me ato me rendiment të lartë si dhe përdorimi i shndërruesve statik për rregullimin e shpejtësisë së motorëve elektrik, kursim i cili varijon nga 12%-58%. Vlen të theksohet se kemi kursime të rëndësishme të



energjisë elektrike, duke mbajtur parasysh kostot e motorit elektrik dhe shndërruesit statik gjatë gjithë kohës së tyre të punës.

Transmisionet elektrike konsumojnë rreth 65% të energjisë elektrike të përdorur në industri në vendet e Bashkimit Europian. Kështu përdorimi i transmisioneve me rendiment të lartë në vend të atyre standart mund ti kursejnë vendeve Europiane deri në 202 miliard kWh energji elektrike në vit ose 29% të energjisë së konsumuar nga sektori industrial, kursim i cili është ekuivalent me zvogëlim 10 miliard EUR të kostove të punës në industri. Kjo shifër tregon një kursim potencial të energjisë elektrike me më shumë se 7% të konsumit të energjisë elektrike të vendeve Europiane. Gjithashtu kjo tregon një kursim të madh të energjisë elektrike duke patur parasysh një kohë të arsyeshme vetshlyerje të këtyre transmisioneve 1.5-3 vjet. Ky kursim apo ulje e konsumit të energjisë elektrike sjell dhe përfitime të tjera si:

- një kursim (5-10) miliard EUR në vit për kostot operative në industrinë Europiane nëpërmjet zvogëlimit të kostove të mirëmbajtjes dhe përmirësimit të proceseve të punës;
- një kursim rreth 6 miliard EUR në vit për Europën në zvogëlimin e kostove mjedisore

• zvogëlim prej 79 milion ton emetim të CO2 ose afërsisht një e katërta e targetit të Protokollit të Kyoto-s për vendet Europiane.

• zvogëlim prej 45GW e nevojës për energji elektrike në rreth 20 vjet

Përdorimi i transmisioneve me rendiment të lartë sjell dhe përfitimet jo energjetike siç janë:

kontrolli më i mirë i proceseve të punës, zvogëlim i dëmtimeve - produkteve skarco, përmirësim të cilësisë së produkteve.

Prandaj kompanitë, të cilat investojnë për kursimin e energjisë duke përdorur transmisionet me rendiment të lartë, përfitojnë dhe në mënyrë indirekte.

Aplikimi i transmisioneve me rendiment të lartë has në disa vështirësi, të cilat janë: koha e vetshlyerjes konsiderohet e gjatë për disa aplikime, mbidimensionim i transmisionit për shkak të mos njohjes së karakteristikave mekanike të ngarkesës, vështirësi në përcaktimin e rendimentit të plotë të transmisionit elektrik, shkurtimi i kapitaleve për investime në kushtet e krizës globale etj.

Drejtimet kryesore për kapërcimin e këtyre vështirësive janë: përmirësimi i legjislacionit: klasifikimi dhe etiketimi i transmisioneve elektrike që shiten si njësi të integruara, zbatimi i skemave të detyrueshme të auditimit etj; informimi dhe edukimi: publi-

AIDA SPAHIU

E lindur në Elbasan, Shqipëri, në vitin 1966. Ajo ka marrë titullin Inxhinierë Elektrike në Industri në vitin 1989, në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike të Universitetit Politeknik të Tiranës. Gradën shkencore "Doktor i Shkencave" e ka marrë në vitin 2004 me temën: "Teknikat e projektimit të rregullatorëve FUZZY dhe SLIDING MODE për transmisionet elektrike", nga Universiteti Politeknik i Tiranës. Gjatë këtyre viteve Aida ka dhënë mësim në lëndët e Makinave Elektrike, Transmisioneve Elektrike dhe Konstruksioneve Elektromekanike, që zhvillohen në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike. Aktualisht Aida është përgjegjëse e Departamentit të Automatikës në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike. Puna e saj kërkimore shkencore është në fushën e transmisioneve elektrike me saktësi të lartë, e cila përfshin studime mbi proceset kalimtare, gjendjeve dinamike, simulimin e modeleve të ndryshme etj. Me qëllim kusimin e energjisë elektrike nëpërmjet aplikimit të tyre. Ajo është autore e publikimeve në Konferenca Ndërkombëtare dhe e artikujve shkencorë në këtë fushë kërkimore.

kime dhe seminare të ndryshme me palët e interesuara; mbështetja financiare: për blerësit e transmisioneve elektrike me rendiment të lartë, mbështetja e kërkim-zhvillimit për prodhuesit.

**Teksti i cekur më lartë është përmbledhje e punimit shkencor që autorja në fjalë e ka prezantuar në "SWISS 2010 Workshop on Supplemental Ways for Improving International Stability", të mbajtur në Prishtinë, në UBT, gjatë muajit nëntor 2010.**

## PRESIDENTI I UBT-së LIGJËROI NË FSK

PRISHTINË, PRILL, 2011 —

Me ftesë të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), Presidenti i Universitetit për Biznes dhe Teknologji (UBT), Prof. Dr. Edmond Hajrizi gjatë këtyre ditëve ka organizuar disa ligjëratë para pjesëtarëve të FSK-së me temën si: Menaxhimi dhe Simulimi, Menaxhimi i Informacionit, etj. FSK ka shprehë

nevojën e bashkëpunimit me UBT-në për aplikimin e njohurive shkencore, kështu u patë nënvizuar gjatë nënshkrimit të marrëveshjes për bashkëpunim ndërinstitucional.

Presidenti i UBT-së, z. E. Hajrizi ka shprehë gatishmërinë e ofrimit të një përkrahje adekuate për FSK-në, si në aspektin akademik, shkencorë etj.





# NJOHURITË E FITUARA NË UBT PO I ZBATOJ NË BIZNESIN FAMILJAR

Të mirëseardhur janë studentët e UBT-së si për të na vizituar e po ashtu edhe për praktikë, dhe unë mendoj se është një dobi e përbashkët për të mësuar dhe arritur diçka më shumë - thotë Flori Gagica, menaxhere në hotel "Jehona"

VEPRIM MUSTAFA & SUAD EUJPI, STUDENTË NË UBT

"Njohurit që kam fituar gjatë studimeve themelore në UBT, në fushën e menaxhimit nga profesorët e UBT-së, të cilët kanë dhënë kontribut të pakursyer gjatë gjithë kohës, po i zbatoj në menaxhimin e hotelit", thotë Flori Gagica, e cila është në përfundim të studimeve në UBT, në Fakultetin Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi, e cila njëkohësisht menaxhon një hotel shumë të njohur në vendin tonë, Hotel "Jehona" në Dardanë - ish Kamenicë.

Hoteli në fjalë punën e ka filluar në vitin 2006, dhe sot ka mbi 30 punëtorë dhe çdo punëtor shkelqen në punën që bënë. Po ashtu, janë të kënaqur edhe konsumatorët me shërbimin që u ofrohet. "Pse vijë dy herë së paku brenda javës në këtë hotel sepse ndihem shumë komod, ka ushqim shumë të mirë, pastërti, punëtorë të zellshëm dhe bëjnë shërbim preciz etj", thotë Burim Myftari.

Gjatë një vizite që ia bëmë hotelit të përmendur, takuam shumë mysafirë vendorë dhe ndërkombëtar. Në një sallë



mbahen seminare dhe trajnime të ndryshme që organizohen nga OSCE-ja e USAID-i, por ka edhe salla të zbukuruar për dasma e ahengje të tjera.

Po ta shikojmë si nga ana e jashtme dhe e brendshme hotelin në fjalë shihet që është bërë investim i madh. "Investimet asnjëherë nuk i kemi ndaluar, tani kemi filluar t'i ndërtojmë verandat afër pyllit ngase objekti gjendet në periferi të qytetit, ndërsa

tani pritet të fillojmë punën e ndërtimit të një diskoteke të hapur", thotë menaxheria e hoteli në fjalë. Studentët ndërmjet veti, në bashkëpunim me profesorët dhe menaxhmenti e UBT e kanë traditë të ndihmohen ndërmjet veti si në shpjegim, në punësim në udhëtime të ndryshme etj, dhe F. Gagica, dhe më tej shprehte se për studentët e UBT-së, për punë praktike ose për punësim sezonal janë të mirëseardhur. "Të

mirëseardhur janë studentët e UBT-së, si për të na vizituar po ashtu edhe për punë praktike dhe mendojmë se është një dobi e përbashkët për të na mësuar dhe arrit diçka më shumë".

Hoteli është shumë luksoz, i llojit të lartë dhe më ushqim të gjitha llojeve pa lënë anash edhe ushqimin tradicional. "Që nga fillimi i punës hotel "Jehona" ka ofruar mëny shumë të begatshme, ku konsumatorët janë

përherë të kënaqur me mënyrë të cilat në u ofrojmë si, ushqime vegjetariane, nga skara, nga furra, ushqime tradicionale, evropiane, ëmbëlsira të llojeve të ndryshme, pije joalkoolike dhe alkoolike, e kështu me radhë", përfundoi ajo.

Hoteli në fjalë është i projektuar nga arkitekt të njohur, ashtu që është i përshtatur me pozitën ku gjendet në periferi të Dardanes që është i rrethuar me gjelbërim dhe pyje.

## TRE AUTORË BOTOJË NJË STUDIM

"Internal Perspectives of Market orientation: Case of Central Public Organizations in Kosovo", studim shkencore nga fusha ekonomisë, të botuar në revistën shkencore "Internacional studies". Autorët e tekstit në fjalë janë si: Fisnik Bytyqi, Nazmi Zeqiri, Vyrtyt Hasani. Njëri ndër autorët e tekstit si Nazmi Zeqiri është mësimdhënës në UBT në Fakultetin MBE.



## Doli libri Politika e zhvillimit rajonal



Gjatë këtyre ditëve ka dalë nga shtypi libri më i ri në vend nga fusha e ekonomisë "Politika e zhvillimit rajonal", autorit Prof. Dr. Musa Limani. Autori i librit është edhe dekan në Fakultetin MBE në UBT.



TOP EDUCATION  
FOR  
TOP STUDENTS



## FLUIDI EDHE ME "PURE-PACK" E "TETRAPAK"

"Prej fillimit të punës së fabrikës dhe daljes në treg më lëngjet që ofron fabrika kurrë nuk kemi pas problem me konsumatorin, bile gjatë muajve të sezonit të verës arrijmë ta dyfishojmë numrin e shitjes, sepse në treg gjithmonë kemi qenë si kompani serioz", tha pronari i kompanisë Fluidi, Ismet Mustafa

FIDAN BUJUPI-RESMIJE HAJRE-DINI, STUDENTË NË UBT

Fabrika Fluidi gjendet në Gjilan dhe ka një sipërfaqe toke mbi tre hektarë. Kjo fabrikë sadopak ka arrit ta zbusë papunësinë në komunën e Gjilanit duke punësuar mbi 80 punëtorë brenda fabrikës dhe punëtorët tjerë në terren, të cilët janë të profleve të ndryshme që janë profesionale për punën që e bëjnë si inxhinierë, laborantë, teknologë, ekonomistë, etj., dhe bashkërisht kanë bërë që kjo kompani të arrijë majat e sukseseve afariste të kësaj lëmie ndër ne e më gjerë. Prodhon lëngje të cilat janë të njohura në hapësirat e gjëra rajonale. Kualitetin e prodhimeve të kësaj kompanie e siguron kuadri profesional i specializuar i kohës, si dhe teknologjia më bashkëkohore italiane dhe gjermane. Në fakt, lëngjet e kompanisë "Fluidi" janë në treg prej viti 1994, dhe prej këtij viti deri më sot në këtë kompani janë bërë investime të shumta dhe sot kjo kompani rangohet në radhën e kompanive me renome ndërkombëtare, gjë që këtë e dëshmon me sigurimin e licencës për prodhimin e pijeve "Rc cola", të kompanisë amerikane të njohur në botë "Royal Crown Cola International" nga Columbus, shteti Gjeorgjia e SHBA-ve, me të drejtë prodhimin, distribuimit në shtetet e rajonit tonë, përkatësisht në Kosovë, Shqipëri, Mat të Zi, Serbi dhe në Maqedoni.

# RC COLA - ENERGJI, FRESKI ME SHIJE QË KËNAQ

Nuk di, por prej se ka dalë në treg arsikolla, kurrë më nuk jam shërbye me pije tjetër, sepse kjo pije ka shije shumë të mirë që të kënaq e të freskon shpirtin.

Kalimthi e takuam një qytetar të moshës së re më plot shishe të pijes "Rc Cola", dhe prej kureshtjes e pyetëm për këtë pije: "Nuk di, por prej se ka dalë në treg arsikolla, kurrë më nuk jam shërbye me pije tjetër, sepse kjo pije ka shije shumë të mirë, se kjo të kënaq e të freskon shpirtin", tha Labinoti. Po ashtu edhe shitësit e markeve të ndryshme flasin për pijet në fjalë edhe ata lëvdërohen me këtë fabrikë, e cila ofron këto pije si: Rc Cola, Red Rain, Jaffa Champion, Fluidi, Orient Emporium, Relax Aqua ujë natyral i gazuar me minerale dhe pije energjike, qajna shege dhe çaj pjeshke, etj. Për prodhimet vendore konsumatori ynë heziton, por për këto pije siç janë të renditura me radhë, e dinë që janë vendore dhe blen pa u kursyer, bile bindshëm them, se janë ndër pijet më të shitura në marketin tonë". Po ashtu edhe Besa, e cila që disa vite radhazi punon në marketin e njëjtë thotë se konsumatori është i njoftuar dhe ka besim në këto pije.

Po ashtu edhe njëri ndër pronarët e fabrikës shprehet se është i kënaqur më lëngjet që i ofron në tregun e brendshëm dhe të jashtëm dhe orientimi i kompanisë dhe puna e tij është t'i shërbej konsumatorit vendor dhe të huaj në mënyrë sa më serioze.

"Prej fillimit të punës së fabrikës dhe daljes në treg më lëngjet që ofron fabrika kurrë nuk kemi pas problem me konsumatorin, bile gjatë muajve të sezonit të verës arrijmë ta dyfishojmë numrin e shitjes, sepse në treg gjithmonë kemi qenë si kompani serioz", tha pronari i fabrikës "Fluidi", Ismet Mustafa.

**Red Rain - cilësi e veçantë në rajon**  
Siç po shihet kompania "Fluidi" ka

dëshmuar vetën fuqishëm si në pikëpamje profesionale e menaxhuese, ashtu edhe në tekniko-teknologjike për aftësitë e saj të prodhimit të lëngjeve me brend të licencuar sipas kërkesave dhe standardeve ndërkombëtare. Pas mbushjes së "Rc Colës", e cila pije sot është e pozicionuar shumë mirë në treg, dhe më tutje kjo kompani filloi edhe me prodhimin e pijes së famshme energjike "Red Rain" si asortiment i ri në programin e shijes "Rc Cola", e cila për konsumatorët tanë zgjoi interesim të madh, duke u vlerësuar me të drejtë si cilësi e veçantë në rajon.

**Të vetmit me qaj shege dhe çaj pjeshke**

Po ashtu, investimi që është bërë kohëve të fundit është linja e prodhimit të lëngjeve prodhuese Italiane, tok me linjën e fryerjes së shisheve PET të prodhuesit francez, që janë të ndërlidhura mes veti me kapacitete prodhuese krejtësisht automatike e që konsiderohet si teknologjia më e përsosur dhe më e avancuar e kohës. Njëherësh, prodhon edhe dy lloje të çajit të ftohtë jo vetëm për tregun tonë por edhe për atë të Ballkanit dhe të Evropës, fjala është për qaj shege dhe për çaj pjeshke.

Kompania në fjalë për momentin i prodhon dhe i ka në treg këto pije: "Rc Cola", "Red Rain", "Fluidi",

"Orient qaj, "Relax Aqua" dmth ujë natyral i gazuar me minerale, pija energjike Double force dhe Jaffa Champion, etj.

Po ashtu në këtë vit, në kompanin "Fluidi" janë bërë investime të mëdha në të gjitha aspektete dhe siç thotë Mustafa, ai shprehet i kënaqur në përgjithësi me të arriturat e fabrikës që janë bërë deri më sot, dhe si risi për konsumatorin vendor dhe të huaj. Kjo fabrikë sjell edhe disa lëngje frutash me shije të re si, "Pure-pack" dhe "Tetrapak".



## PRESIDENTI I UBT-SË, E. HAJRIZI VIZITOI UNIVERSITETIN E CAMBRIDGE

PRISHTINË, MARS 2011 -

Presidenti i Universitetit për Biznes dhe Teknologji (UBT), Prof. Dr. Edmond Hajrizi, gjatë këtij muaji për disa ditë më radhë ka qëndruar në Angli dhe ka zhvilluar një mori takimesh me personalitete të botës akademike

dhe institucioneve tjera. Ndaj më këtë rast vlen të theksojmë takimin dhe vizitën në University of Cambridge. Takimi u realizua me qëllim që një të ardhme të afërt të arrihet një mirëkuptim ndërinstytucional nga bota shkencore dhe akademike, në

mes dyja institucioneve, po ashtu u diskutua për studime, projekte, ndërlidhje dhe praktika të përbashkëta etj.

Sipas palëve, bashkëpunimi ndëruniversitar në mes UBT dhe University of Cambridge do arrihet brenda një kohë të shkurtër.





# URBAN MANAGEMENT IN KOSOVA AND POLICY OPTIONS



Dr. Binak **Beqaj**

The new vision of urban management will be considered not completed if there are not sustainable relations between knowledge and policy in relation with citizen's wants and needs. Analysing the exciting situation of urban planning in Kosovo in comparison with Euro-Perspective; having into a consideration: planning concepts, goals and political options, relevant issues can be opened for discussion:

How to understand urban management as scope of processes supported by different structured activities?

Long-term success of urban management is possible only if responsible institutions can offer competitive advantages, if they can build up reliable and trustful relationships with their citizens through clear definition of vision, strategy, and actional capacities.

Identified strengths of actual situation: Use of existing level

of experience in Kosovo .Use of experience from respective international organizations Legislative base approved. International urban planning principles implemented. Regional integrative approach. High amount of incomes from community of our migrants. Huge request for investments.

Identified weaknesses of actual situation: Lack of continual urban planning .Municipal urban plans not drafted in time as legislation has foreseen. Lack of developed urban infrastructure in urban areas. Not satisfied amount of budget allocated. Low incomes, non-employment and poverty growing up.

Analyzing existing situation about urban developments in some of Municipalities in Kosovo about urban developments, results shows that there are some issues which needs consistent and emergency treatment

Validity of data and information's is very low because Kosovo didn't have registration of population for more than 30 years, so, the logical question is: Did institutions in Kosovo develop

any statistical survey to confirm validity of presented data and information's?

Based on the structure of the population the relevant fact which should be considered is the fact that most of the population mainly are living in rural areas or surroundings of the cities, so, the logical question raised is: What about urban planning of rural areas and informal settlements around urban areas?

Another issue treated is related to coefficient of economical development of Municipalities, for most of them this coefficient is very low, so, the logical question raised is how to secure budget for planning and implementation?

Very important issue is about urban planning priorities of those municipalities, it is clear that none of them doesn't harmonise any development platform based on real needs and real possibilities, so, the logical question is: How to secure an integrated management of this process from design to implementation?

Coming question is: Are there institutional mechanisms ade-

quate for the process, established until now? Results shown are telling that there is not well determined hierarchy (horizontally nether vertically) which will facilitate authorities to deal with actual developments and strategies.

The question related to issue of determining competitive advantages of each Municipality on urban planning is next very important issue which needs adequate prioritization on policy agendas; because identifying possible advantages means that there is a key element of integrated approach to urban planning processes.

For many urban areas, development pressure from areas in neighbourhoods is becoming a problem, because of that it is important to work together for determining a sustainable planning and management of rapid urban increase.

Uncontrolled developments will affect increase of private transport, energy expenses, expensive infrastructure and services, low level- quality of envi-

ronment. So the question will be if there are enough capacities to deal with preventive measures avoiding urban chaos?

Based on mentioned above the conclusion is that policy options should be considering two kinds of project classification:

- Reactive/aiming to solve exciting problems and
- Proactive/aiming to change exciting situation and avoiding problems in future.

Improvement of coordination between the various actors in the process is needed, so, that sustainability and quality should become hallmarks of the urban future in Kosovo.

**Autori është alumni i UBT-së, ligjërues, drejton departamentin e Fakultetit të Arkitekturës dhe drejtor për çështje akademike në UBT. Kjo ese është përmbledhje e punimit shkencor që autori ka prezantuar në "SWIIS 2010 Workshop on Supplemental Ways for Improving International Stability", të mbajtur në Prishtinë, në UBT, gjatë muajit nëntor 2010.**

## ORKESTRIMI I UEB SERVICEVE NË INXHINIERINË SOFTUERIKE TË ORIENTUAR KAH SHËRBIMET



Arian **Celina**

Uebseriset janë të njohura për botën e teknologjisë informative që një kohë relativisht të gjatë. Kohëve të fundit, me avancimin e teknologjisë dhe përhapjes së internetit, përdorimi i tyre filloi të përhapet në mënyrë shumë të shpejtë. Shumë gjigantë të industrisë së softuerit (Google, Microsoft, Amazon, etj.) filluan që t'i publikojnë shërbimet e tyre në formë të uebserviceve në mënyrë që ato të mund të konsumohen nga aplikacione dhe klientë të ndryshëm. Me përhapjen kaq të gjerë të uebserviceve dhe teknologjive për zhvillimin e

tyre, mundësitë për konsumimin e tyre u rritën. Njëra nga mundësitë e konsumimit është edhe orkestrimi i uebserviceve. Orkestrimi i uebserviceve është proces në të cilin duke përdorë ndonjë gjuhë të orkestrimit zhvillues e përcakton rendin dhe rrjedhën e ekzekutimit të një apo më shumë uebserviceve dhe rregullat e komunikimit ndërmjet tyre, dhe si rezultat i një orkestrimi del një uebservis tjetër, i cili e paraqet procesin e orkestruar si një funksion të vetëm. Orkestrimi ka filluar të fitoj rëndësi të madhe me përhapjen e uebserviceve. Ekzistojnë dy forma kryesore të konsumit të uebserviceve. Mund të shkruhet një kod burimor me ndonjë gjuhë programuese (p.sh. Java, C#, PHP, etj.) dhe duke përdorur

gjuhën programuese të thirrren uebserviset dhe të përcaktohet komunikimi ndërmjet tyre dhe mund të përdoret një gjuhë e orkestrimit të uebserviceve dhe duke i përdorur rregullat e asaj gjuhe specifikohet rendi dhe rrjedha e ekzekutimit të uebserviceve dhe përpunimi i mesazheve të komunikimit.

Orkestrimi mund të përdoret për shumë gjëra, por çfarë benefite na sjellë? Përdorimi i orkestrimit të uebserviceve a do të e shpejtoj punën e zhvillimit të funksionalitetit të një aplikacioni? Ekzistojnë disa gjuhë të orkestrimit që mund të përdoren për orkestrim, si p.sh. BPEL, BPML, XLANG, WSCI, etj. Për t'iu përgjigjur pyetjes se parashtruar, në hulumtimin e bërë është zgjedhur gjuha

BPEL. Por, për ta përdorur këtë gjuhë, nevojitet një softuer i cili mundëson që të shkruhet orkestrimi në formë me të kuptueshme për syrin e njeriut, pasi shkrimi i një orkestrimi pa ndihmën e ndonjë softueri është punë e lodhshme dhe e prirë për gabime. Për qëllime të këtij hulumtimi, është shkruar një softuer i quajtur WSComposer, i cili ka mundësuar që duke përdorë vetëm aplikacionin të krijohen orkestrimet në mënyrë të lehtë. Pasi që është zhvilluar aplikacioni, ai iu është dhënë dy grupeve punuese që ta testojnë përdorimin e tij, dhe është matur koha e krijimit të katër skenarëve të orkestrimit duke përdorur gjuhën programuese C# dhe duke përdorur WSComposer. Rezultatet e hulumtimit

kanë treguar që, në rastet kur orkestrimi ka kërkuar ekzekutim paralel të degëzimeve të procesit, shkrimi i një orkestrimi me WSComposer është bërë për 173%, me shpejtësi se duke përdorur gjuhën programuese C#. Orkestrimi i uebserviceve gjen zbatim të gjerë në industrinë financiare, te telekomunikacionit dhe në industritë tjera.

**Autori është mesimdhënës në Fakultetin Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri në UBT, dhe eseja cekur më lartë është përmbledhje e punimit shkencor që autori në fjalë e ka prezantuar në "SWIIS 2010 Workshop on Supplemental Ways for Improving International Stability", të mbajtur në Prishtinë, në UBT, gjatë muajit nëntor 2010.**

BISEDË ME PROF. DR. AZIR JUSUFI, LIGJËRUES NË FAKULTETIN E SHKENCAVE KOMPJUTERIKE DHE INXHINIERISË NË UNIVERSITETIN PËR BIZNES DHE TEKNOLOGJI

# UBT-ja - VËRTET ËSHTË INSTITUCION I ARSIMIT TË LARTË

Mundësitë që i ofron UBT-ja gjatë periudhës së studimeve, e sidomos kontaktet në trekëndëshin student-mësimdhënës-staf menaxherial, janë në nivel të lartë, gjë që u mungon Universiteteve publik - thotë prof. dr. Azir Jusufi

KRENAR ASLLANI & ARLIND DINA, STUDENTË NË UBT

**UBT News: Keni pas ofertë edhe nga universitete tjera të shkoni si mësimdhënës, çfarë ju ka shtyrë që të bëheni pjesë e UBT-së dhe cilat janë përshtypjet e juaj?**

**Prof. Jusufi:** Kam qenë i angazhuar si mësimdhënës nëpër disa universitete nëpër Maqedoni. Por, unë që në fëmijëri jam shumë i lidhur me Prishtinën. Këtu vazhdon të jetoj një pjesë e familjes time, prandaj ka qenë synimi im që të vendosem në Prishtinë. Pas një opinioni që mora për universitetet në Prishtinë, unë vendosa të vijë këtu dhe të takohem me prof. dr. Edmond Hajrizin, të cilin e përgëzoj për themelimin e këtij Universiteti modern dhe cilësor në mes të këtij Ballkani të trazuar.

Në UBT unë gjeta institucionin e vërtetë të arsimit të lartë, këtu unë gjeta mundësitë e organizimit të ligjëratave në kushte më bashkëkohore. Siç shihet në UBT dhe posaçërisht në Departamen-

AZIR JUSUFI

Është ligjërues i lëndëve Matematika I, II si dhe Strukturat Diskrete I, II, në Fakultetin e Shkencave Kompjuterike dhe Inxhinieri në Universitetin për Biznes dhe Teknologji (UBT). U lind në Kërçovë të Maqedonisë. Studimet i ka përfunduar në Universitetin e Tiranës më 1998, Fakultetin Matematikë, magjistraturë në Universitetin e Prishtinës në Fakultetin e Shkencave Matematikore-Natyrore, kurse gradën shkencore, doktor i shkencave e ka mbrojtur në Fakultetin e Inxhinierisë Matematike të Universitetit Politeknik të Tiranës, në vitin 2009. Është pjesëmarrës në disa konferenca shkencore ndërkombëtare dhe ka bërë disa publikime nëpër revista shkencore ndërkombëtare.

tin e Shkencave Kompjuterike, stafi menaxherial po kujdeset shumë për mbarëvajtjen e procesit arsimor-shkencor.

**UBT News: Çfare është niveli i studentëve në departamentin ku ligjëroni ju?**

**Prof. Jusufi:** Unë jam i kënaqur me nivelin e të nxëniet të diturive nga ana e studentëve, me seriozitetin që ata i qasen mësimin dhe angazhimeve plotësuese gjatë semestrave. Unë gjatë semestrit përdori standardet



e procesit të Bolonjës. Për shlyerjen e këtyre detyrimeve, studentet tregojnë një interesim të veçantë. Përsosmëria është diçka absolute, prandaj ngelet që studentët të tregojnë angazhim dhe interesim akoma më të madh në përgatitjen e tyre profesional.

**UBT News: Cilat janë përparësitë e UBT karshi Universitetit publik?**

**Prof. Jusufi:** Në UBT, si studentëve ashtu edhe mësimdhënësve (të përzgjedhur nga vendi dhe jashtë) u mundësohet të jenë në qendër të vëmendjes të stafit menaxherial. Këtu kushtet hapësinore, laboratorike dhe argëtuese, që i ofrohen studentëve, nuk besoj se i gjejmë në universitetet publike. Mundësitë që i ofronë UBT-ja, gjatë periudhës së studimit, kontaktet në trekëndëshin student-mësimdhënës-staf menaxherial, janë në nivel të lartë, gjë që u mungon universiteteve publike. Këtu grupet



studimore përbëhen nga një numër jo shumë i madh i studentëve, gjë që mundëson që studenti të vijë në shprehje gjatë mësimin.

**UBT News: Planet e juaj për vitin 2011?**

**Prof. Jusufi:** Përveç përmbylljes me sukses të procesit mësimor në

UBT, në plan për këtë vit kam që të përfundoj një tekst mësimor, të cilin e kam në përfundim, kam edhe dy punime shkencore të cilat kanë ngelur të pa përfunduara dhe dërgimi i tyre për botim. Pjesëmarrja në ndonjë konferencë shkencore, nuk besoj që do më ik.



## PRESIDENTI I UBT-së E. HAJRIZI MORI PJESË NË KONFERENCËN VJETORE TË IPMA-së

Prishtinë, Mars 2011 —

Presidenti i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, gjatë muajit mars po të këtij viti zhvilloi një sërë takimesh nëpër Evropë e më gjerë, me personalitete të institucioneve universitare dhe tjera.

Më theks të veçantë vlen të veçohet pjesëmarrja e tij në konferencën dhe takim vjetor të Organizatës për Menaxhimin e Projekteve (IPMA) që u zhvillua në Riga të Lituanisë.

Të gjitha shtetet anëtare në IPMA si SHBA, Gjermani, Austria, Kosova që përfaqësohet nga Presidenti i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi dhe përmes institucionit që drejton etj, gjatë konferencës të gjithë me hulumtimet e tyre më shumë u fokusuan që të punojnë dhe të avancojnë një model të ri

të standardeve për vlerësimin e kompetencës në menaxhimin e projekteve.

Nga konferenca në fjalë përfaqësuesit e Serbisë edhe kësaj radhe e kundërshtuar anëtarësimin e Republikës së Kosovës përmes UBT-së në këtë institucion.

Përfaqësuesit e Serbisë e patën kundërshtuar anëtarësimin e Republikës së Kosovës përmes UBT-së në këtë institucion, si dhe kanë protestuar ndaj pjesëmarrjes së dr. Hajrizit në konferencë edhe në vitin 2009 të mbajtur në Dablin të Irlandës.

Ta ndërlihim edhe një informacion se Kryetari i Komitetit Ndërkombëtar, Y Hans Knoepfel në takimin e vitin të kaluar përveç të tjerave si rend dite zyrtarisht

para të pranishmëve i a dorëzoi vendimin e IPMA-së z. Edmond Hajrizit dhe e shpalli si asesori (vlerësuesi) i parë i akredituar nga IPMA në Kosovë dhe në gjithë trevat shqip folëse për menaxhimin e projekteve.

Ta theksojmë edhe njëherë se në Organizatën për Menaxhimin e Projekteve (IPMA), Kosova sot është e anëtarësuar në këto organizmat më të mëdha botërore, pikërisht përmes Presidentit të UBT, z. Hajrizi.

IPMA është organizatë në nivel botërore në fushën e Menaxhimit të Projekteve, e cila certifikon menaxherët e projekteve, krijon ekipe për menaxhimin e projekteve dhe hulumtues të suksesshëm, si dhe nxjerr publikime të ndryshme lidhur me menaxhimin e projekteve.



# SI U KRIJUA INTERNETI?

AMIR ASLLANI,  
STUDENT NË UBT

Shpikja më e madhe e njerëzimit, pas rrotës e zjarrit është interneti, i cili po transformon gjithnjë e më tepër jetën e njeriut. Ky transformim është shumë i rëndësishëm, duke u bërë një përdorim i domosdoshëm i njeriut, ashtu si një kafe e mëngjesit.

Interneti prej viteve mundëson komunikimin e shpejtë të individëve, organizatave, mediave, qofshin të dëgjua apo të shkruara, duke u kthyer në enciklopedinë më të madhe të botës moderne.

## Fillimi

Fillimi i internetit i përket viteve të 60-ta, si përpjekje e ushtrisë amerikane për t'u lidhur me rrjet (network), e cila bazën e saj e ka në Amerikë. Më pas, rrjeti u përhap, duke nisur me universitetet, ku më vonë ato shërbyen si ISP për studentët dhe profesorët. Kjo bëhet me qëllim të një shkëmbimi sa më të madh të informacionit. Rreth viteve të 70-ta, filloi dhe komercializimi i internetit, duke u përdorur vetëm posta elektronike, që në atë kohë ishte një shërbim tepër i kushtueshëm.

## Si u krijua interneti?

Zanafilla e idesë për ndërtimin e rrjetit, që për ne është i njohur me emrin "internet", rrjedh nga koha e Luftës së Ftohtë në vitet e 60-ta. Si iniciatorë të këtij rrjeti janë strukturat ushtarake të SHBA-së. Në fillim të viteve të 60-ta, ushtarakët amerikanë mendonin se si t'i mbronin informacionet e tyre në rast të ndonjë sulmi atomik nga kundërshtarët. Si zgjidhje më të mirë të këtij problemi ishte një rrjet elektronik. Në këtë rrjet duhej që të njëjtat të dhëna të regjistroheshin dhe të shpërndaheshin nëpër kompjuterët që ndodheshin në distancë. Në rast të ndryshimeve të këto të dhëna, duhej që ndryshimet të bëheshin në të gjithë kompjuterët e lidhur



në atë rrjet. Secili nga kompjuterët e lidhur duhet të komunikonte në disa lidhje me kompjuterët e tjerë. Vetëm në këtë mënyrë ishte e mundur vazhdimësia e komunikimit në rast të shkatërrimit të ndonjërit nga kompjuterët, ose këputjes së ndonjë lidhjeje.

Në vitin 1964, Forcat Ajrore të SHBA-së angazhojnë firmën RAND Corporation, për ndërtimin e projektit të quajtur "Rrjeti i decentralizuar". Kjo firmë nuk u angazhua për atë që ne sot e njohim si paraardhës të internetit. Për shkak të shumë vështirësive, ky projekt nuk u realizua. Ideja për një "rrjet të decentralizuar", ku mbajtja e të dhënave bëhet në formë paketash, mbeti një ide në letër. Qendra shkencore Advance Research Projects Agency (ARPA), që nga viti 1958 shërbente për zhvillimin shkencor për ushtrinë amerikane, vendosi që më 1966-ën të ndërlidhë rrjetin me llogaritësin ARPA. Me këtë rast, ideja për "rrjetin e decentralizuar" u zhvillua edhe më tej dhe mori një formë paksa më të kuptueshme. Në vitin 1969, në rrjetin ARPA-net ishin të lidhura katër llogaritës. Tri vjet më vonë, në ARPA-net ishin të lidhura 40 llogaritës. Duhet

theksuar se edhe në këtë kohë, ARPA-net ishte një rrjet i mbyllur. Nga ky rrjet i mbyllur, ARPA-net do të ndërtohej më vonë si rrjeti i internetit.

## Interneti sot

Në internet mund të komunikosh me këdo dhe nga kudo. Mund të lexosh, mund të kulturohesh (ose të shkulturohesh nëse je pa mend), mund të informohesh, mund të blesh e të shesësh mallra e shërbime, mund të paguash faturat e shtëpisë e të biznesit, të paguash e të paguhesh, mund të botosh, të dëgjosh muzikë, të shohësh koncerte e filma, mund të bësh shkollë e trajnime profesionale me korrespondencë e të tjera; e gjëra pa fund nga jeta e përditshme e çdokujt prej nesh.

Zhvillimi më i madh në këtë botë të re të teknologjisë së informacionit (IT) është bërë që nga fundi i viteve të 80-ta e në vijim. Ashtu siç i duhej dikur njeriut një plug për ta tërhequr me qe, kuaj apo traktor për të lëruar tokën dhe më pas një laps si mjet më të sofistikuar për të shkruar, ashtu edhe për internetin duhet të kesh një kompjuter dhe një lidhje, që të hysh në botën e madhe të cybers-

pace (kibernetikës). Nuk mund të mendohet përparimi i sotëm në botë, i palidhur me botën e kompjuterit e të IT-së.

Interneti u fut për herë të parë në Shqipëri në vitin 1991, nga Fondacioni Soros. Gjatë këtyre 17 vjetëve, janë krijuar mjaft kompani, sidomos në qytetet e mëdha të vendit, të cilat ofrojnë përdorimin e internetit. Tashmë është e qartë për të gjithë, se përdorimi i internetit është një nevojë e domosdoshme për Shqipërinë në përgjithësi, e rininë shqiptare në veçanti. I ndodhur në një pozitë të lakmueshme gjeografike, sa i përket trafikut të cyberspace, me një popullsi relativisht të vogël dhe me një potencial të fuqishëm rinor intelektual, Shqipëria i ka të gjitha mundësitë që me vullnet e përpjekje të vihet në radhët e vendeve të përparuara në atë drejtim, ku lëviz e ardhmja.

## Interneti dhe përhapja e informacioneve

Në të kaluarën, vetëm një elitë e vogël mjetesh informimi, si gazetat, rrjetet televizive dhe korporatat e mëdha, kontrollonin pjesën më të madhe të informacionit. Me përhapjen e Internetit,

gjithnjë e më shumë njerëz po arrijnë të marrin direkt informacione të pafiltruara të të gjitha llojeve. Bizneset po e njohin këtë prirje dhe po përpiqen të përfitojnë prej saj. Miliona e miliona njerëz hyjnë në faqet elektronike në kohët e sotme, për të lexuar shtypin e ditës, parashikimin e motit, këmbimin valutor, postën elektronike e për të kërkuar çdo gjë në të famshmen Google. I njohur si motori më i madh për kërkimet në Internet, ka një mesatare prej mbi 100 milionë kërkimesh në ditë. Njerëzit nga i gjithë globi bëjnë thujse miliarda kërkime çdo muaj. Informacioni ka qenë gjithnjë një produkt dhe pushtet në botën e biznesit. Tani atë e shfrytëzojnë më shumë konsumatorë kur përdorin Internetin. Sot dihet se një nga shërbimet më të rëndësishme të teknologjisë bashkëkohore janë kompjuterët. Mundësitë dhe përdorimet e tyre janë kaq të shumta, sa është vështirë t'i numërojmë, por e sigurt është se ata lehtësojnë dhe shumëfishojnë në mënyrë të pamagjueshme punën në shumë drejtime të veprimtarisë njerëzore. Interneti nuk i përket askujt. Çdo kompjuter që bashkohet me të, është përgjegjës për strukturimin dhe për përdoruesit e tij. Nga "origjina", natyra e tij dhe mënyra e materializimit, Interneti ka një formë jo të përqendruar "anarkike". Kjo karakteristikë përcakton edhe faktin që nuk i përket askujt dhe nuk drejtohet nga askush. Megjithatë nuk pushon së qeni një i tërë. Interneti nuk ka as këshill drejtues, as drejtor të përgjithshëm, por vetëm disa "trupa" që luajnë një rol këshillues dhe rregullues (jo fitimprurës) kryesisht në temat teknike. Përgjegjësinë kryesore për zhvillimin teknik dhe drejtimin e rrjetit e ka sot Shoqëria e Internetit (ISOC), që është një organizatë vullnetare, në të cilën mund të marrin pjesë ligjërisht dhe fizikisht persona që kanë qoftë dhe një lidhje të thjeshtë me internetin.

## STUDENTËT E UBT-së BËJNË MUZIKË ME VEGLA SHKOLLORE



13 PRILL 2011 -

Disa përfaqësues të rinj të kompanisë "Red Bull", në Kosovë, edhe para studentëve të UBT-së dhe në bashkëpunim me ta, po në hollin e UBT-së organizuan dhe zhvilluan projektin e tyre TUM TUM PA, ku para publikut shumë të mrekullueshëm u paraqitën gjashtë grupe muzikore. Ajo çka ishte interesante për publikun, sepse grupet nuk bënë muzikë të zakonshme, dhe instrumentet e tyre ishin lapsi, stilolapsave, vizorja, gërshërët dhe gomat. Pas përfundimit të garës, juria profesionale zgjodhi tre vendet e para të cilat u shpërblyen me nga një pako të pijes "Red Bull". Po ashtu edhe i tërë publiku u freskuan më nga një pije të kompanisë në fjalë. Finalja botërore të RED BULL TUM TUM PA, do të zhvillohet në Rio de Janeiro. Red Bull Tum Tum Pa, është konkursi i parë për studentë të krijimit të muzikës.





Departamenti për Trajnime dhe Certifikime në UBT është shumë i angazhuar për të kontribuar në avancimin e shoqërisë kosovare në një shoqëri konkurrense, nëpërmjet trajnimeve tona profesionale, të cekura më poshtë:

#### Menaxhim

- Menaxhimi i Burimeve Njerëzore
- Administrim Biznesi
- Menaxhimi i Kualitetit (ISO 9001:2000)
- Menaxhimi Strategjik
- Ngritja (Themelimi) e ndërmarrjes së re
- Menaxhimi i Produktit
- Ndërtimi i Brendit
- Inxhinieringu Industrial
- Menaxhimi i Projekteve
- Menaxhimi i Proceseve
- Menaxhimi i Zinxhirit të Furnizimit
- E-Biznes
- Transport dhe Logjistikë
- Sisteme Fleksibile të Prodhimit
- Prodhimi mbështetës
- Prodhim, Planifikim dhe Skedulim
- Menaxhimi i Ndryshimeve
- Menaxhimi i Rrezikut
- Menaxhimi i Ankesave
- Menaxhimi i Kohës
- Ndërmarrësi dhe Biznisplan
- Menaxhimi i Sistemeve Informativ
- Prokurimi
- Menaxhimi i Konfliktit
- Përgjegjësia Sociale e Korporatës
- Menaxhimi i Ngjarjeve
- Sistemet HACCP
- Fuzionimi dhe Bashkimi
- Planifikimi i resurseve të manufakturës
- Planifikimi i Materialeve të Kërkueshme (MRP)
- Shkathësi negocimi
- Menaxhmenti i Logjistikës

#### Financa

- Raportim Financiar i Korporatës
- Tregtia e Jashtme/Doganat
- Analiza e Kostove
- Kontabilitet dhe Menaxhim i Financave
- Vendimarrja Financiare
- Institucionet Financiare dhe Tregjet

#### Marketing dhe Shitje:

- Marketing dhe Shitje
- Planifikimi i Burimeve të Shpërndarjes
- Mjetet e IT për Marketing

- Menaxhimi i Lojalitetit
- Merchandising
- Modeli i Optimizimit të çmimeve
- Zhvillimi i Produkteve dhe Brendimi
- Menaxhimi i Shitjes
- Shitja Efikase dhe Teknikat e Shitjes
- Menaxhimi i Ankesave të Konsumatorëve

#### Shkathësi kryesore të këshillimit:

- Menaxhimi Personal
- Komunikimi
- Punët e suksesshme grupore
- Grupimi dhe Krijimi i Grupeve
- Periodizimi
- Kodi i Etikës së Këshilltarit
- Zgjidhja e Konfliktit
- Negocimi i Kontratës
- Menaxhimi i Marrëdhënieve me Klientë
- Shërbime Këshillimi për Marketing
- Menaxhimi i Proceseve Këshilluese

#### Gjuhët e huaja:

- Gjuhë angleze
- Gjuhë gjermane
- Gjuhë frënge

Vërejtje e rëndësishme: Gjuhët e huaja, varësisht prej kërkesave të grupit në fokus, mund të mbahen edhe në bazë të kërkesave specifike të grupit për mësimin e terminologjive të ndryshme profesionale për gjuhët përkatëse

#### Drejtësi, Shkenca Politike dhe Diplomaci:

- Teknika Negocimi
- Zgjidhja e Konfliktit
- Aqvi Comunnitëre e Bashkimit Evropian
- Institucionet e Bashkimit Evropian
- Komunikimi Masiv
- Shkathësi Diplomatie
- State Protocol

#### Mekatronikë dhe Teknologji të tjera

- Mekatronikë (Pneumatikë, Elektro-Pneumatikë, E-Teknika / Programmable Logic Controllers (PLC), Hidraulikë, Elektro-Hidraulikë, Sistemet e Kontrollit Hidraulik, Sensorët
- Design Assembly & Mirëmbajtja e Sistemeve Mekatronike
- CAx - Teknologjitë (CAD/CAM, CAQ, CAP dhe CA të tjera)
- CNC-Teknikat
- Robotikë
- Teknika të Punës/ Organizim i Punës
- Mbrojtja e Mjedisit

- Teknika të Sigurisë për mbrojtjen së punëtorëve
- Dokumentimi Teknik
- Saldimi
- Inovimi

#### Teknologji Informativ

- CISCO
- IT Essencial
- CCNA Discovery 1.2.3.4
- CCNA Exploration 1.2.3.4
- ECDL
- Hardware
- Inxhiniering i Software (Gjuhët programuese dhe Bazat e të Dhënave)
- Rrjetizim
- Simulim i Kompjuterit
- Disenj Kompjuterik dhe Animacion
- Sisteme Aplikative të Ndërmarrjes
- Aplikime të Internetit
- Paketat CAD/CAM
- Menaxhimi i Marrëdhënieve me Konsumatorë (CRM)
- Modelimi, Optimizimi dhe simulimi

#### Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor

- Menaxhimi i Projekteve Konstruktuese
- Projektim me AUTO CAD, ARCHI CAD
- Materiale Konstruktuese dhe Kontroll Kualiteti
- Menaxhim Urban
- Certifikim për Kualitet
- Marketing në Arkitekturë

Trajnimet profesionale në disiplinat e lartcekura ofrohen në periudha të ndryshme, në bazë të kërkesës së individëve, institucioneve, kompanive dhe korporatave të ndryshme. Një grup profesionistësh vendorë dhe ndërkombëtarë, me përgatitje akademike superiore dhe përvojë të suksesshme, janë në dispozicionin tuaj për t'ju ofruar një vistër të gjerë trajnimesh për një karrierë personale të avancuar dhe për sukses të padiskutueshëm të ndërmarrjes apo institucionit tuaj.

**Vërejtje e rëndësishme: Ju lutemi, mos hezitoni të kontaktoni zyrtarin përgjegjës për Trajnime profesionale në Universitetin për Biznes dhe Teknologji, përmes numrit të telefonit 038 541 400.**



**Kredi për studentë**



**Raiffeisen  
BANK**

*...JETO MË MIRË*

# Financoni studimet tuaja

- Norma të volitshme interesi
  - 10,000 Euro deri në 5 vjet
  - 0% - shpenzime administrative

[www.raiffeisen-kosovo.com](http://www.raiffeisen-kosovo.com)  
Raiffeisen Direct: 038 222 222



# "BONITA" E CILËSISË SË LARTË

Studentët e UBT-së janë të mirëseardhur për punë praktike në cilën do kohë. Do i mirëpresim dhe do u lëmë hapësirë të mjaftueshme sidomos studentëve të cilët i përkasin Fakultetit të Mekatronikës, thotë z. Agim Dushi

HANA JANJEVA & EGZON GOJNOVCI, STUDENTË NË UBT



Gjeografia e qytetëzës së Lipjanit është shumë interesante. Nëpër Lipjan kalon rruga Prishtinë – Prizren, Prishtinë – Ferizaj - Shkup, pastaj nëpër Lipjan kalon rruga hekurudhore Prishtinë – Shkup. Për shkak të konfiguracionit dhe tokës së rrafshet, që ka, në të shtrihet edhe Aeroporti Ndërkombëtar "Adem Jashari" i Kosovës. Njëherësh në këtë tokë të rrafshët po në këtë vit do të ndërtohet objekti i Universitetit për Biznes dhe Teknologji (UBT), po ashtu në territorin e kësaj komune, pas luftës janë ndërtuar shumë kompani private ndërtimore dhe ushqimore dhe që me investimet e tyre të mëdha, me punësimin e shumë të rinjve të komunës në fjalë dhe me punën e tyre profesionale i kanë dhënë pamje të mrekullueshme dhe sadopak e kanë zbutur papunësinë në komunën e Lipjanit. Në këtë rast si shembull më për së afërmi e kemi marr kompanin "Bonita", e cila është e njohur jo vetëm për

qytetarët kosovarë por edhe në shtetet e rajonit, me ujin Bonita dhe lëngun Libella, të pijshëm dhe me shije fantastike.

Do përmendur se studentët e Fakultetit të Mekatronikë në UBT shprehin interesim të dijnë më shumë për kompaninë, dhe bashkërisht me disa nga aty, edhe përsëafërmi e kanë vizituar kompaninë me pajisje moderne dhe të standardeve më të larta që ka teknologjia e sotit. Kjo kompani ka zyre të rregulluara dhe skajshëmrisht të pastërta. Aty janë të punësuar mbi 50 punëtorë të zellshëm dhe të gjithë të komunës, të profileve të ndryshme, përkatësisht secili punëtorë është profesionist për punën që e bënë.

Aty takuam edhe drejtorin gjeneral z. Agim Dushin, i cili na shpjegoi edhe më konkretisht na

mbajti një ligjëratë se si ka filluar punën Bonita e më pas edhe më lëngun Libella, pastaj si ka arrit të depërtoj në tregun e brendshme e të jashtëm, çka dhe si duhet të punohet për ta zhvilluar një biznes të tillë me teknologjinë e nivelit të lartë që e ka sot "Boniat" në Lipjan.

#### Bonita është e certifikuar me ISO 9001 2008 dhe HACCP

"Ka qenë një pikë e lirë e ujit e cila gjendet afër kompanisë Coca-Cola të Lipjanit, përmes së cilës kemi bërë analiza. Pastaj në bazë të tyre kemi bërë shpuarjen afër 50 metra të ish-burimit të kompanisë së Coca-Colës së dikurshme. Me kalimin e kohës me vazhdimin e punimeve ne angazhuam Institutin më të njohur profesional ndërkombëtar dhe Evropian nga Gjermania, Instituti Fresenius, i

cili ka bërë të gjitha analizat dhe ka arritur në përfundim se ky ujë është shumë i mirë dhe i përdorshëm", thotë Agim Dushi, pronar i kompanisë Bonita dhe i lëngut Libella në komunën e Lipjanit.

Bonita ka startuar me prodhim të ujit natyral dhe ujit mineral, kapaciteti ka qenë rreth 2000 shishe në orë që në gjuhën e prodhimit të ujit quhet prodhim bashkëkohor i viteve të fundit në Evropë të njohura nga Gjermania dhe Italia. Kompania jonë llogaritë një investim të gjithëmbarshtëm 3.850.000 euro që nga fillimi e deri më tani. Cilësisë së ujit, Bonita duket se i ka kushtuar një rëndësi të madhe duke fituar licenca të standardeve të larta ndërkombëtare. Kompania Bonita është e certifikuar me standardin ndërkombëtar ISO 9001 2008 dhe me certifikimin

HACCP. Burimi i ujit që gjendet pranë Kompanisë Bonita është i certifikuar prej institutit FRESSENIUS dhe është burim i certifikuar nga instituti ndërkombëtar. Prodhimi i ujit fillon nga burimi, pastaj kalon nëpër filtra mikrobiologjik duke u filtruar mirë e më mirë. Pastaj vazhdon me mbushje, procedura e mbushjes e cila është e rregulluar sipas sistemit të makinerisë dhe është procedurë e mirë dhe e sigurt. Gjatë procedurës së mbushjes së shisheve me ujë, shisheve i bëhet analiza çdo orë nga laboratorit në mënyrë që të sigurohet mirë cilësia e produktit.

Ndaj ujit të kompanisë në fjalë përkujdeset edhe Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik që ujit i bënë analizë një herë në vit sikurse edhe Instituti FRESSENIUS.

Kompania Bonita paguan me rregull kontributet ndaj shtetit, duke ju kushtuar vëmendje të madhe këtyre procedurave. Deri më tani ajo ka paguar më shumë se 1 milion euro tatime shtetit, përkatësisht komunës së Lipjanit.

#### Bonita është prezent në gjithë tregun kosovar

"Çështja e shitjes qëndron mirë dhe përfshinë një nivel të lartë, që nënkupton se kompania jonë është prezente në gjithë tregun kosovarë me një përqindje të mirë dhe të qëndrueshme si me ujin Bonita ashtu edhe lëngun Libella", thotë z. Dushi, dhe shton më tej se lëngu Libella është e licencuar nga kompania e njohur ndërkombëtare WIND.

## RËNDËSIA E INVESTIMEVE TË HUAJA DIREKTE PA STATISTIKA NUMERIKE

BUJAR ABDULLAHU



Në mënyrë që një produkt të kalojë ciklin e tij të prodhimit nga faza e gjetjes së tij e deri te përpunimi final, madje deri tek edhe shitja e tij, ai, pra produkti, duhet të përshkon nëpër shumë procedurë të ndryshme.

Po që se p.sh kemi të bëjmë me një mineral, çfarëdo qoftë ai, i cili gjendet në thellësi të mëdha nëntokësore, atëherë padyshim që për ta nxjerr këtë produkt, që në këtë rast është lëndë e parë, është e domosdoshme pasja e një teknologjie të avancuar për nxjerrjen e tij. E pasja e një teknologjie të tillë pa dyshim, kërkon edhe aftësi dhe shkathtësi, respektivisht njohuri, të caktuara për përdorim të saj. Pasi ai të nxirret është e nevojshme një makineri tjetër për fillimin e përpunimit të tij, njëjtë, edhe me këtë rast, është

e nevojshme që të ekzistojnë persona të trajnuar me njohuri adekuate për përdorim të tyre edhe për këtë fazë. Dhe kjo teknologji së bashku me persona të cilët kanë njohuri të mjaftueshme për përdorim të kësaj makinerije, vazhdon deri në përfundim të procesit të prodhimit, respektivisht deri tek produkti final. Realisht kjo nuk është e tëra, madje, edhe shitja është aftësi e cila me kalimin e kohës përmirësohet. Kuptohet pasi koha është para, atëherë sa më shpejt persona të caktuar fitojnë aftësi të nevojshme për shitje aq më pak humbet koha, respektivisht paraja.

Por si mund të shfrytëzohet një mineral i çmueshëm dhe me vlerë, i cili gjendet në thellësi të mëdha nëntokësore në një vend i cili është, thanë shkurt, i varfër? Si mund të nxirret ai mineral nga persona të cilët nuk kanë njohuri të duhur e as nuk posedojnë teknologji të mjaftueshme për ta ndërmarrë një hap të tillë?

Eventualisht një gjë e tillë mund edhe të ndodh, por pasi këta per-

sona nuk kanë teknologji dhe njohuri të mjaftueshme, procedurat e nxjerrjes së saj do të jenë shumë të ngadalshme, dhe se përpunimi i tij gjithsesi do të jetë me mangësi të mëdha.

Edhe pse jemi në epokën e informatikë, në epokën e shkëmbimit të informatave brenda një kohe shumë të shkurtër, kjo dukuri, pra mungesa e teknologjisë dhe njohurive për një proces të prodhimit të shpejt dhe efikase ekziston në shumë vende të botës. Pra shtohet pyetja si këto vende me një zhvillim të ulët ekonomik, por pa dyshim edhe ato vende të cilat janë në zhvillim e sipër, t'i shfrytëzojnë pasuritë e tyre të ndryshme? Praktikisht më të mira ndërkombëtare tregojnë se zgjidhja më e mirë e mundshme është ajo që në terminologjinë ekonomike quhet "Investimet e Huaja Direkte" – IHD.

Investimet e huaja direkte janë komponente të rëndësishme relevante për zhvillim ekonomik të një vendi, ashtu si u përmend më herët, për vendet të cilat janë të varfra

dhe për ato në zhvillim. (Edhe vendet e zhvilluara IHD-në e kanë si një motor të mbajtjes së nivelit të zhvillimit ekonomik).

Shikuar realisht këto vende, pra ato në zhvillim dhe të varfra, platformë mbi të cilin duhet bazaruar prosperitetin e tyre, ndër të tjera, janë edhe investimet e huaj direkte. Ky konstatim faktotet duke u bazuar në hulumtimet e shumta të ndërmarrja nëpër vende të ndryshme të botës, të cilat kanë qenë të hapura ndaj investimeve të huaj direkte përballa atyre të cilat, thënë me kujdesë, kanë qenë më konservative, respektivisht me mëdyshje përballë kësaj komponente. Vendet të cilat kanë pasë qasje pozitive ndaj IHD-së kanë një normë shumë më të lartë të zhvillimit krahasuar me vendet të cilat kanë hezituar të lejojnë investimet e huaja direkte të jen edhe pjesë e tyre.

Arsyet e ndikimit pozitiv të IHD-së janë shumë dimensionale, duke filluar nga futja e kapitalit të huaj nga një vend në një tjetër, e deri tek rritja e punësimit. Pa dyshim që IHD-ja rritë konkurrencën dhe kjo e fundit kualitetin, pra IHD-ja ndikon edhe në rritjen e kualitetit të produkteve dhe shërbimeve.

Nëpërmjet IHD-së bëhet i mundur edhe transferimi i njohurive

dhe teknologjisë nga investitorët e huaj tek vendorët, faktorë shtesë i rëndësishëm së IHD-së. Gjithashtu IHD-ja ndikon në rritjen e llojllojshmërisë së produkteve dhe shërbimeve të një vendi.

Por çka duhet bërë një vend që të ketë më shumë investime të huaja direkte?

Së pari duhet që të jetë e gatshme që ta pranojë se investimet e huaja direkte do të jenë dobipërditëse, pra që IHD-ja do të jetë pozitive, së dyti duhet të përpiqen politika të tilla të cilat së paku do të ia lehtësojnë investitorit të jashtëm depërtimin në tregun vendorë. E kjo arrihet me politika ekonomike të duhura dhe kompatible me standardet ndërkombëtarë, respektivisht me standardet më të mirë evropiane që realisht janë standarde nga vendet prej të cilave përgjithësisht edhe vinë investitorët e huaj.

Pra, pa u futur në statistika numerike dhe krahasuese, ndërmjet vendeve të cilat e kanë përqafuar IHD-në dhe atyre të cilat kanë refuzuar atë, vet koncepti i investimeve të huaja është i mjaftueshëm për ta kuptuar se IHD-të janë një ndër komponentet më të rëndësishme ekonomik për një zhvillim më të shpejt të një vendi jo të zhvilluar.



## **Ndërto të ardhmen tuaj me bllokat Silka** **Shtëpitë e ndërtuara me Silka janë:**

- › Izolator të zhurmës
- › Ruajtës të nxehtësisë
- › Klimë të mirë banimi
- › Dimensione të sakta
- › Nuk digjen
- › Peshëmbajtës e shumë e shumë veçori pozitive.

Zgjedhni bllokat dhe tullat e fasadës Silka  
për një jetë më cilësore në shtëpit tuaja!



**Do shtëpi? Zgjedh silësi.**

[www.kosova.xella.com](http://www.kosova.xella.com)

**xella**

**silka**

# ZBATIMI I NJOHURIT NË SHKENCA TJERA

NJË POHIM FILOZOFIK THOTË:

MATEMATIKA ËSHTË "MBRETËRESHË" E TË GJITHA SHKENCAVE TJERA POR, NJËHERIT ËSHTË EDHE "SHËRBËTORE".

PROF. DR. SADRI SHKODRA

Duke e zbrërthyer këtë pohim filozofik, për matematikën, në gjuhën popullore mund të thuhet se nga njëra anë matematika është kulmi që respektivisht i mbulon të gjitha shkencat tjera e nga ana tjetër ajo ndodhet në bazamentin e të gjitha shkencave tjera, duke ju shërbyer si rrugë rrëfyese për llogaritje dhe njehsime të lloj-llojshme për nevojat e tyre përkatëse.

Çdo lëmi e matematikës e ka pikënisjen e cila bazohet në dy-tre koncepte fillestare, të cilat nuk mund të përkufizohen por, me anë të tyre pastaj përkufizohen, formulohen, zhvillohen dhe nxirren shumë e shumë kuptime, pohime, përfundime e rrjedhime për dukuri të ndryshme, matematikore, bujqësore, socialo-ekonomike, statistike, teknologjike, industriale, astronomike, gjeografike, fizike, biologjike, kompjuterike, etj; dhe kjo vazhdon deri në pafundësi me njohuri teorike në aspektin e abstraksionit logjik.

Në këtë aspekt po i përmendim vetëm disa nga njohuritë themelore matematikore:

- **Lëmia e Aritmetikës** fillon nga koncepti numër që nuk mund të përkufizohet por, me bazën e tij përkufizohet dhe zhvillohen të gjitha veprimet e mundshme me ta, siç janë p.sh. mbledhja, zbritja, shumëzimi, pjesëtimi, fuqizimi, rrënjëzimi, logaritmi..., e vazhdon deri në pafundësi me Teorinë e numrave.

- **Lëmia e Gjeometrisë** fillon me konceptin themelorë pikë, që nuk mund të përkufizohet dhe duke shfrytëzuar edhe dy kuptime tjera drejtëzën dhe ndërmjet përkufizohet dhe konstruktohen të gjitha figurat dhe trupat gjeometrik si dhe relacionet e ndërlidhjeve ndërmjet tyre.

- **Lëmia e Algjebrës** duke filluar nga koncepti fillestar bashkësi, përkufizohet dhe formohen shumë kuptime dhe struktura tjera algjebrike duke vazhduar me teorinë e algjebrës abstrakte.

- **Lëmia e Gjeometrisë analitike** që ka për objekt shqyrtimin dhe studimin e lidhjes së gjeometrisë me algjebër dhe anasjelltas, në kuptimin që figurave dhe trupave gjeometrikë që mund të konstruktohen dhe vizatohen gjeometrikisht të shprehen në aspektin algjebrik me anë të formulave, ekuacioneve dhe inekuacioneve përkatëse.

- **Lëmia e Matematikës financiare**, duke filluar nga koncepti i përpjesës, kapitalit dhe përqindjes përkufizon dhe zhvillon shumë kuptime të tjera nga lëmia e ekonomisë, teknologjisë etj..., siç janë p.sh. interesi, depoziti, renta, kredia (huaja), investimet etj.

- **Lëmia e Modelimit matematikorë** duke shfrytëzuar programimin linear dhe jolinear, trendët lineare, parabolike, eksponenciale, shumë e katrorëve më të vegjël, etj..., ka për qëllim që dukurive të ndryshme që ndodhin në natyrë të ja u shkruaj modelin (formulën, ekuacionin, inekuacionin) përkatës, me anë të cilit jemi në gjendje të llogarisim realizimin pozitiv ose negativ (të dobishëm ose jo të dobishëm) dhe nga këto llogaritje jemi në gjendje të parashikojmë zhvillimin e asaj dukurie për një afat të caktuar të ardhshëm kohorë ose reagimet e saj në kushtet e ndryshme nga ato që është realizuar.

- **Lëmia Analizës Matematikore** duke filluar nga kuptimi i vlerës kufitare, derivatit dhe integralit mundëson: kuptimin dhe shpjegimin e lëvizjes, shpejtësisë, nxitimit, lakueshmërin e lakores, llogaritjen e gjatësisë së harkut; llogaritjen e syprinave të figurave të trupave të rregullta dhe jo të rregullta gjeometrike; vëllimin e trupave të rregullt dhe jo të rregullt gjeometrik, sqaron dhe studion fushat skalare, vektoriale, elektrike, magnetike, etj.

Duke mos përmend edhe shumë lëmi tjera të matematikës që kanë mbetur pa u theksuar në pjesën e parë të këtij shkrimi, do të vazhdoj me shkrimin e disa shembujve karakteristikë që mendoj se janë interes dhe nevojë e të gjithë studentëve e posaçërisht atyre të UBT-së.

Për dy madhësi  $a, b$ ,  $b \neq 0$ ; herësi  $a : b = A$  ose  $\frac{a}{b} = A$  quhet **përpjesë** e këtyre dy madhësive. Për madhësitë e radhitura  $a, b, c, d$ ,

$b \neq 0, d \neq 0, c \neq 0$ ; shprehja  $a : b = c : d = A$  ose  $\frac{a}{b} = \frac{c}{d} = A$  quhet **proporcion i drejtë** ndërsa  $a : c = d : b = B$  ose  $\frac{a}{c} = \frac{d}{b} = B$  quhet **proporcion i zhdrejtë**.

**Shembulli 1.** (Proporcion i drejtë), 10 punëtorë kryejnë një punë për 12 ditë në vlerë prej 1200 €. Me të njëjtin intensitet dhe çmim sikur të vazhdonin punën 30 punëtorë sa ditë dhe sa euro do të realizoni?

**Zgjidhje:** 10 punëtorë kryejnë një punë për 12 ditë  
30 punëtorë kryejnë një punë për  $x$  ditë.

Pra, sipas proporcionit të drejtë kemi:  $10 : 12 = 30 : x$  respektivisht  $10x = 360$  dhe përfundimisht  $x = 36$  ditë.

Nga relacioni tjetër :

10 punëtorë realizojnë 1200 € për 12 ditë  
30 punëtorë realizojnë  $y$  € për 36 ditë.

Pra sipas proporcionit të drejtë kemi

$$10 : 1200 = 30 : y$$

respektivisht:

$$10y = 36000, \text{ prandaj } y = 3600 \text{ €}.$$

Përgjigjja përfundimtare e detyrës do të ishte: 30 punëtorë për 36 ditë pune realizojnë 3600 €.

**Shembulli 2.** (Proporcion i zhdrejtë), tre punëtorë e ndërtojnë një shtëpi për 36 ditë. Sa punëtorë do ta ndërtojshin atë shtëpi për 9 ditë nëse punojnë me intensitet të njëjtë?

**Zgjidhje:** Pra, 3 punëtorë e ndërtojnë shtëpinë për 36 ditë,  
 $x$  punëtorë e ndërtojnë shtëpinë për 9 ditë.

Sipas proporcionit të zhdrejtë kemi:



# VE MATEMATIKORE DHE NË PRAKTIKË

$$\begin{aligned} 3 : x &= 9 : 36, \\ 9x &= 108 \end{aligned}$$

$$x = 12 \text{ punëtor}$$

Prandaj, nëse 3 punëtorë e punojnë një shtëpi për 36 ditë, atëherë 12 punëtorë do ta punojnë atë shtëpi për 9 ditë.

Problematika në vazhdim ka të bëjë me privatizimin e ndërmarrjeve dhe ekonomive shtetërore në Kosovë.

Shumë herë kemi dëgjuar nga mediat e shkruara ose audiovizuale se u ble kjo apo ajo ndërmarrje nga dy ose tre ose katër persona (ortakë) me shuma jo të barabarta të pagesës. Për këtë qëllim të caktimit të shumave që ka paguar secili pjesëmarrës po e caktojmë këtë model matematikorë.

Po supozojmë se kapitali  $K$  është ndarë në  $n$  pjesë  $p_1, p_2, p_3, \dots, p_n$  jo të barabarta sipas një proporcioni  $r_1 : r_2 : r_3 : \dots : r_n$ .

Koeficienti i proporcionalitetit të ndarjes  $A$  është:  $\frac{p_1}{r_1} = \frac{p_2}{r_2} = \frac{p_3}{r_3} = \dots = \frac{p_n}{r_n} = A$ . Nga këtu kemi

$$Ar_1 = p_1; Ar_2 = p_2; Ar_3 = p_3; \dots; Ar_n = p_n \dots \dots \dots (*)$$

$$K = p_1 + p_2 + p_3 + \dots + p_n = A(r_1 + r_2 + r_3 + \dots + r_n)$$

$$\text{respektivisht, } A = \frac{K}{r_1 + r_2 + r_3 + \dots + r_n}$$

Pasi caktohet koeficienti i proporcionalitetit  $A$  nga barazimet (\*) caktohen pjesët  $p_1, p_2, p_3, \dots, p_n$ .

**Shembulli 3.** Katër aksionarë (ortakë) e kanë blerë një ndërmarrje  $K$  në Prishtinë për 17 500 000 € me pjesëmarrje të shprehur me proporcion 6:4:3:1. Nga sa € ka paguar secili nga katër aksionarët?

**Zgjidhje:**  $K=17\,500\,000$  €, aksionarët  $p_1, p_2, p_3, p_4$  dhe proporcionet  $r_1 = 6, r_2 = 4, r_3 = 3, r_4 = 1$

Koeficienti i proporcionalitetit është:

$$A = \frac{K}{r_1 + r_2 + r_3 + r_4 + r_5} = \frac{17\,000\,000}{6 + 4 + 3 + 1} = \frac{17\,000\,000}{14} = 1\,250\,000 \text{ €}$$

Nga barazimi (\*) kemi:

Proporcioni i ndarjes është:

$$p_1 = Ar_1 = 1\,250\,000 \cdot 6 = 7\,500\,000 \text{ €},$$

$$p_2 = Ar_2 = 1\,250\,000 \cdot 4 = 5\,000\,000 \text{ €},$$

$$p_3 = Ar_3 = 1\,250\,000 \cdot 3 = 3\,750\,000 \text{ €},$$

$$p_4 = Ar_4 = 1\,250\,000 \cdot 1 = 1\,250\,000 \text{ €}.$$

$$\text{Shuma } p_1 + p_2 + p_3 + p_4 = 17\,500\,000 \text{ €}$$

Përgjigjja përfundimtare është:

Aksionari i parë ka paguar 7 500 000; i dyti 5 000 000; i treti 3 750 000 dhe i katërti 1 250 000.

Dy shembujt vijues kanë për qëllim të tregojnë rendësin e përqindjes në jetën e përditshme.

**Shembulli 4.** Në qoftë se një artikull shitet me çmim 2442 € humbja do të jetë 7,5 % nga çmimi i prodhimit të tij. Sa duhet të shitet ai artikull në mënyrë që të fitohet 12,5 % nga çmimi i prodhimit?

**Zgjidhje:** Le të shënojmë me  $Q$  çmimin e prodhimit të atij artikulli. Atëherë kemi:

$$Q - \frac{Q \cdot 7,5}{100} = 2442, \text{ prej këtu } Q \left(1 - \frac{7,5}{100}\right) = 2442, \quad Q = 2640 \text{ €}.$$

Pra, çmimi i prodhimit të artikullit është  $Q=2640$  €. Që të jetë fitimi 12,5 % nga çmimi i prodhimit atëherë ai artikull duhet të shitet me çmimin:

$$Q_1 = Q + \frac{Q \cdot 12,5}{100} = 2640 + \frac{2640 \cdot 12,5}{100} = 2640 + 330 = 2970 \text{ €}.$$

**Shembulli 5.** Oferta e dy blerësve të një banese është

- Blerësi i parë  $B_1$  ofron sot 45000 € të gatshme (kesh)

- Blerësi i dytë  $B_2$  ofron sot 20000 € të gatshme, pas 4 vitesh 20000 € dhe pas 10 vitesh edhe 15000 €.

Cila ofertë është më e volitshme për shitësin në qoftë se ky shitës e ka ofertën për deponim në bankë me 6 % (p.a.d) dhe kapitalizimi 6 mujor për 10 vite?

**Zgjidhje:** Shitësi i banesës ka llogaritur në këtë mënyrë.

- Nga blerësi i parë  $B_1$ , 45000 € të gatshme po t'i depononte në bankë me 6 % (p.a.d) për 10 vite dhe me kapitalizim 6 mujor do ta kishte shumën:

$$K_{10} = K \left(1 + \frac{p}{100m}\right)^{nm} = 45000 \left(1 + \frac{6}{100 \cdot 2}\right)^{10 \cdot 2} = 81275 \text{ €}.$$

- Nga blerësi i dytë  $B_2$  do të kishte:

$$\overline{K}_{10} = 20000 \left(1 + \frac{6}{100 \cdot 2}\right)^{10 \cdot 2} + 20000 \left(1 + \frac{6}{100 \cdot 2}\right)^{6 \cdot 2} + 15000 = 79637,4 \text{ €}.$$


Përgjigjja përfundimtare është:

Oferta e blerësit të parë është më e mirë (më e madhe) prej 81275-79637,4=1637,6 € se sa oferta e blerësit të dytë  $B_2$ .

Një problem tjetër praktik, që lidhet me funksionin, derivatin e parë dhe të dytë respektivisht me maksimumin dhe minimumin e tij është shembulli në vijim.

**Shembulli 6.** Sa duhet të jetë rrezja  $R$  dhe lartësia  $H$  e një ene cilindrike e punuar prej llamarine me vëllim të caktuar  $V$  ashtu që të shpenzohet sa më pak material për përgatitjen e saj.

**Zgjidhje:** Le të shënojmë me  $S$  syprinën e enës cilindrike. Kërkesa në detyrë është që ta caktojmë minimumin e syprinës  $S$ , me kusht që vëllimi gjithnjë të mbetet konstant  $V$  siç shihet në vizatim:



Nga njohuritë elementare matematikore dihet se syprina  $S$  e cilindrit është

$$S = 2B + M = 2R^2\pi + 2R\pi \cdot H = 2R\pi(R + H)$$

Ndërsa vëllimi i cilindrit është

$$V = B \cdot H = R^2\pi \cdot H, \text{ pasi vëllimi } V \text{ është konstant (i caktuar) atëherë po e shprehim lartësinë } H = \frac{V}{R^2 \cdot \pi}, \text{ të cilën e zëvendësojmë në}$$

syprinën  $S$  si funksion që varet nga rrezja  $R$ , pra  $S = 2R\pi\left(R + \frac{V}{R^2\pi}\right)$  (respektivisht nëse shënojmë  $S=y$  dhe  $R=x$  atëherë funksioni i tillë

shprehet në formën  $y = 2x^2\pi + 2\frac{V}{x}$ ). Caktojmë derivatin e parë dhe të dytë të syprinës  $S$ .

$$S' = 4\pi R - \frac{2V}{R^2} \text{ dhe } S'' = 4\pi + \frac{4V}{R^3}.$$

Vlerat **max** dhe **min** të funksionit  $S$  caktohen nga  $S'=0$ , respektivisht  $4\pi R - \frac{2V}{R^2} = 0$ ,

$$2\pi R^3 = V, \quad R = \sqrt[3]{\frac{V}{2\pi}}. \text{ Duke zëvendësuar vlerën } R = \sqrt[3]{\frac{V}{2\pi}} \text{ në derivatin } S'' \text{ kemi } S''\left(\sqrt[3]{\frac{V}{2\pi}}\right) = 4\pi + \frac{4V}{\left(\sqrt[3]{\frac{V}{2\pi}}\right)^3} = 4\pi + \frac{4V}{\frac{V}{2\pi}} = 12\pi > 0$$

Pasi që  $S''\left(\sqrt[3]{\frac{V}{2\pi}}\right) > 0$ , rrjedhë se  $R = \sqrt[3]{\frac{V}{2\pi}}$  paraqet minimum të syprinës  $S$ . Në këtë rast lartësia minimale

$$H = \frac{V}{R^2 \cdot \pi} = \frac{V}{\left(\sqrt[3]{\frac{V}{2\pi}}\right)^2 \cdot \pi} = 2\sqrt[3]{\frac{V}{2\pi}} = 2R$$

Përgjigjja e detyrës do të ishte:

Prej të gjitha enëve cilindrike me vëllim të caktuar  $V$  (sepse të tilla ka shumë) syprinën minimale (harxhohet më së paku material) do ta ketë ajo enë që lartësinë  $H$  e ka të barabartë me  $2R$  respektivisht lartësia duhet të jetë e barabartë me diametrin e bazës.

**Komentimi i detyrës.** Po supozojmë se një fabrikë për konservimin e trangujve ka porositur një kontingjent prej 1 milion copë enësh në formë cilindrike me vëllim të caktuar  $8 \text{ dcm}^3$  respektivisht  $8 \text{ kg}$ . Tani pronari i fabrikës për prodhimin e atyre ambalazheve përmes stafit inxhinierik që ka në fabrikë duhet t'a dijë që ato enë duhet të prodhohen me dimensione që lartësia e tyre të jetë sa dy rreze të bazës për të harxhuar më së paku material për përgatitjen e tyre. Po, mos të përfillet ky fakt atëherë për çdo enë p.sh. do të harxhohet nga  $1 \text{ cm}^2$  llamarinë më tepër që dmth  $1000000 \text{ cm}^2 = 100 \text{ m}^2$ . Në këtë mënyrë shkaktohen humbje të panevojshme në fabrikën për prodhimin e ambalazheve për konservime të ndryshme vetëm nga arsyeja se kanë munguar njohuritë matematikore për caktimin e vlerës minimale të syprinës  $S$  për enë me vëllim të caktuar  $V$ .

Me këtë shkrim modest u munduam që studentëve dhe të tjerëve të ju japim sado pak njohuri më të afërta për arsyen, nevojën dhe rendësin e mësimin dhe studimit të lëmvive të ndryshme matematikore.

Autori është mësimdhënës në UBT



# PRODUKTET E XELLA INTERNATIONAL MË TË MIRAT NË VEND

## Do shtëpi? Zgjedh cilësi.

[www.kosova.xella.com](http://www.kosova.xella.com)

xella®

silka®

PRISHTINË, 01 PRILL 2011 - Menaxhmenti i lartë "Xella Kosova LLC" me seli në Lipjan, e cila është pjesë e "Xella Internacional" me seli në Gjermani në kuadër të aktiviteteve të sajës, me qëllim të informimit dhe dhënies së njohurive profesionale për studentët e Fakultetit të Arkitekturës mbajti një prezantim para studentëve, mysafirëve dhe stafit akademik të UBT-së.

Qëllimi i prezantimit ka të bëjë në ofrimin e mundësive për studentët e arkitekturës dhe ndërtimtarisë që të kenë njohuri sa më profesionale për prodhimet sillka si produkte më cilësore në tregun vendor të ndërtimit. Aspektet fizike dhe teknike të produkteve silikate ishin temat që u shpjeguan gjatë prezantimit dhe diskutimeve me studentët të UBT-së, drejtimi arkitekturë.

Kontakti fizik me produktin nga ana e pjesëmarrësve, mundësitë e aplikimit, informimi i profesorëve të lëmis së njëjtë dhe sugjerimet lidhur me futjen e produkteve Silka në plan programe shkollore si produkt murature i kualitetit të lartë me standarde Evropiane ishin disa nga çështjet që u shpjeguan gjatë prezantimit.

Blokat dhe tullat e fasadës të fabrikës "Xella" janë padyshim material më kualitetit të lartë për ndërtimin e shtëpive dhe objekteve të ndryshme, këtë e dëshmojnë testet e bëra lidhur me matjen e parametrave kryesorë si fortësia, simetria, mbrojtja nga zhurma, ruajtës i energjisë dhe tejet i shëndetshëm. Përbërja e bllokave është krejtësisht natyrale:

rërë silikate, gëlqere dhe uji, kjo mundëson që ambienti i banimit jetë shumë i shëndetshëm. Qetësia dhe komoditeti i banimit me bllokat "Xella" dhe tullat e fasadës është i pakrahasueshëm me materialet tjera ndërtimore, u tha gjatë prezantimit.

"Xella International" gjendet në komunën e Lipjanit në magjistralen Prishtinë - Shkup.

## BISEDË ME MIRADIJE VLLAHIUN, MENAXHERE NË "KINO ABC" NË PRISHTINË



# SHIKUESHMËRIA NË RRRITJE

Në KINO ABC të paktën 20 premiera botërore shfaqen brenda një viti. Pastaj një numër i madh i filmave shfaqet edhe në kuadër të javëve dhe festivaleve që organizohen në këtë kinema në bashkëpunim dhe që tash janë tradicionale - Miradije Vllahu

SARANDA MUSLIU & ALOR EUJPI, STUDENTË NË UBT

**Cili vit ka qenë më i suksesshmi dhe më sfiduesi që nga hapja e KINO ABC?**

**M. Vllahu:** Viti 2010 më saktësisht 24 maj 2010, ka shënuar 10 vjetorin e punës së suksesshme të kinemasë ABC. Tani ne jemi në vitin e 11-të të promovimit të pandërprerë të vlerave kinematografike, prandaj të gjitha vitet e punës së kinemasë kanë shënuar sukseset të shumta por dhe sfida. Çdo vit është karakterizuar me një numër të madh të filmave premiere, si holidiane, evropiane, shqiptare, një numër i aktiviteteve

të ndryshme kinematografike, javë dhe festivale të filmit etj.

Prej hapjes kinemaja ABC e deri në vitin 2004, ka pasur një numër të kënaqshëm të shikueshmërisë diku deri rreth 100 mijë, por vitet në vazhdim (2005-2007) kanë kaluar nëpër sfida dhe vështirësi të shumta, te cilat kanë ardhur si rezultat i mosfunksionimit të Ligjit për Kinematografi dhe Ligjit për Drejtat e Autorit, që ka shkakuar një hov të jashtëzakonshëm të konkurrencës jolojale në treg. Këto kanë qenë vitet me numrin më të ultë të shikueshmërisë gjatë tërës veprimtarisë së Kinemasë ABC. Ndërsa, vitet 2008-2010 kanë bërë një kthesë dhe kanë shënuar një rritje të ndjeshme të shikueshmërisë, krahasuar me vitet paraprake.

**Cilët filma pëlqehen më së shumti?**

**M. Vllahu:** Shijet e shikuesve tanë janë të ndryshme prandaj, kompania jonë KDSHF "GENCI" punon për të plotësuar kërkesat dhe nevojat e tyre duke përdorur strategji të reja sipas standardeve evropiane, në bashkëpunim me kompani evropiane dhe holidiane. Bazuar në statistikat tona

zhanri komedi, romance, triler e kohëve të fundit edhe horror josh me tepër audience e re, e cila përbën njëherit edhe moshën potenciale të publikut të kinemasë.

**Me cilat sfida po ballafaqoheni gjatë këtyre viteve?**

**M. Vllahu:** Sfide për kinemanë vazhdon të jete përballja me dukurinë e piraterisë pra konkurrenca jolojale në treg, mosfunksionimi i dy ligjeve themelore që mbron vlerat jo vetë kinematografike por edhe kulturën në përgjithësi, si dhe mos funksionimi i rrjetit të kinemave në qytetet tjera të Kosovës, duke pas parasysh që KDSHF "GENCI" kompania e parë dhe e vetme me të drejta të distribuimit të filmit për tërë territorin e Kosovës, dhe të vetmen kinema, ka kinemanë ABC si shfaqës dhe filmit.

**Si ka ecur privatizimi i kinemave dhe pse përpos Prishtinës kinema të tjera nuk po funksionojnë?**

**M. Vllahu:** Mos funksionimi i kinemave në qytetet tjera edhe 10 vite pas luftës është evident. Kontribut dhe meritë e KDSHF "GENCI", Qendrës Kinematografike të Kosovës dhe Unio-

nit të Artistëve të Kosovës, është arritja e marrëveshjes me Agjencionin Kosovë për Privatizim, që brenda një periudhe 10 vjeçare, kinemave edhe pas privatizimit te mos ju ndërrohet destinimi i tyre.

**Me cilat kompani keni bashkëpunim?**

**M. Vllahu:** KDSHF "GENCI" bashkëpunon me Continental Film nga Zagrebi dhe Imperial Cinemas nga Tirana, përmes tyre me kompani holidiane, bashkëpunojmë edhe me shumë kompani kinematografike shqiptare, nga vendet e ndryshme të rajonit, Evropa e më gjërë. Nga viti 2001 jemi anëtar të rrjetit të kinemave evropiane EUROPA CINEMAS, me seli në Paris dhe anëtar të rrjetit të distributoreve evropiane EUROPA DISTRIBUTION nga 2008, falë funksionimit të kompanisë dhe kinemasë sipas standardeve evropiane.

**Sa shikohet filmi shqiptarë në përgjithësi?**

**M. Vllahu:** Kinemaja e ka shikuesin e saj edhe për filmat shqiptar, por marre në përgjithësi qasja e mjaftueshme e publikut mungon, fatkeqësisht. Kinemaja

ofron vlera, ka mundësi gjithnjë edhe për më shumë, por këtij angazhimi tonë të përbashkët duket ti paraprijë edhe vet publiku, duke u bërë pjesë në ngritjen dhe zhvillimit e mëtutjeshëm të këtyre vlerave, për të cilat kemi nevojë ne, ka nevojë edhe Kosova.

**Sa premiera në vit i jep KINO ABC?**

**M. Vllahu:** Të paktën 20 premiera botërore shfaqen brenda një viti. Pastaj një numër i madh i filmave shfaqet edhe në kuadër të javëve dhe festivaleve që organizohen në kinemanë ABC në bashkëpunim dhe që tash janë tradicionale.

**Më konkretisht çka ju ofroni studentëve?**

**M. Vllahu:** Çmimi është tre euro, ndërsa në forma të organizuar, për të gjitha institucionet qofshin shkollore apo të tjera gjithnjë ekziston çmimi 1 euro. Ndërsa javët dhe festivale dhe shumë e shumë aktivitete tjera që përbëjnë mbi 30% të programit tonë një vjeçar, duke shfaqur filma nga kinematografit e vendeve të ndryshme evropiane që kanë shumë vlera, ofrojmë hyrje falas.



## UBT KONSULENT PROFESIONAL PËR INVESTIMET KAPITALE NË QKUK

Universiteti për Biznes dhe Teknologji (UBT) është partner konsulent për Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK) në bazë të kontratës dyvjeçare që ka me këtë institucion në cilësinë e konsulentit. Puna mes dy institucioneve ka filluar nga viti i kaluar, dmth prej fillimit të vitit 2010, dhe UBT me stafin e vet profesional deri më tani e ka ndihmuar dhe ka bërë punë të mrekullueshme në konsulecë rreth renovimit të nyjeve sanitare të Qendrës Emergjente të QKUK-së dhe renovimit të nyjeve sanitare të Klinikës Interne të QKUK-së. Po ashtu UBT ka bërë edhe vlerësimin e projektit ideor dhe kryesore për Qendrën e Re emergjente që do të ndërtohet në QKUK për dy vitet në vijim si në ndërtimin e sistemit informativ të QKUK-së, renovimin e fasadës së Klinikës Infektive, renovimin

e kulmit në Klinikën Ortopedike, renovimin kulmit në Klinikën e Dermatologjisë dhe pulmologjisë. Po ashtu vlen të cekim edhe investimet kapitale të QKUK-së për dy vitet në vijim. Një pjesë e projekteve të lartpërmendur janë realizuar ndërsa një pjesë tjetër janë duke u realizuar dhe janë projekte që do të realizohen gjatë këtij vit.

Të cekim më konkretisht se UBT ka realizuar në QKUK në vitin e kaluar këto aktivitete konsulente - mbikëqyrje si: mbikëqyrje të realizimit të projekteve rinovuese, revidim të projekteve, analiza të fizibilitetit të projekteve, analiza të ofertave për realizimin e projekteve, konsulecë profesionale gjatë realizimit të projekteve, propozime për projekte për përmirësimin e infrastrukturës menaxhuese, operationale etj.



NË UBT U ORGANIZUA LIGJËRATA ANËTARËSIMI I KOSOVËS NË OBT

## MOSNJOHJA NGA DISA SHTETE NUK E PENGON KOSOVËN TË ANËTARËSOHET NË OBT

“Kosova nuk është e njohur nga shumë shtete botërore, por kjo nuk do të thotë që domosdoshmërisht ne duhet të presim që të njihet nga të gjitha shtetet për t’u bërë pjesë e Organizatës Botërore të Tregtisë, dhe ky nuk është një argument që ne e marrin parasysh për t’u bërë pjesë e OBT-së”, tha z. Garland Boyette.

PRISHTINË, 31 MARS 2011-

Universiteti për Biznes dhe Teknologji (UBT), vazhdon traditën e organizimit të ligjëratave me personalitete nga jeta publike, si me përfaqësues të institucioneve ndërkombëtare ashtu edhe me institucionet vendës.

Ndaj në këtë vazhde, Këshilltar për Tregti pranë projektit të USAID-it për përmirësimin e mjedisit afarist, me theks të veçantë z. Douglas J. Cruickshank bashkë me kolegun e tij Garland Boyette, ekspert nga fusha e tregtisë, para studentëve, profesorëve, mysafirëve



të UBT - së dhe mbajti ligjëratën me temën “Anëtarësimi i Kosovës në OBT, sfidat dhe mundësit”.

Këshilltar për Tregti pranë projektit të USAID-it për përmirësimin e mjedisit afarist., Douglas J. Cruickshank, foli për kushtet që duhet plotësuar Kosova për të

qenë pjesë e OBT-së. “Duhet një përgatitje për të pasur një tregti të lirë, sistem i cili funksionon edhe në Evropë, ky sistem duhet të vazhdojë edhe ndërmjet Kosovës dhe Serbisë për të pasur një tregti të lirë dhe pozitive”, ka përmendur ai. “Ideja për të pasur një bashkë-

punim që do të prodhonte beneficione për dy shtete ose më shumë që kanë një sistem të mirë bashkëpunimi ndërmjet tyre është krijimi i atyre kushteve që do të krijojnë një klimë të mirë të tregut”.

Cruickshank ka përmendur edhe nxitjen e tregut të liberal nga

ana e institucioneve shtetërore. “Në emër të Organizatës sonë dua të jap një mesazh se sukcesi i një ekonomie të mirëfilltë tregtare është krijimi i një tregu liberal edhe nga ana e qeverisë së vendit tuaj, pra krijimi i një sistemi të lehtë dhe liberal nga Ministria e Tregtisë”, ka thënë ai. “Ju duhet të demonstroi se keni një sistem të atillë që jep mundësi për çdo kënd të futet në tregti por gjithashtu të krijoni një sistem në të cilin paligjshmëria nuk duhet të gjej të vend në ambientin tregtar të Kosovës”.

Po ashtu Garland Boyette ka thënë se Kosova duhet që të prodhojë aktivitet më të shtuar drejt procesit të anëtarësimit në OBT. “Për opinionin tim Kosova nëse dëshiron të jetë pjesë e organizatës duhet të konsideroj që të bëjë aplikimin sa më shpejt. Aplikimi do të tregonte interesimin e Kosovës për të qenë pjesë e tregtisë botërore dhe kjo do të merrej parasysh nga OBT-ja natyrisht”, tha ai.

Kosova nuk është e njohur nga shumë shtete botërore, por kjo nuk do të thotë që domosdoshmërisht ne duhet të presim që të njihet nga të gjitha shtetet për t’u bërë pjesë e Organizatës Botërore të Tregtisë, dhe ky nuk është një argument që ne e marrin parasysh për t’u bërë pjesë e OBT-së”, përfundoi z. Garland Boyette.

## XHEJMS BERISHA VAZHDON LOBIMIN PËR NJOHJEN E KOSOVËS

PRISHTINË, 29 JANAR 2011— Piloti shqiptaro-amerikan Xhejms Berisha gjatë lobimit të tij për njohjen e Kosovës, deri më tash ka lobuar në 26 vende afrikane, ndërsa do të vazhdojë rrugëtimin

edhe në 30 shtete tjera, duke shpërndarë mesazhin e paqes, miqësisë dhe kërkesës për njohje sa më të shpejtë të vendit tonë. Kështu kanë thënë në një konferencë për media përfaqësues të Flying for Kosovo,

që u mbajt në hollin e objektit të Universitetit për Biznes dhe Teknologji (UBT), të cilët kanë shpalosur ecurinë e lobimit të pilotit shqiptaro-amerikan nëpër vendet e kontinentit afrikan.







## FLORINI I SUKSESSHËM NË STUDIME E VALLËZIM

Arritja më e madhe e grupi ishte në vitin 2009, ku në bashkëpunim me RTV-21, e bën "Musical" e parë në shqip në Kosovë. Nuk ishte ëndërr por realitet dhe askush nuk mund të thotë se arritjet e mëdha s'ekzistojnë për grupet e vogla", tha Florin Krasniqi për gazetën "UBT News".

LIRIGZONA MORINA & HEROLIND DRESHAJ- STUDENTE NË UBT

Vallëzimi është vet jeta e tij. Në lëvizje ai e gjen vetën të motivuar për të mësuar gjithçka që ka të bëjë me këtë art. Dhjetë vite më parë, kur shikonte në TV vallëzimet moderne, u fokusonte në hapat e tyre. Në atë kohë i dukej e pamundur një jë e tillë, por nëse e pyesim tash, do na thotë se "pamundësia" është shumë relative dhe nëse njeriu ka pasion, arrin gjithçka. Ky është Florin Krasniqi, anëtar i grupit "Art Design", pjesëtar i emisionit "Kabare" në RTV-21, e gjithashtu edhe student në Fakultetin Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi në Universitetin për Biznes dhe Teknologji- (UBT).

Fillimet e karrierës së Florini ishin paksa të vështira, ai nuk kishte përkrahje nga familja dhe rrethi i gjerë dhe marrja me vallëzim sipas familjarëve të tij kjo ishte më shumë humbje kohe. "Të vallëzoje ishte sikur të merresh me një aktivitet, që tek ne e quajmë humbje kohe". Andaj, as familja nuk ishte e kënaqur me këtë zgjedhje, sepse ata dëshironin diçka më efektive, siç janë studimet", thekson ai dhe vazhdon: "Po provove mund të humbësh, por nëse nuk provon, je i humbur gjithmonë. Unë rrezikova, por nuk humba asgjë...kjo ndodhi para tetë vitesh, kur unë i disponuar nga një këngë e re, mendova të gjej atë "pasqyrën", që do më jepte shpresë, ose do më thoshte nuk je për këtë gjë. Pa lajmëruar kënd u nisa, i trembur dhe i hutuar për të vërtetuar aftësinë time dhe që në fillime takova e koreografin e grupit "Art design"- Jeton Vorfin dhe me ndihmë, përkrahjen dhe

kujdesin e tij, sot unë mundem të vallëzoj deri të vallëzimi më i koklavitur", tregon ai për gazetën "UBT Neës", rrugëtimin e tij drejt vallëzimit profesional.

Florini bashkë me grupin "Art Design" është prezent nëpër të gjitha koncertet dhe manifestimet që mbahen goftë për festa shtetërore, apo gjatë xhirimeve të Vitit e Ri. Ata përformojnë në të gjitha qytetet e Kosovës si dhe në shumë vende të tjera në Diasporë. "Ne ishim aty ku ishte hareja. Ne donim t'i jepnim të gjithëve pak nga dëfrimi ynë. Ne ishim aty për t'i dhuruar pak nga arti. Ne ishim aty për tu treguar se edhe ne jemi pjesë e modernizimit. Edhe kjo ishte përballje e vështirë, sepse të kënaqësh çdo anëtar të publikut nuk është e lehtë. E rëndësishme ishte duartrokitja e të rinjve, që tregonin se sa shumë na çmonin. Këtë e vërtetonte edhe numri i të interesuarve, për vallëzim, që rritej pothuajse çdo herë e më shumë. Me grupi "Art Design" morën pjesë në të gjitha festivalet e Video - festit muzikore deri në vitin 2010. Në vitin 2007 na solli një fitore, me këngëtarën Vesa Luma, ku dhe u zgjodhën si kënga më e mirë e vitit. Kemi marr pjesë pothuajse në të gjitha spektaklet e bukurisë, e gjithashtu edhe në festivalin "Kënga magjike", ndërsa në Austri, morëm pjesë në Gjimnasriadën Olimpikë, ku e përfaqësuam Kosovën në vitin 2008. Gjithashtu për dy vite radhazi kemi qenë pjesë edhe e spektaklit "Star Bingo". Ishim pjesëmarrës edhe në Kfor-in Amerikan në "Bon Stil", pastaj në Aeroportin e Gjakovës, ku kemi vallëzuar për Kfor-in Italian. Gjatë kësaj periudhe morrën

shumë çmime dhe mirënjohje për punën që bënim. Nuk duhet harruar as pjesëmarrjen tonë në videoklipet: "Jemi dhe s'jemi" të këngëtares Vesa Luma, pastaj "Mos e le për pak" të Hekuran dhe Blinera Krasniqit si dhe shumë videokle të këngëtarëve tjerë të njohur shqiptarë", përshkroi Florini sukseset e tij bashkë me grupin "Art Design".

Me tej duke folur për sukseset e grupit, Florini arritjen më të madhë e konsideron vitin 2009 ku në bashkëpunim me RTV-21, e bën "Musical" e parë në shqip në Kosovë. "Nuk ishte ëndërr por realitet dhe askush nuk mund të thotë se arritjet e mëdha s'ekzistojnë për grupet e vogla. Gjithçka varet nga puna dhe përkushtimi që mund të kenë anëtarët", tha Florin Krasniqi.

Ndërkohë më të filluar studimet në "UBT" Florini është aktivizuar edhe në emisionin "Kabare" i cili transmetohet në "RTV 21". Ai këtë eksperiencë e quan si më të bukurën për të. "Jo vetëm xhirimet me këngëtarë, por edhe të jesh mësues i tyre e t'u mësosh pikat e parapara për xhirim, të bën të ndjehesh krenarë", citoi ai, dhe shton: "Asgjë nuk më pengon ta marr atë që dua. Më thjeshtë, mendoj se mund të jem edhe student, edhe valltar, e njëkohësisht të menaxhoj me sukses gjithçka nga jeta ime, sepse njeriu ka kohë për të gjitha vetëm atëherë kur e kupton se koha është e vlefshme", shprehet Florini.

Për fund ai theksoi se do të vazhdon të jetë anëtar i grupit "Art Design", pjesëtar i emisionit "Kabare" në RTV-21, e gjithashtu edhe student i "UBT"-së.



## UBT I BASHKOI STUDENTËT KOSOVARË

PRISHTINË, 21 MARS 2011 - Studentët e Universitetit për Biznes dhe Teknologji (UBT) organizuan një ndejë të mrekullueshme në lokalin "Duplex", në Prishtinë. Përveç studentëve të UBT-së, ftesës ju bashkëngjiten edhe studentët e të gjitha universiteteve të vendit si të "Universitetit të Prishtinës", "AAB-Rinvest", "Fama", "Victory", "Dardania", "Universum", "Tempulli", "Pjeter Budi", "i Biznesit", etj, po ashtu edhe profesorë dhe mysafirë të tjerë.

Arta, studentë në "Universitetin AAB-Rinvest" dhe pjesëmarrje e nejtës në fjalë shprehet e befasuar me organizimin e studentëve të UBT-së. "Shpesh

organizojmë neja të ndryshme por vetëm me studentë të universitetit tonë, por kjo që është organizuar nga studentët e UBT-së është diçka befasuese dhe shumë pozitive për mua besoj edhe për të gjithë të pranishmit".

Ndeja u shoqërua me muzikë nga grupi "NRG BAND", "Dj-Flow" dhe "Dj- Jungle", që krijuan atmosferë të mirë të shoqërimit dhe festimit të jetës së mirë të studentëve kosovare.

Kryetar i Organizatës Studentore të UBT-së, Agron Krasniqi, dhe organizatori i ndejës në fjalë ka premtuar se në bashkëpunim me të tjerët do organizojnë takime të tilla edhe më të shpeshta.

## Ginqe i fasionuar pas beatbox-it



Agron Krasniqi, e thërrasin Ginqe, studion në Fakultetin MBE në UBT. Përveç studimeve Ginqe merret edhe me beatbox, ku shpesh e gjejmë nëpër lokale e vende të ndryshme të vendit duke

e zhvilluar këtë, të cilin aktivitete e do me gjithë shpirt. "Mbon me shpreh botën çka e kom brenda meje", tha Ginqe, për gazetën "UBT News". Ginqe nuk e diskuton të ardhmen e vet pa beatbox.



# PRESIDENTI I UBT-së, z. HAJRIZI PJESËMARRËS NË MISIONIN TREGTAR NË GELSENKIRCHENTË GJERMANISË



PRISHTINË, 07 PRILL 2011 - Presidenti i Universitetit për Biznes dhe Teknologji (UBT), Prof. Dr. Edmond Hajrizi me disa përfaqësues të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë (MTI) dhe të Agjencisë për Promovimin e Investimeve (APIK) dhe këshilltarë të ministrisë së MTI-së, si dhe përfaqësues të biznesit të Kosovës për disa ditë me radhë kanë marrë pjesë në misionin tregtar në Gel-

senkirchen të Gjermanisë për të promovuar investimet dhe eksportet kosovare.

Në këtë organizim, presidenti i UBT, z. Hajrizi dhe përfaqësuesit e MTI-së dhe të APIK-ut kanë pasur takim me përfaqësues të kompanive të fuqishme gjermane, siç është "FAURECIA", e cila ka mbi 200 fabrika në mbar botën me mbi 60.000 të punësuar, e cila merret me prodhi-

min e pjesëve të automobilave të markave të shumta botërore, siç janë: VW, BMW, Mercedes, Ford, etj, kompaninë 'TRW Automotive', e cila merret me prodhimin e pjesëve automobilistike, kompaninë "VALLIANT" e cila është e njohur në fushën e teknologjinë të sistemit të ngrohjes.

Po ashtu delegacioni kosovar ka parë për së afërmi edhe Parkun Shkencor dhe Teknologjik

"SCIENCE PARK GELSENKIRCHEN", që është lider në Gjermani për energjinë e ripërtërishme.

Gjatë vizitës që u bënë këtyre kompanive të rëndësishme, përfaqësuesit nga Kosova kanë promovuar mundësitë për investime në Kosovë në sektorët potencial, si ai i energjisë, bujqësisë, teknologjisë informative, automobilistikes etj. Po ashtu gjatë qëndrimit u organizua edhe një workshop,

në të cilin prezantojë Presidenti i Universitetit për Biznes dhe Teknologji (UBT), Prof. Dr. Edmond Hajrizi.

z. Hajrizi me këtë rast foli për potencialin që ka Kosova, për investime të huaja në vend si dhe për përparësitë dhe veçoritë e këtij sektori.

Po ashtu me një prezantim u paraqiti edhe ambasadori i Kosovës në Gjermani, Vilson Mirdita.

## BERAT AQIFI, DOKTORANTI I PARË NË SHKENCAT DOGANORE



PRISHTINË, 18 PRILL 2011- Në Universitetin "Shën Klimenti i Ohrit", Fakultetin për Turizëm dhe Hoteleri, doli doktoranti i parë në lëminë e shkencave doganore dhe shpedicionit në Maqedoni. Kosovë dhe Shqipëri. Studiuesi i njohur Berat Aqifi nga Kumanova, dhe njëherit profesor-ligjërues në Universitetin për Biznes dhe Teknologji (UBT), me sukses mbrojti temën e doktoratës me titull: "Drejtoria Doganave e Republikës së Maqedonisë dhe format e kriminalitetit transnacional".

Mbrojtjen e disertacionit e bëri pran komisionit si: Akademik Prof. Dr. Vlado Kambovski- kryetar komisionit, dhe anëtarët Prof. Dr. Miladin Krastanovski, Prof. Dr. Jove Kekenovski, Prof. Dr. Liljana Batkoska dhe Prof. Dr. Pere Aslimoski.

Komisioni punën e kandidatit e vlerësoi me notë të shkëlqyeshme duke e çmuar lartë punën e tij profesionale dhe hulumtimet që i ka bërë në këtë drejtim.

Përndryshe kjo është doktoratura e dytë e Dr. Sc. Berat Aqifit, ku në vitin 2010 mbaroi me sukses studimet e doktoraturës në Universitetin të Kievit -Ukranië, me temën "International personel Academy", në lëminë e shkencave juridike drejtimin civilo-juridik.

z. Aqifi deri më tani ka publikuar një numër të madh të punimeve shkencore në revista vendore dhe ndërkombëtare të nivelit shkencorë.

Dr. Berat Aqifi përndryshe është ligjërues në Universitetin për Biznes dhe Teknologji (UBT), Prishtinë.

# LULZIM BEQIRI - VIZITË SHKENCORE NË IRLANDË

PRISHTINË - PRILL, 2011- Vizita studimore në Kolegjin Universitar Kork (UCC), në Irlandë, është organizuar nga projekti Tempus dhe menaxhuar nga projekti Wus Austria - zyra në Kosovë.

Vizitës në fjalë ju kanë bashkëngjitur edhe dhjetë përfaqësues të institucione të arsimit të lartë privat në Kosovë, ku Universitetin për Biznes dhe Teknologji (UBT) e ka përfaqësuar Can. Dr. Lulzim Beqiri, njëherit ligjërues dhe menaxher për departamentin e projekteve dhe të trajnimeve në UBT.

Vizita studimore ka pas të bëjë me menaxhimin e zyrës së cilësisë dhe me menaxhimin e cilësisë në kuadër të Universitetit, shkëmbimi i përvojave në fushën e arsimit në mes të Kosovës dhe Irlandës, dhe gjithashtu ka përfshi edhe menaxhimin në të gjitha lëmit universitare si hulumtime, projekte, menaxhment, intership, etj. Vizita është realizuar nga 9 prillit deri më 14 prill.





ANKETË ME STUDENTË: SA RRESPEKTOHET LIGJI PËR PARANDALIMIN E CIGARES NË KAFITERITË E KOSOVËS

# LIGJI I RI UA PRISH TYMIN E DUHANIT

"Ndalimi i pirjes së duhanit në vende publike", i organizuar nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike, në bashkëpunim me Organizatën KADC ka hyrë në fuqi në fillimin të vitit 2011, me shpresë që edhe për qytetarët e Kosovës ky vit të ketë një nismë më të shëndoshë. Ndërsa në anën tjetër kemi ata që mundohen të dëshmojnë se Kosova është një vend ku rrespektohet ligji.

Shtrohet pyetja rreth zbatueshmërisë së Ligjit kundër pirjes së duhanit. Sa përpiqet inspektoriati në këtë aspekt? Sa zbatohet ky ligj kur ende nuk dihet për qindja e duhanpirësve në vendin tonë?

Disa nga studentët e fakulteteve të ndryshme të Prishtinës kanë opinione të ndryshme. Ja se cka mendojnë ata:

Kaltrina Smajli



Pa dyshim se ligji për parandalimin e pirjes së duhanit është i mirëseardhur, në veçanti për ata të cilët nuk tymosin. Arsyeja është e thjeshtë; atyre nuk u shkohet në lokale në të cilat tymi i duhanit pushton tërë hapësirën e mbyllur. Dhe ata të cilët nuk tymosin nuk dëshirojnë të jenë të ngulatur nga shtëllungat e timit të duhanit.

Por, në anën tjetër, duhanpirësit nuk mund ta imagjinojnë pirjen e një kafeje pa shoqërim të një cigareje, për shkak se, siç thotë populli, kafa me cigare shkon, madje edhe muhabeti disi bëhet më i mirë.

Unë besoj se shumica e lokaleve kanë filluar ta respektojnë këtë vendim për shkak se në të kundërtën edhe mund të gjobiten. Megjithatë ndarja e lokaleve në 30% për ata që pinë duhan dhe tjetra për ata të cilët nuk pinë, është pak e vështirë për shkak se arkitektura e disa lokaleve është e tillë që sjell vështirësi.

Valentina Zariqi



Sipas disa të dhënave me ligjin e ri vërehet një rënie e punës nëpër restorante dhe kafeneve të qytetit për shkak se si duket kafenë e

mëngjesit e pinë nëpër shtëpitë e tyre. Në shumicën e restoranteve dhe të kafeneve të qytetit janë vendosur në hyrje shenjat e ndalimit të pirjes së duhanit dhe brenda janë larguar taketuket nga tavolinat. Kjo duket të jetë një nismë e mirë. Disa nga restorantet kanë filluar edhe të lënë këndin për duhanxhinjtë, por deri tash te pak lokale vërehet qartë ndarjet fizike të pjesëve ku pihet duhani dhe atyre ku nuk pihet, ashtu siç e kërkon ligji. Mendoj se popullatës i duhet kohë derisa të mësohet me situatën e re nëpër lokale.

Visar Shahini



Ligji që ndalon pirjen e duhanit nëpër objektet publike ka per qëllim të mbrojë ambientin në përgjithësi dhe në veçanti ata të cilët nuk pinë duhan. Në të njëjtën kohë me këtë Kosova e plotëson edhe një standart të BE-së nëpërmjet të së cilës e rregullon dhe e mbron shëndetin e njeriut. Me sa e di ky ligj u miratua vitin e kaluar nga Kuvendi i Kosovës dhe filloi të zbatohet në fillim të këtij viti, por si duket ende po hasë në vështirësi zbatueshmëria. Megjithatë zbatueshmëria e ligjit duhet të jenë të vendosur që këtë ligj, për të gjithë ata që nuk e respektojnë, të procedojnë me atë që në realitet e parashihet vet ligji.

Jeta Islami



Ligji për parandalim të pirjes së duhanit respektohet në masë

të caktuar. Secila kafiteri e ka të ndarë sektorin e atyre që tymosin dhe atyre që janë jo duhanpirës. Ky ligj i mbron ata të cilët nuk janë duhanpirës nga ata të cilët janë. Sipas mendimit tim kjo është një gjë shumë e mirë, sepse jo vetëm që e mbrojmë ambientin por edhe jemi me të shëndosh.

Ilir Livoreka



Duhanin e ndaluan, tash veç edhe sendet tjera!

Besoj, që ky ligj po respektohet në një pjesë bukur të madhe të kafiterive, por brengosës është fakti te përmbushja e kriterëve, pasi që ky ligj, edhe pse respektohet, shumë kafiterive nuk i përmbushin kushtet për pjesën e 30 përqindshit që lejohet.

Në realitet paraprakisht këtë ligj, së pari duhet të përmbushet nga vet institucionet si pjesë të organeve miratuese; inspektorët, policia etj., dhe në fund edhe vet qytetarët.

Rina Malneziri



Duke u nisur nga fakti që ligji për ndalimin e pirjes së duhanit ka hyrë në fuqi në fillim të këtij viti duke e reduktuar hapësirën e pirjes së duhanit në vende publike deri në 70%, mendoj se ky ligj veç ka filluar të zbatohet, gjë që po vërehet në shumicën e lokaleve në të cilat ka më shumë qarkullim ditën. Mirëpo jam e bindur se ka vende ku ky ligj ende nuk zbatohet

dhe shpresoj që inspektorët të jenë më të kujdesshëm gjatë kontrollimit.

Qëndresa Neziri



Ky vit, ndoshta, ka nisur mbarë për faktin se ka filluar të zbatohet një ligj, i cili në letër ka ekzistuar shumë më herët, por, që thua se asnjëherë nuk është zbatuar. Lidhur me atë se sa është duke u zbatuar ky ligj, po vërehet në shumë kafiteri të Prishtinës, ku përgjithësisht "hapësira është e ndarë" për duhanpirës. Ndalimi i pirjes së duhanit në vende publike duhet të respektohet për arsye se kjo ndikon në shëndetin publik të qytetarëve

Afërditë Dema



Edhe ky ligj si edhe të gjitha ligjet tjera, i cili pa dyshim duhet respektuar, duket se do të ngelë si shumica e tyre.

Sipas të gjitha gjasave ne si popull na duhet, në njërin anë, kohë që të mësohemi me ndryshime (sidomos kur janë pozitive), dhe në anën tjetër ligjëvënësve këmbëngulje më e madhe. Sipas mendimit tim ky ligj nuk është duke u respektuar në shumicën e vendeve, e aty ku supozohet se respektohet bëhet sa për sy e faqe. Ndoshta duhet vetëdijesim më i madh i popullatës si dhe i pronarëve të lokaleve.

Andin Rashica



Jo, ligji i cigares ku rri unë nuk respektohet aspak. Edhe pse nuk jam konsumues i cigares tymi i duhanit nuk më pengon, por shpresoj që dita ditës ky ligj do të gjej zbatueshmëri më të madhe dhe se do të respektohet më tepër nga pirësitë e cigares dhe nga pronarët e kafiterive. Përkundër faktit që për pronarët e lokaleve do të jetë problem i madh, për shkak se cigarja më së shumti pihet nëpër lokale, me siguri ata, pra pronarët, do ta gjejnë ndonjë zgjidhje që ta bejnë ndonjë vend të posaqëm në lokal që të pihet cigarja ose një orar të caktuar ku cigarja mund të konsumohet.

Artan Murati



Sa i përket kësaj teme, fillimisht mendoj se është ndërmarrë një iniciativë shumë e mirë për mbrojtjen e shëndetit të të gjithë qytetarëve, por edhe për shumë arsye të tjera. Deri më tani nëpër disa kafiteri veç kanë filluar të bejnë ndarjen e hapësirave ku lejohet dhe ku nuk lejohet duhani, këtë e kam parë personalisht, mirëpo vërtet shpresoj që kjo të vazhdojë edhe më tutje e të mos e ketë fatin e njejtë si shumë ligje të tjera në Kosovë që fatkeqësisht nuk respektohen fare.

Besfort Matoshi

Ligji Anti-duhan mendoj se duhet të respektohet, por sa do të respektohet kjo varet nga kontrolli i organeve kompetente, më saktësisht inspektorëve të ligjit anti-duhan, pronarëve të lokaleve dhe vetë duhan-pirësve. Besoj se ata të cilët nuk e respektojnë këtë ligj, si edhe të gjitha ligjet tjera duhet të gjobiten, me shpresë që ky ligj do t'i vetëdijësoj se duhani, nikotina, është mjerimi më i madh dhe zbulimi më i shëmtuar nëpër shekuj i cili duhet të ndalohet reptësisht në gjithë botën.

ANKETOI: BERNA DEVEXHIU,  
STUDENTE NË UBT



STUDENTËT E UBT-SË ORGANIZUAN VIZITË STUDIMORE NË SHQIPËRI

# TRASHËGIMIA KULTURORE-NATYRORE E SHQIPËRISË

ALBERT GASHI,  
STUDENT I MASTERIT NË UBT

Nga 4-6 mars 2011 studentët e studimeve master në Fakultetin Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi në Universitetin për Biznes dhe Teknologji (UBT) nën organizimin dekanatit e po të këtij fakulteti dhe në bashkëpunim me disa studiues arkeologë nga Universiteti i Tiranës, për tre ditë më radhë organizuan udhëtim studimor nëpër Republikën e Shqipërisë.

Studentët vizituan vende të ndryshme si objekte dhe zona të mbrojtura kulturore e natyrore si dhe fabrika me plantacione rrushi për prodhimin e verës, po ashtu vlen të veçohet se përsëafërimi vizituar bukuritë natyrore të Shqipërisë.

Më pastaj u vizitua Parkun Kombëtar në Divjak, qytetin antik të Apolonisë, qyteti antik të Beratit, fabrikën për prodhimin e verës "Çobo" në Berat dhe së fundi Tiranën.

Gjatë udhëtimit studiuesit arkeologë të Universitetit të Tiranës, ligjëruan më shumë për trashëgimin kulturore e natyrore dhe zhvillimin ekonomik të Shqipërisë. Do përmendur se gjithsej 13% e territorit të Shqipërie janë zona të mbrojtura kulturore-natyrore dhe këto zona ndahen në gjashtë kategori: Zonat strikte të mbrojtura - Parqet Kombëtare (Shqipëria ka 15 parqe kombëtare me mbi 180 hektar), Monomentet e natyres - Shqipëria ka 766 monimente të natyres, prej tyre në gjendje të pashkatërruara janë 690, Rezervatat natyrore, pejsazhet e mbrojtura dhe zonat e mbrojtura nga burimet e menaxhuara.

## Parku kombëtar në divjak

Parku në fjalë para viteve 1960 kishte qenë i tri kënetat (ligatina), por gjatë viteve 1960-1970 këto - Kënetat e Tërbufit (siç quhet tash) filloi të thahej për përfitim dhe tokave punuese. Parku Kombëtar i Divjakës ndodhet 40 kilometra larg nga qyteti i Lushnjës. Parku është një pjesë e Lagunës së Karavastasë, e cila mbrohet nga Konventa Ndërkombëtare e Ramsarit e vitit 1994. Ky kompleks përbëhet nga laguna në fjalë, godulla homonime, liqeni i godullës, ligatinat përreth tyre, grykëderdhjet e lumit të Shkumbinit e Semanit dhe pylli Pisha e Divjakës. Kjo pasuri natyrore ka biodiversitet të theksuar: vegetacion të larmishëm, kserofil, halofit, higrofil, etj. Dallohen pyjet halorë mesdhetare me pishë të butë dhe të egër, të shoqëruara nga frashëri, dushku, vidhi, plepi, etj. dhe nënpylli i dendur me shkurre mesdhetare gjithmonë të gjelbra. Ky park, me bukuri mahnitëse, ka botë të pasur dhe të larmishme shtazore, që lidhet me habitatet dhe mjediset e larmishme, që shfrytëzohen për shumëzim, dimërim dhe migrim nga mbi 229 lloje shpendësh. Mjediset e parkut janë shumë më të pasura gjatë dimrit, kur vijnë shpendë migratore nga



vendet veriore. Midis shpendëve, shquhet pelikani. Jetojnë 12 lloje gjitarësh, 16 specie zvarranikësh, etj. Në këtë "rezervat", janë futur edhe lopë e kuaj, që jetojnë në gjendje të lirë që tani edhe kanë marrë tipare të lopëve dhe të kuajve të egër.

## Qyteti antik i Apolonisë

Apolonia e hershme, rreth 12 km larg qytetit të Fierit, u themelua në vitin 588 në një kodër pranë detit dhe afër grykëderdhjes më të madhe të lumit Vjosa dhe bashkë me Durrësin ishin qytetet kryesore të Ilirisë. Apolonia ishte qyteti më i madh ndër 30 qytetet në antikitet dhe si qytet-shtet që në shekullin V para Krishtit preu monedhën e vet të argjendit, e cila u përhap shumë në Ballkan e jashtë tij. Në Apolloni, sikurse edhe në Dyrrah, lulëzuan skulptura, mozaiku dhe muzika.

Për rëndësinë që e kishte, Apolonia u bë arenë luftimesh ndërmjet ilirëve, epirotëve, maqedonasve e romakëve. Për 200 vjet Apollonia ishte qendra kryesore e Romës dhe kolonive të saj dhe mendohet të ketë qenë gjithashtu stacioni kryesor i rrugës së famshme të asaj kohe - Egnatia. Ai ishte monopoli kryesor për Cezarin në luftën civile të tij me Pompein.

Apolonia filloi të rrëzohej e shkatërrohej, e sidomos lumi Vjosa ndryshoi rrjedhën dhe bregdeti ndryshoi si rezultat i tërmetit të madh që ndodhi në vitin 376. Apoloninë e zbuloi në vitin 1924, Leon Rei. Më pas arkeologu shqiptar Hasan Ceka zbuloi edhe një sasi monumentesh interesante si agnotetet, odeonin, bibliotekat, etj.

Qyteti Antikë i Apolonisë deri me tani nga arkeologët vendor dhe ata ndërkombëtar është gërmuar vetëm deri te masa 5% e hapësirës, kurse 95% ende mbetet i mbuluar.

Afer pjesës se godines, që quhej Buleterion, gjendet një Manastir Bizantin shekullit XIII, si dhe Kisha e "Shën Merisë" e cila filloi të ndërtohej qysh në shekullin e XIV, kurse perfundoi në shekullin e XVIII.

Profesor Osli, drejtor i Institutit të Trashëgimis Kulturore të Shqipërisë, na tregoi se Qyteti antik i Apolonisë ndahej në tre pjesë: Zona e parë - zona fetare, ku brenda saj gjenden tempujt e Apollonit dhe ai i Artemisit. Në zonën e dytë janë të ndërtuara Teatri i Odeoni, i cili në kohën Romake, kur edhe ishte ndërtuar, kishte një kapacitetin për 10.000 spektatorësh, kurse më poshtë teatrit Odeon gjindet shetitortja Agoraja, e njohur si zonë publike, që ishte edhe qendër e qytetit-shtet. Ndërkaq, në zonën e tretë janë tre lagje të tjera private të banimit me banesat arkaike, dhe pikërisht këto banesa i japin një imazh të plotë dhe të saktë planit të atëhershëm urbanistik të Apolonisë antike. Në afërsi Apolonisë janë edhe varrezat të quajtura Nekropoli i Apolonisë të quajtur Tuma, ku kishte me dhjetëra qindra varre.

## Qyteti i Beratit 2400-vjeçar

Gjatë vizitës që i bëmë qytetit antik të Beratit pamë Kalanë e Beratit, Muzeun e Onufrit si dhe shikua Xhaminë e Bardhë. Kalaja e Beratit është monumenti më antik, me një sipërfaqe 9.6 ha, i cili ngrihet në një kodër prej 187 metra, e ribërë nga Mëhilli Engjëll Komneni e pastaj, në vitin 400, nga venecianët, ndodhet në pjesën e sipërme të qytetit dhe ka mure të larta rrethues të ndara nga 24 kulla të formave dhe dimensioneve të ndryshme, të ndërtuara në periudha të ndryshme. Në periudhën bizantine kështjella ndodhej në listën e fortifikimeve të Justinianit, muri rrethues rrethon kodrën,

e cila dominon qytetin aktual të Beratit dhe ka formën e një shigjete drejtuar nga veriu, më parë formonte një zinxhir me kodrën përballë Goricës, e cila është 6 m më e lartë. Në pjesën më të lartë të kështjellës ndodhet gjithashtu një akropol i rrethuar me mure, brenda së cilës gjenden mbetjet e një garnizoni ushtarak, mbetjet e sarajeve të pashait dhe të Xhamisë së Bardhë të periudhës Otomane.

Muzeu i Onufrit gjindet brenda kalasë dhe është hapur për vizitor para 20 vitesh. Onufri ishte një ikonograf dhe prift shqipëtar, që përpos që kishte pikturuar dhe punuar ikonat e Manastirit në Kalanë e Beratit (i kishte përfunduar së ndërtuari më 9 Mars 1797) ai punoi dhe pikturoi edhe në shumë manastire në Brindizi të Italisë, si dhe në manstire të tjera të bizantit. Brëndia e Manastirit në Kalanë e Beratit në tërësi është e punuar me dru, e ngjyrosur me flori (ari), që perkon me kulturen dhe stilin barok të bizantit të asaj kohe. Ikonat më të përsosura dhe kryevepra e Onufrit ishte ikona e Shën Merisë. Aty gjenden edhe ikonat të tjera të punuar nga ikonografi tjetër i quajtur Johan Qetiri.

Në Manastirin e cekur gjenden edhe 27 ikonat që përkojnë me 27 festa të kohës Bizantine, si dhe vezet e strumcit, të pikturuara në kupollën e Manstirit, ndërkaq në dyshe me gjenden 4 polet, që përkojnë me 4 stinët e vitit, 12 ndarjet me muajt e vitit, 30 trekëndëshat me 30 ditët e muajit, kurse ylli me 6 cepa perkon me yllin e Davidit.

## Kodiket e Beratit

"Kodiku i Purpurt i Beratit", një nga variantet më të vjetra të Testamentit të Ri, është një referencë thelbësore e letërsisë evangjeliste më përgjithësisht, e kulturës kristiane. UNESCO i kushton vë-

mendje të veçantë ruajtjes së kësaj trashëgimie unike të zhvillimit të letërsisë së vjetër biblike dhe liturgjike përgjatë historisë botërore. Ja pse "Kodikët e Beratit" figurojnë në regjistrin e veprave më të rëndësishme të njerëzimit, të krijuar në kuadrin e programit Kujtesa e Botës.

"Kodiku i Purpurt i Beratit" njihet edhe me emrin "Beratinus". Në fakt emrin e Beratit e ka marrë si epinom edhe "Kodiku i Artë i Anthimit", që shpesh quhet edhe si "Beratinus-2". Kjo ka ndodhur se për një kohë të gjatë emri i tij është lidhur e vazhdon të lidhet me emrin e Shën Gjon Gojartit, një prej protagonistëve dhe reformatorëve më të mëdhenj të historisë së krishtërimit të hershëm. "Beratinus" mori rëndësi botërore si një dorëshkrim i hershëm që mund të ndihmonte për të plotësuar historinë e zhvillimit të mendimit ungjillor, nëpërmjet studimeve të posaçme të tekstologjisë kritike ("textual criticism"), që mund të thuhet se, në dijen shqiptare, sapo kanë filluar.

Rëndësia e "Beratinus-it" u theksua edhe më nga fakti se në tipologjinë e tekstit të tij gjenden gjurmë të shkrimeve siriake (të Lindjes) dhe të Perëndimit njëhënjë. Këtyrë mendimi i janë përmbytur shumë dijetarë, prej Batiffol-it deri tek Aleks Buda e më pas Roderic L. Mullen. Kjo e bën atë një prej dorëshkrimeve më të rëndësishme për të krahasuar shkollat e shkrimeve ungjillore dhe procesin historik të kanonizimit të shkrimeve të shenjta në përgjithësi.

Në Shqipëri dijetari i parë që ka bërë të ditur ekzistencën e Beratinus-it dhe të disa kodikëve të tjerë ka qenë Ilo Mitkë Qafëzezi. Ky qe më shumë i preokupuar për "Kodikun e Kostë Beratit", në të cilin gjendej një alfabet i panjohur i shqipes me grafema helene, por nuk harroi të përmendte pak më gjerësisht vlerat e thesarit dorëshkrimor beratas.

## Kantina e verës "Çobo" e Beratit

Në vazhdim vizituar edhe Kantinën e verës "Çobo", e cila gjendet afër Beratit. Familja Çobo ka një traditë të hershme në prodhimin e verës, e cila ze fill në fillim të viteve 1900. Pas ardhjes së komunistëve tradita vazhdoi si sipërmarrje. Sipas pronarëve të kantinës, vllëzerve Muharremi (president i kantine) dhe Petriti (menaxher i kantine), stërgjyshi ynë e filloi traditën e bërjes së verës në fshatin Mbolan afër Malit Shpirag. Zanati u trashëguar nga brezi në brez, derisa historia erdhi te unë dhe vëllai im Muharremi". Pra, vera "Çobo" prodhohet nga të gjitha varietetet e rrushit që rritet në rrethinën e Beratit. Kantina "Çobo" prodhon 5 verera cilësore: Kashmer, Shesh i Zi, Shesh i Bardhë, E bardha e Beratit, Trebiano, si dhe dy raki: Raki me arra dhe raki rrushi.

Në vitin 2010 "Çobo" ka prodhuar deri në 100 mijë shishe verë të llojeve të përmendura.



Goal.com i publikon

# DHJETË BESNIKËT E FUTBOLLIT

“Real Madridi më kërkoi së bashku me Manchester Unitedin dhe Juventusin. Kam menduar të vij në Evropë, por në fund preferova të mbetem në klubin tim të zezërës, Santos”, ka deklaruar Pele

LONDËR— Në futbollin e sotëm, transferimet e shpeshta të futbollistëve janë bërë lajm i zakonshëm. Mirëpo, në të kaluarën, por edhe në ditët e sotme ka ende futbollistë aktivë që kanë kaluar dekada në të njëjtin klub, ndërsa pritjet edhe të dalin në pension aty. Uebfaqja "goal.com" ka krijuar një top 10-she me emrat e futbollistëve më besnikë, të cilët kurrë nuk do të largohen nga klubi i tyre. Në këtë listë ka edhe futbollistë që tashmë e kanë braktisur futbollin, por edhe nga ata që vazhdojnë të luajnë. E nisim nga legjenda Pele. Të gjithë e dimë se Pele e përfundoi karrierën në New York Cosmos, por i qëndroi besnik Santosit për 18 vjet. “Real Madridi më kërkoi së bashku me Manchester Unitedin dhe me Juventusin. Në të vërtetë, Juventus ishte afër marrëveshjes me Santosin, duke përfshirë përkrahjen nga FIAT-i. Kam menduar të vij në Evropë, por në fund preferova të mbetem në klubin tim të zezërës, Santos”, ka deklaruar Pele në një intervistë, në vitin 2009, dhënë për “Eurocalcio”. Kalojmë te një tjetër lojtar i jashtëzakonshëm, të legjenda bardhezi,

Alessandro del Piero. Për t’ia përfunduar karrierën Roberto Baggios te Juventus, duhet të jesh i veçantë dhe Del Piero e demonstroi këtë në raste të shumta, pas transferimit nga Padova, më 1993. Shpeshherë spekulohet me kalim në Spanjë ose në Angli, por legjenda e “biankonerëve” qëndroi në klub edhe në Serinë B dhe pritjet ta përfundojë karrierën në Juventus. Del Piero është lojtari më i adhuruar nga tifozët bardhë e zi, por jo vetëm kaq. Ai është edhe rekordmeni i “Zonjës së vjetër”. Një tjetër legjendë është kapiteni i Barcelonës. Është thjesht e paimaginueshme të flitet për Puyolin e të mos jetë në fanellë të Barcelonës. Titullar për më tepër se një dekadë, qendërmbrojtësi kërkohet nga klube të ndryshme evropiane, duke përfshirë Manchester Unitedin në vitin 2003, por gjithmonë i qëndroi besnik Barcelonës, ku edhe sot vazhdon të jetë njëri prej futbollistëve kryesorë të ekipit. Në këtë listë është edhe Lev

Yashin. I votuar si portieri më i mirë i shekullit të 20-të, Yashini e ka marrë nofkën “merimanga e zezë”, për shkak të refleksit të tij të shkëlqyeshëm. Një veteran i tri kampionateve botërore, Yashini është i vetmi portier që e ka fituar “Topin e artë”. Gjithë karrierën e tij 22-vjeçare si futbollist e kaloi te Dinamo e Moskës, ndërsa kaloi edhe dy dekada të tjera në klub si zyrtar, para vdekjes së tij, më 1990. Megjithatë, përveç këtyre 10 flakujve, në listë mund të futeshin edhe lojtarë të tjerë, p.sh. Francesco Totti. Kapiteni i Romës është flamuri i këtij ekipi. Ai luan prej vitesh me verdhë e kuqë dhe do ta përfundojë karrierën në kryeqytetin italian. Totti ka refuzuar shumë oferta për t’i qenë besnik Romës. Një nga refuzimet e tij ka qenë edhe Reali i Madridit.

## 10. Pele (Santos)

E dimë se Pele e përfundoi karrierën e tij në New York Cosmos

nos, por i qëndroi besnik Santosit për 18 vjet. “Real Madridi më kërkoi së bashku me Manchester United dhe Juventusin. Në të vërtetë, Juventus ishte afër marrëveshjes me Santosin, duke përfshirë përkrahjen nga FIAT-i. Kam menduar të vij në Evropë, por në fund preferova të mbetem në klubin tim të zezërës, Santos”, ka deklaruar Pele në një intervistë, në vitin 2009, dhënë për “Eurocalcio”-s.

## 9. Sepp Maier (Bayern Munih)

Një portier që i qëndroi besnik një klubi. Sepp Maier qëndroi në portën e Bayern Muniut 17 vjet, duke fituar tituj të ndryshëm, si dhe kampionatin botëror me Kombëtaren gjermane, më 1974.

## 8. Matthew Le Tissier (Southampton)

Le Tissier nuk e lëshoi kurrë Southamptonin. Ish-partneri i tij, Alan Shearer, e ftoi t’i bashkonin forcat në Blackburn Rovers, ndërsa ai ishte kërkuar edhe nga Manchester Unitedi. Por, Le Tissieri mbeti në Southampton gjatë gjithë karrierës dhe ishte aq i mirë, saqë ylli spanjoll, Xavi Hernandez, e kishte idhull dhe e lavdëroi talentin e tij si “sensacional”.

## 7. Lev Yashin (Dinamo Moskë)

I votuar si portieri më i mirë i shekullit të 20-të, Yashini e ka marrë nofkën “merimanga e zezë”, për shkak të refleksit të tij të shkëlqyeshëm. Një veteran i tri kampionateve botërore, Yashini është i vetmi portier që e ka fituar “Topin e artë”. Gjithë karrierën e tij 22-vjeçare si futbollist e kaloi te Dinamo e Moskës, ndërsa kaloi edhe dy dekada të tjera në klub si zyrtar, para vdekjes së tij, më 1990.

## 6. Alessandro del Piero (Juventus)

Për t’ia përfunduar karrierën Roberto Baggios te Juventus, duhet të jesh i veçantë dhe Del Piero e demonstroi këtë në raste të shumta, pas transferimit nga Padova, më 1993. Shpeshherë spekulohet me kalim në Spanjë ose Angli, por legjenda e “bian-

konereve” qëndroi në klub edhe në Serinë B dhe pritjet ta përfundojë karrierën në Juventus. Del Piero është lojtari më i adhuruar nga tifozët bardhezinj, por jo vetëm nga ta. Ai është edhe rekordmeni i “Zonjës së vjetër”.

## 5. Jan Ceulemans (Club Brugge)

Mesfushori belg, Jan Ceulemans, gjithë karrierën e tij e kaloi në vendlindje. Ai u transferua nga Lierse në Brucce më 1978 dhe qëndroi aty për 14 vjetët e ardhshëm, duke refuzuar edhe klube nga Serbia.

## 4. Carles Puyol (Barcelona)

Është thjesht e paimaginueshme të flitet për Puyolin e të mos jetë në fanellë të Barcelonës. Titullar për më tepër se një dekadë, qendërmbrojtësi kërkohet nga klube të ndryshme evropiane, duke përfshirë Manchester Unitedin në vitin 2003, por gjithmonë i qëndroi besnik Barcelonës, ku edhe sot vazhdon të jetë njëri prej futbollistëve kryesorë të ekipit.

## 3. Juan Carlos Plata (Municipal)

Sulmuesi Plata theu rekorde të shumta në Municipal dhe u shndërrua në legjendë të klubit, duke fituar 15 tituj. Atij, madje, iu kushtua edhe një film dokumentar për jetën dhe karrierën e tij, ende pa dalë në pension si futbollist.

## 2. Ryan Giggs (Manchester United)

Ai e filloi karrierën si i ri në Manchester City, por u shndërrua në legjendë të rivalit, Manchester United, dhe kurrë nuk shprehu dëshirë për t’u larguar nga “Old Trafford” gjatë dy dekadave të deritashme të qëndrimit në klub. Me 11 tituj në ligë, me mundësi për të fituar edhe më tepër, Giggsi mbetet futbollist i klasit botëror, pavarësisht moshës 37 vjeçe.

## 1. Paolo Maldini (Milan)

Debutoi me Milanin qëkur ishte 16 vjeç, i fitoi shtatë tituj në Serinë A dhe pesë Kupa të Evropës. Paolo Maldini ishte gjithmonë pjesëmarrës në suksesin e Milanit, për më tepër se 20 vjetët e kaluar. Tifozët e klubit ende presin ta shohin zhvillimin e dy djemve të tij, të cilët aktualisht paraqiten për ekipin e të rinjve.





**Jaffa Champion**







ERMALA BEJTULLAHU -  
STUDENTE NË UBT

Florentina Ismaili është një nga studentet e dalluara në universitetin "UBT". Ajo është studente e vitit të dytë në drejtimin Menaxhment, Bznes dhe Ekonomi. Mirëpo, Flo-

tentina gjatë kohës së lirë dhe jashtë aktiviteteve studentore ka edhe një pasion që nga fëmijëria. Ajo luan mrekullueshëm me intrumete muzikore, ndërsa instrumenti më i dashur për të është piano. "Gjithmonë më kanë pëlqye dhe i adhuroj tingujt e pianos. Kur luaj me piano me bënë të jam larg streseve ditore. Piano është qetësimi i shpirti tim. Jam e lidhur shumë me të, sa që çdo ditë në shtëpi luaje me ore të tëra, është pasioni ime", tha Florentina Ismaili, për gazetën e studentëve të UBT-së, "UBT News".

Florentina është pjesëmarrëse e rregullt nëpër koncerte në qytete

të ndryshme si në vend po ashtu edhe jashtë Kosovës, nga ku jo rrallë edhe ka marr mirënjohje.

Pas përfundimit të studimeve në "UBT", Florentina të ardhmen e vet e sheh si menaxhere e ndonjë kompani ose ndërmarrje që është profitabile për vendin, por pa e lënë anash edhe pianon.

dorët nga mosha 16-18, ndoshta dikush mund të thonë që mosha 16-vjeçare është shumë e re, po kur them 16 vjet mendoj një grim shumë të lehtë, një shkëlqim në buzë, qerpikë pak diçka, dhe në asnjë mënyrë të filloj me pudra të rënda, apo ndonjë produkt që të bënë të dukesh jo vetvetja, me një nuancë krejt tjetër nga lëkura e personit, atëherë kur vjen mosha 18-vjeçare, siç krejt e dijmë, të gjithë femrat e kanë një liri pak më të madhe, por prapë të shkon kah natyralja, në mënyrë që sa më shumë t'i iket grimin të tepruar.

Valoni shton se një përqindje e vogël iu përmbahet rregullave të grimin. "Fatkeqësisht rinia jonë grimin e përdorin në dy kohë - ditën dhe natën. E çka është më së keqti se grimin po përdoret edhe në institucione shkollore", thotë ai, duke shtuar se gjatë ditës bëhet një grim shumë i thjeshtë dhe sa më natyral që të jetë e mundur apo fare. Kurse sa i përket natës atëherë varet prej rastit se ku shkon, p.sh ndeja të ndryshme, varet veshja, stili nëse është një natë paksa më solemne, atëherë përdoret një grim pak më i rënd, gjithmonë duke pas parasysh moshën e personit, stilin, veshjembathjen, e kështu me radhë.

Mesazhi për vajzat e reja është që sa më pak grim, sa më natyrale, por edhe të lexoni instrukcionet prapa në produkt si duhet të përdoret grimin, por gjithmonë duke e konsultuar dermatologun", thotë Valoni.

Në anën tjetër, dermatologët thonë se kremat dhe pudrat e ndryshme i bllokojnë poret e lëkurës, ndaj duhet t'i përshtatën tipit të lëkurës. "Kremat, sherku, pudëra, duhet t'ia përshtasim lëkurës, varërisht se a është lëkura e yndyrshme, e thatë apo normale, e nëse e përshtatim sipas konditave që parashihet, nuk do të thotë që do të ketë probleme, por nëse nuk ia përshtatim tipit të lëkurës, në të ardhmen kemi me pas efekte negative", thonë doktorët dhe shtojnë se çdo person që mendon për fytyrën e vet duhet të konsultohet me dermatologët ose sallonet e kozmetikës.

njerëz profesional, si me njërin ndër frizerët më të njohur në Prishtinë, Valon Gashin, prej sallonit "Vogue", i cili kategorikisht është kundër grimin të tepruar tek vajzat e reja. Njëherësh ai tregon konkretisht sa dhe prej cilës moshë duhet të fillohet të përdoret grimin. Më besoni se meshkujt në Kosovë, në përgjithësi preferojmë femra me stil të thjeshtë, me pak grim dhe sa më natyrale", duke shtuar se grimin bënë të fillohet të për-

# SA MË PAK GRIM AQ MË E BUKUR

EGZANA PEJA & DIELLZA  
BERISHA, STUDENTE NË UBT

Ajo çka po vërehet te femrat e moshës së re në Kosovë është kallajtja e fytyrës me grim të tepruar. Një gjë të tillë e kanë vërejtur edhe qytetarët e të gjitha moshave. Ja çka thotë axha Idriz, që i është ofruar të gjashtëdhjetave: "Në moshën 20 vjeçare edhe drejtë është i bukur e leje më një vajzë e re. Po shkojnë e po grimosen sa po e humbin bukurinë që ua ka falë Zoti. Përdorin një kg pudër, karmin dhe shmik nga ngjyrat e nxehta, plus take afër 10 cm, sa tik-taket e tyre të zgjojnë nga gjumi, nuk dihet ku po shkojnë a në dasme, në shkollë apo në fakultet".

Vazhduam rrugën dhe hymë në oborrin e Universitetit dhe takuam Arta Krasniqin, studentë e vitit të parë, e cila sapo doli nga ligjëratat. Ishte e grimosur ashtu

siç kish ditë vetë, buzët me karmin të kuq, kapakun e syrit kaltër, po ashtu edhe mollëzat e faqeve me shkëlqim etj... "Po plaku nuk di. Unë nuk mund të shkoj në fakultet, në shopping, apo në një ndeje pa u grimosur në këtë masë. Jam mësuar dhe tash rregullisht rregullohem kështu".

Në pyetjen tonë që ia drejtuam Granitit (afër njëzetepesëvjeçar), se çka mendon për vajzat që përdorin grim të tillë, ai thotë: "Nuk di. Unë femrën time nuk e lejoj të kallaitet ashtu. Ajo rregullohet me një grim të lehtë si më pëlqen mua edhe asaj dhe siç i ka hije një femre të re".

Më besoni se meshkujt në Kosovë, në përgjithësi preferojmë femrat me stil të thjeshtë dhe me pak grim, në mënyrë që të kenë pamje sa më natyrale.

Duke i parë moskënaqësitë e qyfterëve, biseduam edhe me



# TOP EDUCATION FOR TOP STUDENTS

